



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË HËNË, 5 QERSHOR 2023, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**NËNKRYETARJA E KUVENDIT**  
**ERMONELA FELAJ**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.05.2023 dhe procesverbalit të seancës së posaçme të datës 01.06.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)*

3. Diskutime për çështje të evidentuara nga zgjedhësit *(neni 40/1, pika 4 e Rregullores së Kuvendit)*

Diskutime jo më shumë se 4 orë.

Për sa më sipër, minutazhi për diskutimet është si vijon:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste 129 minuta

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike 60 minuta

Grupi Parlamentar “Aleanca për Ndryshim” 12 minuta

Grupi Parlamentar “Drejtësi dhe Integrim” 14 minuta

Deputetët jashtë grupeve parlamentare:

Partia e Lirisë 5 minuta

PSD 5 minuta

Sali Berisha 3 minuta

Edmond Spaho 3 minuta

Flamur Noka 3 minuta

Ludovik Hasani 3 minuta  
Oerd Bylykbashi 3 minuta  
Agron Shehaj 3 minuta  
Petrit Doda 3 minuta

**Ermonela Felaj** – Mirëmëngjesi, kolegë!

Ju lutem, le të bëhemi gati për fillimin e seancës plenare.

Ndërkohë, i lutem sekretarisë që të njoftojë edhe kolegët që qëndrojnë në ambiente të tjera.

Mirëmëngjesi, kolegë!

Meqenëse nga këshilltarët e seancës më bëhet me dije se kuorumi për të hapur seancën plenare është i plotë, mund të fillojmë. Kështu që e deklaroj të hapur këtë seancë!

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, më duhet t'ju bëj me dije rendin e ditës për seancën e sotme plenare, e cila është e detyruar për t'u zhvilluar pas "Javës së gjelbër".

Sot në rendin e ditës do të kemi: miratimin e procesverbalit të seancës plenare, datë 25 maj 2023, dhe të procesverbalit të seancës se posaçme që mbajtëm në datën 1 qershor 2023. Pika e dytë lidhet me njoftimet, më pas do të kalojmë te diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhësit tanë.

Lidhur me procesverbalin, besoj se ju është vënë në dispozicion.

Ka vërejtje a sugjerime për procesverbalin? Miratohet!

Kalojmë te njoftimet.

Dëshiroj t'ju njoftoj se në Kuvend janë depozituar tri projektligje nga Këshilli i Ministrave. Po ashtu, është kërkuar një interpelancë urgjente me ministren e Arsimit, që sigurisht, konform Rregullores, do të zhvillohet në seancën plenare.

Titujt e çështjeve, të cilat sapo i njoftova, i gjeni edhe në sistemin që kemi këtu në sallë.

Vazhdojmë me çështjet e rendit të ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të përfundoj pak këtë pjesë, më pas do t'ju jap fjalën!

Referuar nenit 40/1 të Rregullores, nen i cili disiplinon veprimtarinë parlamentare, java e katërt kalendarike është në dispozicion të deputetëve dhe grupeve për njohjen e zgjedhësve me punimet e Kuvendit dhe për trajtimin e problemeve që kanë zgjedhësit në çdonjërin prej qarqeve të Republikës së Shqipërisë. Kuvendi i zhvillon punimet në seancë plenare për diskutimin e çështjeve që ngrenë zgjedhësit ditën e hënë, që pason javën e veprimtarisë njohëse me zgjedhësit.

Referuar këtij neni, pra nenit 40/1 të Rregullores, seanca plenare zhvillohet jo më shumë se katër orë. Koha e diskutimeve ndahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës parlamentare, duke marrë parasysh edhe deputetët e pavarur ose deputetët që qëndrojnë jashtë grupeve parlamentare. Koha e diskutimeve brenda shumicës dhe pakicës ndahet, për sa është e mundur, në proporcion me madhësinë e grupeve, numrin e deputetëve të pavarur dhe të deputetëve jashtë grupeve.

Për sa më sipër, minutazhi është ai që kemi përdorur vijimisht. Sidoqoftë, për kujtesë, do më duhet ta them: Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka 129 minuta në dispozicion, kohë kjo e ndarë midis diskutantëve të ndryshëm; Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka 60 minuta; Grupi Parlamentar "Aleanca për Ndryshim" 12 minuta; Grupi Parlamentar "Drejtësi dhe Integritim" 14 minuta; deputetët jashtë grupeve parlamentare kanë të gjithë së bashku 21,6 minuta në dispozicion, sipas specifikimeve që janë bërë në listë.

Unë e kam përpara listën e diskutimeve. Para se të hapim diskutimet, zoti Shehu e ka kërkuar fjalën.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fatkeqësisht, ne vazhdojmë në këtë parlament me shkelje të rënda të procedurës e të Rregullores prej një kohe shumë të gjatë. Kjo na bën që të mblidhemi sot këtu, sikur të jemi parlamenti i Marsit apo i Jupiterit, dhe jo si parlamenti shqiptar.

Zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Në përputhje të plotë me Rregulloren e me procedurën, ne, një grup deputetësh, kemi paraqitur që prej një viti e ca një kërkesë për një mocion me debat dhe rezolutë ndaj gjenocidit serb në Kosovë në vitet '90.

Në shkelje të plotë të procedurës e të Rregullores, akoma nuk është futur në diskutim pranimi apo mospranimi i këtij diskutimi nga Asambleja Plenare. Veçanërisht sot, kur ngjarjet kanë precipituar në mënyrë të rrezikshme, kur mbi Kosovë po realizohet një agresion i plotë, kur ata që janë përgjegjësit, shkaktarët dhe autorët e gjenocidit në Kosovë, kërkojnë të veshin sot petkun e qengjit dhe të anatemojnë Kosovën, ne heshtim. Ne nuk kemi guxim as ta kalojmë atë rezolutë, me anë të së cilës të dënojmë gjenocidin serb.

Unë do të them diçka: zanafilla e gjithçkaje, fillimi i gjithçkaje është ai gjenocid, është ajo dhunë që u realizua mbi popullin e Kosovës, është ajo shtypje e madhe, e cila më pas u finalizua me vrasjet e krimet masive të viteve '90. Pa dënuar atë, pa e njohur atë, siç ka bërë Parlamenti i Kosovës, pa dyshim që ne nuk kemi të drejtë të flasim dhe nuk kemi të drejtë të kërkojmë drejtësi.

Nga ana tjetër, Serbia vazhdon të mos e njohë atë gjenocid, vazhdon të tallet me atë gjenocid, kur në të gjitha parimet europiane të pasluftës është krejtësisht e qartë se njohja e gjenocideve, kërkimi i faljeve për gjenocidet është baza, është themeli i stabilitetit dhe i paqes së mëtejshme. Kjo nuk bën. Parlamenti shqiptar nuk guxon ta kalojë atë gjenocid këtu. Pse? Sepse mërzhitet Vuçiçi, i cili ka deklaruar qartësisht se nuk do të lejojë që parlamentet e vendeve “mike” ta hapin një diskutim të tillë.

*(Bie gongu.)*

Dhe ne heshtim; heshtim në kundërshtim të plotë me Rregulloren, në kundërshtim të plotë me procedurën, në kundërshtim të plotë me parimet, me detyrimet tona si Shqipëri dhe si shqiptarë e jo vetëm si shqiptarë, me detyrimet e botës demokratike për të dënuar atë gjenocid, i cili realisht është baza e çdo gjëje që po ndodh sot në Kosovë me riaktivizimin e grupeve nacionaliste dhe ekstremiste për të goditur Kosovën.

*(Bie gongu.)*

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehu!

Kjo seancë, konform nenit 40/1 të Rregullores, e ka objektin të përcaktuar në mënyrë

të tillë që ne nuk mundemi as ta shtojmë e as ta pakësojmë. Patjetër që diskutime të natyrave të tjera mund të ngrihen në Kuvendin e Shqipërisë.

Atëherë, fillojmë diskutimet.

Do të më duhet t'ia jap fjalën zonjës Klotilda Bushka.

Të përgatitet zonja Merita Bakiu.

Zonja Bushka, keni shtatë minuta në dispozicion!

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja kryesuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë!

Të dashur qytetarë!

Në vijim të aktivitetit nëpër zonat tona, ku jemi përfaqësues, sigurisht që të gjithë kemi diskutime me qytetarët në lidhje me problematika të ndryshme. Thelbi i çështjeve që duhet të sjellim në seancë plenare, ka të bëjë me ato problematika që njihen nga një masë e gjerë e popullatës, në mënyrë që të gjejmë zgjidhje për t'i adresuar.

Prandaj unë, nga gjithë moria e diskutimeve që kam bërë me qytetarët gjatë javës së kaluar, kam vendosur të diskutoj në këtë seancë plenare në lidhje me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Njësia 3, në Tiranë, ku unë shërbej si deputete, ka një zonë që konsiderohej zonë informale, që tashmë është urbanizuar, por që në të ka ndërtime pa leje ende të palegalizuara. Në vitin 2020, ne miratuam në këtë Kuvend ligjin nr. 20/2020 “Për proceset kalimtare të pronësisë” së bashku me një sërë aktesh të tjera, që zgjidhën një sërë problematikash në lidhje me çështjet e pronësisë, përfshi edhe legalizimin e ndërtimeve pa leje. Jo vetëm kaq, por u parashikuan rregulla të qarta në lidhje me mënyrën se si duhej të kryhej ky proces, e më pas se si do të duhej të balancoheshin edhe të drejtat e pronarëve, mbi trojet e të cilëve ishin bërë ndërtimet pa leje, si do të shpërbleheshin pronarët dhe se si do të mbarohej ky proces, që të mund t'i hapte rrugë një procesi tjetër, që është procesi i kompensimit të pronarëve që u është njohur pronësia, por, për efekt të pronave të zëna, nuk e kanë marrë ende kompensimin e pronës së tyre apo të drejtën e saj.

Në këto kushte, ajo që vë re, për të cilën mendoj se është një fenomen që ndodh edhe në zona të tjera, pavarësisht se ligji është miratuar dhe ka më se tre vjet që është në funksion të plotë, bashkë me aktet nënligjore, bashkë me reformën institucionale në institucionet që merren me

trajtimin e pronës apo me regjistrimin e saj, shoh se ka zona ku në një lagje janë tri shtëpi të legalizuara, ndërsa tri të tjera janë të palegalizuara. Një pjesë e ndërtesave kanë të njëjtën problematikë, por dikush e ka marrë lejen, dikush nuk e ka marrë.

Sipas gjykimit tim, do të duhet të ndryshohet metoda e punës sa i takon adresimit të këtij problemi. Metoda e punës do të thotë që lagjet të merren me blloqe, të fillohet nga blloku i parë deri në bllokun e fundit dhe ky proces të njësohet në të gjitha zonat, sepse pas kaq vjetësh, kur tashmë reforma për këto çështje është në konsolidimin e saj, do të duhet të ndihen efektet te qytetarët. Sa më shpejt që ndërtimet pa leje të legalizohen në mënyrë të njëtrajtshme nëpër zona, aq më shpejt do të shpërblehen pronarët, trojet e të cilëve janë zënë me ndërtime pa leje. Sa më shpejt të kryhet ky proces, aq më shpejt do të identifikohen sipërfaqet e lëna bosh që ish-pronarët të trajtohen nga fondi i kompensimit të pronës. Kjo do të thotë se ato vendime të Këshillit të Ministrave që janë miratuar së fundi, për të cilat unë e përgëzoj qeverinë, të cilat kërkojnë t'u kthehet toka apo prona atyre pronarëve, që ende nuk e kanë në posedim, kjo për efekt të pengesave të mëparshme, kur ajo është e lirë, do të duhet të realizohet në momentin pasi mbaron një proces i identifikimit të pronës së lirë.

Unë mendoj se kjo mazhorancë, Kuvendi, i kanë miratuar të gjitha aktet ligjore dhe mekanizmat për ta arritur këtë synim. Do të duhet që thjesht të kemi një qasje pak më eficiente në zbatimin e legjislacionit. Në këtë drejtim, Komisioni për Çështjet Ligjore është edhe autoriteti përgjegjës brenda Kuvendit, sa i takon raportimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për procesin e ecursisë së gjithë atyre dispozitave dhe mekanizmave që parashikon ligji nr. 20/2020 “Për proceset kalimtare të pronësisë” dhe një herë në vit thërret në dëgjese këtë institucion.

Do të duhet të diskutojmë së bashku se si mund të ketë një mënyrë tjetër organizimi metodika e punës, që efektet e legjislacionit të ndihen te çdo qytetar. Unë pashë statistikat javën e kaluar. Ka një ecuri mjaft të kënaqshme numri i ndërtimeve pa leje që janë legalizuar. Është edhe një proces tjetër që duhet të vijojë pas legalizimit, që është procesi i regjistrimit të lejeve të legalizimit, proces që merr kohën e vet. Për sa kohë që zgjidhet ligjore janë në ligj, për sa kohë

që ligji ka dhënë gjithë mekanizmat e duhur që këto çështje të adresohen e të zgjidhen, qytetarët do të duhet t'i ndiejnë efektet e tij sa më shpejt që të jetë e mundur.

Siç e thashë më parë, i pashë edhe statistikat. Kemi një rritje të konsiderueshme të numrit të ndërtimeve pa leje që janë legalizuar. Kemi një rritje të konsiderueshme të pronarëve që janë shpërblyer nga legalizimi i ndërtimeve pa leje, kur ato janë në tokat apo në pronat e tyre. Nga ana tjetër, do të duhet të ecim me ritme më të shpejta, pavarësisht se afati në ligj për realizimin e të gjitha proceseve, e këtu flas për ligjin nr. 20 të 2020-ës, është shtatë vjet nga dita e miratimit. Pra, ne gjendemi në rreth një të tretën e kohës, apo pak më shumë, për të kuptuar se sa ka funksionuar ky mekanizëm i ri ligjor dhe se çfarë duhet bërë për ta çuar atë më para.

Unë mendoj se në momentin që do të kemi një siguri të tillë në titujt e pronësisë, siç ka qenë qëllimi i reformës dhe siç vijon të jetë, sa i takon reformës së pronës, do të jetë baza për një ekonomi më të fortë dhe për më shumë siguri për investime në Shqipëri.

Kësisoj, unë mendoj se në dëgjuesën që ne do të kryejmë në Komisionin e Ligjeve, për të cilën do të vihet në dijeni edhe seanca plenare e Kuvendit, do t'i diskutojmë këto çështje, në mënyrë që të shohim përsheptimin e procesit, një qasje të re të metodikës së punës, sepse prona është një nga elementet më të rëndësishme në jetën e njeriut. Për sa kohë kjo mazhorancë e ka pasur gjithë vullnetin të bëjë një reformë prone, për t'i dhënë të drejtën atij që i takon, do të duhet që ai t'i ndiejë efektet e kësaj reforme sa më shpejt që jetë e mundur.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Bushka!

Zonja Bakiu, keni 5 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Koçi.

**Merita Bakiu** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Më në fund, pas shumë kohësh, ne po zhvillojmë seancën pas “Javës së gjelbër”. Në fakt, për mua, si deputete e Krutës, kjo seancë është shumë prioritare. Në këtë seancë unë përmbush misionin tim, atë të delegimit të shqetësimeve të atyre banorëve që më kanë besuar

votën. E di që sot shumica e opozitës do të jetë falënderuese ndaj atyre njerëzve që i dhanë votën, e cila dihet dhe është e qartë se si është marrë.

Zoti Rama ka ndërmarrë një tur falënderues në të gjithë Shqipërinë, por ende nuk është ngjitur në Krujë. Ai e di fare mirë arsyen, sepse ka 10 vjet që politikat e kësaj qeverie e kanë shpopulluar qytetin e Krujës, i kanë larguar të gjitha institucionet nga ky qytet dhe, mbi të gjitha, nuk po bëjnë asnjë përpjekje, qoftë dhe për të ruajtur mjedisin dhe natyrën e qytetit të Krujës.

Sot, ndërsa po flasim në këtë seancë, banorët e fshatit Borizanë të Krujës janë ngritur në protestë për shkak të problemeve që kanë dhënë guroret e vëna në këtë njësi administrative. Ka 4 muaj që familjarët kanë bërë denoncime të ndryshme pranë organeve të rendit dhe nuk është marrë asnjë masë. Problemi i guroreve është kthyer në shqetësim prej 4 vjetësh për krutanët, por më i rëndësishëm për t'u përmendur është fakti që mediet nuk janë të pranishme në këtë protestë, edhe pse ne i kemi lajmëruar, gjë që tregon edhe një herë se sa e lirë është media në Shqipëri.

Nga një analizë e revistës “Monitor”, në vitin 2020 Kruja mbante rekordën për dhënien e lejeve minerare, veçanërisht për lejet për grupin e mineraleve ndërtimore, me një total prej 23 lejesh, 9 nga të cilat operojnë në Borizanë, të cilat janë akoma aktuale. Dhënia e numrit shumë të lartë të këtyre lejeve ka rritur ndjeshëm jo vetëm ndotjen e mjedisit, por ka rrezikuar rëndë jetën, shëndetin e banorëve dhe sigurinë e banesave për shkak të distancës së afërt me qendrat e banuara. Për shkak të mungesës së transparencës, personalisht, u jam drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës, Qendrës Kombëtare të Biznesit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për informacion të detajuar lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe të kontrollit të këtyre institucioneve përgjegjëse në sektorin minerar, si dhe masat konkrete të marra nga këto institucione. Ndotja e ajrit dhe e tokës në Krujë është në nivele alarmante nga çlirimi i lëndëve kimike nga fabrika e çimentos. Kryetari i Bashkisë së Krujës, sapo mori drejtimin e këtij institucioni, në mandatin e parë premtoi se ndërtimi i një *landfill*-i do të ishte primar dhe do të kishte një bashkëpunim me fabrikat e çimentos për rehabilitimin e zonave të dëmtuara të Krastës së Krujës, ndërkohë që sot puna e kësaj bashkie

ka mbetur vetëm në fazën e konsultimeve për gjetjen e një zgjidhjeje për parandalimin e ndotjeve në zonat e dëmtuara. Në vitin 2019, pas një kontrolli, ministria u hoqi lejen minerare 12 subjekteve, të cilat ushtrojnë aktivitetet minerar në zonën e shpallur “pejzash i mbrojtur natyror”, Krastë-Verion. Pavarësisht heqjes së këtyre lejeve, për të cilat nuk ka asnjë informacion, sepse mbyllen për efekte mediatike për t'u rihapur përsëri pas një periudhë të caktuar kohore, Kruja mbetet bashkia me numrin më të lartë të lejeve minerare dhe me ndotjen më të lartë si pasojë e tyre. Në Krujë, nga dhënia e lejeve pa kriter, kemi tjetërsim të habitatit natyror. Është e përcaktuar qartë që pas shfrytëzimit disavjeçar, këto kompani duhet të rehabilitojnë zonën dhe bashkë me të të kenë edhe një vlerësim të ndikimit në mjedis, por diçka e tillë nuk ka ndodhur dhe kjo duket nga pamja, po të ngjiteni në Krastën e Krujës.

Fabrikat e çimentos, guroret janë industri që kanë ndikim të madh negativ në mjedis, pasi janë industritë më ndotëse në vend. Kthejani ndonjë lek këtij qyteti nga gjithë ky shfrytëzim i pasurive natyrore, që banorët të punojnë me të vetmen gjë që u ka mbetur: turizmin. Mjedisin ua keni shkatërruar me grykësinë tuaj dhe po u gërryeni mushkëritë dhe jetën banorëve të qytetit të Krujës.

Kruja është vetëm 22 kilometra larg Tiranës dhe mbetet momenti i lavdisë kombëtare. Durimi i krutanëve është i skalitur në vështirësi të mëdha, ata dinë të mbrohen dhe të sulmojnë. Besoj se historia duhet t'ua ketë mësuar këtë, ndaj jepuni atë që u takon.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Bakiu!

Fjalën e ka zoti Petro Koçi, 5 minuta.

Të përgatitet zoti Gazment Bardhi.

**Petro Koçi** – Faktikisht, nuk do të flas për gjendjen politike, ku kulmon situata familjare në PD, ku në njërin anë është “fëmija PD”, i cili nuk di me kë të shkojë, me prindin 1 apo me prindin 2, nga ana tjetër, janë dy prindërit që zihen më njëri-tjetrin se kush do të marrë fëmijën, njëri e ka *de facto*, tjetri *de jure*, por gjithsesi është një proces shumë i rëndësishëm për shoqërinë dhe politikën shqiptare.

Unë do të flas për diçka tjetër, për arsimin.

Këto ditë kam takuar një grup pedagogësh, të cilët janë të interesuar për atë që po ndodh në Ministrinë e Arsimit, në përgatitjen e strategjisë

së arsimit. Përveç të tjerave, bëhet fjalë për teknologjinë digjitale në provime, pra për provim digjital ose *education technology* (EDTECH). Për mendimin tim, kjo teknologji garanton luftë të hapur kundër korrupsionit në provimdhënie, natyrisht, krijon edhe kushte shumë të mira, me kosto shumë më të ulët, që shkon në më pak se 70%, garanton dhënien e provimit si në klasë, ashtu dhe jashtë saj. Ka një *software*, i cili garanton që kamera të kontrollojë studentin ose nxënësin në 360 gradë, pa dyshim, teston studentin dhe pedagogun. Besoj se kjo është një teknologji sa moderne, aq dhe e aftë për t'u përgjigjur sfidave të kohës. Mendoj se, natyrisht, nuk mund të jetë e mundur të aplikohet varianti total në sistemin tonë arsimor, por kjo mund të realizohet nëpërmjet një programi pilot, siç ndodhi me zgjedhjet, kur në 2-3 bashki u aplikua votimi dhe numërimi elektronik dhe ne e pamë shumë mirë se sa lehtësira krijonte jo vetëm në administrimin e zgjedhjeve, por edhe në eliminimin e fenomenit të tmerrshëm të vonesave të mëdha në numërimin e votave.

Sistemi i provimit digjital aplikohet në shumë vende të botës, duke filluar nga SHBA-të, në Francë, në rrjetet e universiteteve katolike e të tjera dhe është i aftë që brenda një momenti të caktuar të marrë në proces 300 mijë të testuar, studentë ose nxënës. Imagjinoni çfarë lehtësirash ka! Unë e kuptoj që në ambientet tona arsimore dhe universitare mund të krijohet një lloj rezistence, sepse në përgjithësi ne jemi tradicionalë, siç jemi edhe ne të politikës kur vjen diçka e re dhe e kemi të vështirë ta përtpim apo ta tretim menjëherë. Gjithsesi, mendoj se ky është një avantazh dhe besoj se grupi i punës së ministrisë do ta marrë në konsideratë këtë propozim, sepse është një lehtësi, një avantazh i jashtëzakonshëm, sidomos ndaj luftës kundër korrupsionit dhe për krijimin e një barazie thuajse totale për çdo nxënës apo student, ndërkohë shmangen edhe shumë fenomene e debate, ku përfshihet edhe politika, si ajo e daljes së testeve të provimit para kohe; krijon shumë lehtësi në mbikëqyrjen e procesit, se nuk duhen me mijëra njerëz që mbajnë nën kontroll gjithë procesin dhe ku shpeshherë krijohen diskutime e debate. Pra, tashmë është teknologjia ajo që i garanton të gjitha këto. Vetë sistemi eliminon mundësinë e kopjimit, se kontrollon sjelljen e atij që testohet automatikisht, jo se ka ndonjë subjekt mbrapa, por

është vetë *software*-i i tillë, që i përgjigjet mundësisë për të kontrolluar dhe për të mos lejuar asnjë lloj kopjimi, përndryshe ta ndërpret procesin.

Këtë kisha si një propozim konstruktiv me grupin e punës që po harton strategjinë e arsimit e që shpresoj të merret në konsideratë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka zoti Bardhi. 10 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Erion Braçe.

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të dashur bashkëqytetarë,

Këto ditë mësuam se qeveria ka rritur tarifën e korrupsionit. Nga një tender modest prej 8 milionë lekësh i Ministrisë së Shëndetësisë kuptuam se tarifa e korrupsionit ka shkuar 40%. Kur Kryeministri i sotëm i hyri politikës, ai njihej si “*Mister 10-përqindëshi*”. Ky është një politikan, i cili e bazoi karrierën e tij te korrupsioni dhe prej 25 vjetësh nuk njeht të ndalur. Sot kemi një Kryeministër me një etje të pakufishme për pushtet. Sa më e madhe dëshira për pushtetin, aq më i madh korrupsioni. 40% vjedhin këta vetëm me një tender, por duan që populli të besojë se ky është një rast i izoluar, se këta nuk janë të gjithë kaq hajdutë sa ishte, në fakt, zëvendësja apo vartësja, bashkëpunëtorja më e afërt e ministres së Shëndetësisë.

Populli thotë se peshku qelbet nga koka dhe ka shumë të drejtë. Aty ku ka vullnet, korrupsioni luftohet me të vërtetë, as bëhet teatër e as ushtrohet presion ndaj drejtësisë.

Merrni rastin e suksesshëm të Moldavisë! Aty po ndodh një luftë spektakolare kundër korrupsionit, sepse në krye të kësaj lufte qëndron një Kryeministre e ndershme, e zgjedhur me votë të lirë, që ka frymëzuar të rinjtë, profesionistët dhe shoqërinë moldave për t'u bërë pjesë e kësaj beteje të vështirë, por Shqipëria është vite dritë larg Moldavisë.

Pas dy dekadash e gjysmë në pushtet, Edi Rama jo vetëm nuk ka bërë kurrë ndonjë gjë për të luftuar korrupsionin, por ka ndërtuar një sistem shkatërrues për demokracinë. Cili nga ju sot, kolegë të mazhorancës, do të dilte të thoshte se tarifa e korrupsionit në qeverinë tuaj nuk është 40%? E keni të pamundur t'i mohoni faktet që ka

sjellë SPAK-u për rastin e tenderit në Ministrinë e Shëndetësisë. A na mjafton neve rasti i SPAK-ut? Absolutisht jo, prandaj, në vend që ta sulmojmë, duhet ta inkurajojmë. E di që është e vështirë, e di që qeveria, Kryeministri dhe emisarët e tij janë në përpjekje të vazhdueshme për të kontrolluar drejtësinë, por s'ka asnjë shpresë tjetër konkrete që diçka në këtë vend të ndryshojë për mirë!

Korrupsioni është një çështje që prek çdo aspekt të jetës sonë, jo më kot ai zë vendin e parë në çdo sondazh dhe hulumtim të shoqërisë sonë. Mbi 80% e shqiptarëve e shohin korrupsionin si problem kyç dhe, me të drejtë, duan që kjo të ndryshojë, sepse korrupsioni përkeqëson shërbimin në sistemin tonë shëndetësor, përkeqëson arsimin e fëmijëve dhe të rinjve, mbyt të drejtat e njeriut, vë në rrezik sigurinë kombëtare, dëbon njerëzit nga atdheu i tyre, zbrax buxhetin e shtetit për të mbushur xhepat e qeveritarëve, dobëson njerëzit e zakonshëm dhe fuqizon njerëzit me pushtet dhe krimin e organizuar.

Çfarë vlere ka rritja e pagave, kur korrupsioni mbretëron në Shqipëri?

40% e taksave tuaja, të nderuar qytetarë, vidhen; 40% e pasurive kombëtare vidhen. Mos harroni, nga 10%, kur mori për herë të parë pushtetin, Edi Rama e ka çuar në 40% taksën e korrupsionit! Mendoni sa shumë kemi humbur nga korrupsioni në shëndetësi, në arsim e në infrastrukturë. Një vend kaq i vogël dhe kaq i pasur sa yni, duhet të ishte një Zvicër në zemër të Ballkanit, por korrupsioni na ndalon të begatohemi, na ndalon të punojmë në vendin tonë dhe të fitojmë me djersën tonë.

E shoh që nuk po rrini rehat në karriget tuaja, zonja dhe zotërinj ministra, e kuptoj që ju krijon alergji lufta kundër korrupsionit. Për shembull, ju mund ta ndihmoni drejtësinë drejtpërdrejt duke rrëfyer rastet në dikasteret tuaja. Për shembull, zonja Zëvendëskryeministre, sa e keni tarifën e korrupsionit në ministrinë tuaj? E keni biseduar me sekretarin tuaj të Përgjithshëm? Në pjesën e luanit të fondeve të rrugëve dhe të energjisë, ju patjetër duhet ta keni mbi 40% gjobën për çdo prokurim publik. Pyeteni dhe na e thoni!

Edhe ju, zonja Ministre e Financave, në ministrinë tuaj duhet të jeni në një garë të fortë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me Ministrinë e Infrastrukturës për të zhvatur sa më shumë nga fondet publike përmes tenderëve dhe procedurave

korruptive. Sot nuk vihet më në diskutim a merrni 40% të vlerës së tenderit, por sa më shumë se kaq merr secili prej jush. Pyeteni edhe ju sekretarin tuaj të Përgjithshëm, jo atë të arrestuarin, për normën e gjobës në tenderët në ministrinë tuaj. Nëse nuk jeni e kënaqur prej tij, pyesni sekretarin e Përgjithshëm të paraardhësit tënd.

Njerëzit e tij i lëviznin paratë e korrupsionit me thasë nga njëra shtëpi në tjetrën, derisa përfunduan në shtëpitë e sanitareve.

Zonja Ministre e Shëndetësisë, si ka mundësi që heshtët për skandalin në ministrinë e tuaj, duke mos u distancuar nga aktet korruptive të bashkëpunëtores suaj më të afërt? Ju, në fakt, dëshmoni se korrupsioni i sekretares suaj të Përgjithshme nuk është një rast i izoluar. Ju tregoni se jeni pjesë dhe i shërbeni një sistemi të kalbur nga korrupsioni. Do të ishte në nderin tuaj të jepnit dorëheqjen. Të tregoni me fakte, se nuk jeni bërë pis. Të tregoni me vullnetin tuaj të lirë dhe jo me propagandë boshe se e mbështesni drejtësinë dhe i hapni rrugë drejtësisë për të hetuar deri në nivelet më të larta, deri te ju. Por ju e humbët këtë shans. Nëse ju ngushëllon si fakt, nuk jeni e vetme. Ju mësoni nga më profesionisti në punët e korrupsionit, nga kryetari juaj legjendar, që u kap me presh në duar me aferën "McGonigal", dhe vazhdoi të sillet sikur nuk ka ndodhur asgjë! A e keni vënë re? Sa herë i shpërthen një skandal korrupsioni në nivele të larta, Edi Rama thotë: "Nuk di gjë". Nuk dinte asgjë për Saimir Tahirin, megjithëse ne ia thamë përditë për katër vjet rresht! Nuk dinte asgjë për inceneratorët, megjithëse ne prapë i denonconim çdo ditë! Me shumë gjasa nuk di asgjë as për Vangjush Dakon, i cili po hyn e po del shumë shpesh nga SPAK-u këto kohë. Faza e vjetruar e tij "Nuk bëhet mburojë për askënd", shërben vetëm sa për demagogji. Dalja nga burgu e Saimir Tahirit i rrëzoi gjithçka dhe provoi se Edi Rama është peng i korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ai është një minus i vërtetë i demokracisë sonë dhe përfaqëson një shans të humbur për mirëqenien e shqiptarëve.

Historia na ka mësuar se regjimet autoritare janë ndërtuar mbi korrupsionin. Kjo që kemi ne sot, nuk është demokraci. Kush thotë të kundërtën, gënjen veten dhe këdo tjetër. Ne nuk mund të nisim të ecim përpara, pa nisur ta luftojmë seriozisht korrupsionin. Edi Rama ka dështuar ta bëjë këtë, sepse ai i blen zgjedhjet.

Stabiliteti që ai ofron për komunitetin ndërkombëtar, është një fasadë e rreme, e ndërtuar mbi një sistem korrupsioni që gëlon në çdo qelizë të qeverisjes. Kjo duhet të ndryshojë, dhe e vetmja mundësi që të ndodhë, në mënyrë që të mos na shembet mbi kokë çatia, e ngrënë tashmë nga korrupsioni, janë zgjedhjet e lira, të pandikuara dhe të pablera me paratë e korrupsionit. Për Shqipërinë, ky është shpëtimi i vetëm.

Problemi më i madh sot në Shqipëri është se njerëzve u ka shtuar besimi se politikanët mund të ndryshojnë diçka, dhe kanë të drejtë. Diskutimi i tyre, për fat të keq, është se cila nga palët politike ka bërë më shumë korrupsion se tjetra. Humbja e besimit të njerëzve është një lajm i keq për vendin, por sot dua t'u them mijëra të rinjve dhe të rejave që mendojnë kështu se nuk kanë plotësisht të drejtë. Në këtë sallë, në fakt, nga të dyja krahët ka njerëz të ndershëm që mund ta ndryshojnë këtë situatë katastrofike për vendin dhe Shqipërinë. Në këtë sallë ka politikanë që e kanë provuar veten se nuk i dorëzohen korrupsionit. Kjo është një situatë emergjente që duhet ndryshuar dhe duhet të na bëjë të gjithë bashkë.

Ne, të dashur qytetarë, mund ta ndryshojmë së bashku me kurajë, me guxim dhe ndershmëri!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Bardhi!

Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministrja. Zonja Balluku, 10 minuta, ju lutem!

**Belinda Balluku** – Për të thënë të drejtën, unë e kam thjesht për replikë dhe nuk do t'i konsumoj as 10 minutat.

Meqenëse ishte një fjalë poetike me pyetje: “Ministrja e kësaj ministrie, ministrja e kësaj ministrie, çfarë thoni për gjobën, për korrupsionin e të tjera e të tjera?”, dua t'i përgjigjem zotit Bardhi që sekretarja ime e Përgjithshme dhe unë kemi mbi 5 vjet në detyrë, dhe besoj se me të gjitha përpjekjet që ti dhe kolegët e tu keni bërë për ta çuar çështjen në SPAK, SPAK-u, si një organ totalisht i pavarur i drejtësisë, i cili është aty për shkak të reformës që ne kemi bërë, që ju nuk jeni as të kënaqur dhe as e mbështesni, pra sa herë SPAK-u ndërmerr ndonjë veprim, jeni të lumtur, ta kishit mbështetur të paktën.

Zoti Bardhi, unë dua të pyes: sa është tarifa juaj dhe e kolegëve tuaj, që merrni nga kompanitë private, për të dërguar çështje në Gjykatën Kushtetuese, çështje të cilat bien ndesh me

interesat e këtyre kompanive dhe ju jeni ofruar bujarisht që të merrni para, pikërisht për të mbrojtur interesat e tyre në Kushtetuese? Nuk e di çfarë forme korrupsioni mund të quhet kjo, por e lartë shumë, sepse ju keni ardhur këtu me votën e popullit, jo për t'u shërbyer interesave të çdo kompanie që i prishet interesi privat! Ndërkohë, nga ana tjetër, çështjet që ju çoni në Gjykatën Kushtetuese, janë çështje të cilat kanë të bëjnë me interesin publik.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

E dini ju shumë mirë se në cilat çështje e keni çuar dhe e dini...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Unë nuk të ndërpreva! Fjalën tënde poetike, që nuk i ngrite sytë nga letra... Zakonisht, kur kemi kështu fjalë poetike, nuk ke nevojë për letër që të pyesësh ministrja filan e ministrja fistek dhe të tregosh se njerëzit e ndershëm, që janë ulur nga ky krah, duhet të kenë shansin; njerëzit e ndershëm të ulur nga ky krah duhet ta kenë shansin me votë, i dashur zoti Bardhi, se nuk e bëjmë dot me thirrjen tënde, sepse thirrja jote në vitin 2021 kushtoi jetë njerëzish në Elbasan!

*(Bie gongu.)*

Kështu, nuk e di nëse je ti personi i duhur, zoti Bardhi, për të folur këtu për etikë, për të folur këtu për korrupsion apo për të folur këtu se kush është i ndershëm dhe i pandershëm në këtë sallë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Shyqyr Zotit, nuk ka ngelur në dorën tënde dhe të asnjë tjetri këtu që të gjykohet!

Për sa i përket se kush hyn e del nga burgu, unë e di që për ty është e pakonceptueshme, por nuk është në dorën e qeverisë. Nuk merret qeveria me drejtësinë.

E di që në kohë tuaj drejtësia ishte shkopi dhe karota që ju kishit, por ne nuk kemi asnjë lidhje me drejtësinë, ndaj, kush hyn e kush del në burg, nuk varet nga qeveria. Do t'ju duhen ca vite që ta kuptoni këtë, se jeni rritur... Domethënë, keni lindur dhe jeni rritur me idenë se drejtësia është në dorën e autokratit, shefit dhe babait tuaj spiritual. Por jo, në rastin tonë nuk është. Drejtësia, për shkak të reformës në drejtësi që ka bërë Partia Socialiste dhe jo ju, është një pushtet totalisht i pavarur, që i merr vendimet duke na penalizuar edhe ne. Por, siç e thashë, shyqyr që nuk është në dorën tënde!

Unë kam pyetje, zoti Bardhi...

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*



Iu përgjigja pyetjes sate si ministre e Infrastrukturës; për sa më përket mua dhe sekretares sime të Përgjithshme 5 vjet në detyrë, çështjet i ke çuar në SPAK dhe do të vendosin ata se çfarë kemi bërë ne, por, nga ç' duket, për momentin nuk kemi bërë asgjë nga ato që thua ti!

Për ty kam pyetjen: ti që vihesh në dispozicion, pasi je zgjedhur me votat e popullit që t'u shërbesh interesave individuale të kompanive, duke çuar çështje në Gjykatën Kushtetuese, të cilat bien ndesh me interesin e publikut, me sa para paguhesh, zoti Bardhi? Kjo është pyetja ime.

**Ermonela Felaj** – Fjalën për replikë e ka kërkuar edhe ministrja Manastirliu.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Bardhi! Ju replikuat me secilën nga ministret dhe sigurisht që ato kanë të drejtën ta kërkojnë fjalën për replikë.

Kështu që, ju lutem, uluni dhe mos na ndërprisni!

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi, pa mikrofon.)*

Jo, sepse replika ka precedencë dhe nuk ka replikë mbi replikën!

Më falni, por ju dëgjuam për 10 minuta. Replikuat me më shumë sesa një ministre dhe ju dëgjova. Kështu që, secila prej tyre ka të drejtën të marrë fjalën për replikë.

Ju lutem!

Fjala për replikë për ministren Manastirliu.

**Ogerta Manastirliu** – Kam fjalën.

Faleminderit!

Pak më shumë se replikë, pa problem.

**Ermonela Felaj** – Zonja Ministre, kërkonti replikë apo fjalën, që të jemi të qartë, sepse edhe mua më duhet të menaxhoj seancën?

**Ogerta Manastirliu** – Fjalën.

**Ermonela Felaj** – Nëse keni fjalën, atëherë keni 10 minuta.

**Ogerta Manastirliu** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Qëndrimi im është i prerë dhe i qartë jo vetëm për këtë ngjarje, nga e cila si institucion distancohem plotësisht, por është qëndrimi që kemi pasur, kemi do të kemi gjithmonë për çdo rast në shkelje të ligjit, për çdo rast abuzimi me detyrën, për çdo rast të shpërdorimit të saj dhe besimit të dhënë. Cilido që shkel këto parime,

duhet të përballet me pasojat që parashikon ligji. Ky është qëndrimi im. Ky ka qenë qëndrimi dhe bindja ime që nga dita e parë që kam marrë përsipër të shërbej në funksione publike. Është pa dyshim një ngjarje e trishtuar dhe e rëndë. Organet e drejtësisë duhet të bëjnë punën e tyre. Rasti duhet të hetohet deri në fund dhe më pas, nëse del ashtu sikurse janë dyshimet, të përballet me pasojat e ligjit.

Çdo person, çdo individ, ditën që merr besimin e bashkë me të edhe detyrën e lartë në shërbimin publik, merr automatikisht edhe përgjegjësinë përpara ligjit, dhe përgjegjësia është individuale. Veprimet e askujt nuk mund ta baltosin punën dhe tërësinë e punonjësve të një institucioni. Kjo është arsyeja përse e iniciuam dhe e bëmë reformën në drejtësi. Kemi zgjedhur një rrugë, nga e cila nuk ka as kthim mbrapa dhe as kompromis: para ligjit të gjithë të jenë të barabartë; para ligjit të gjithë të përgjigjen njësoj! Unë e kuptoj që djathtas, jo të gjithë, e keni të vështirë ta kuptoni dhe ta përtypni këtë. E keni të vështirë, sepse në atë xhunglën e pushtetit tuaj, kur e kishit, kush shkelte ligjin, merrej nën mbrojtje! E keni të vështirë, sepse atëherë, kush ishte në hetim, vazhdonte të drejtonte institucione të rëndësishme financiare edhe nga shtëpia! Kush vriste, merrej dhe strehohej në institucione të larta shtetërore! Kur prokuroria vepronte, i hidheshit në fyt, i shpallnit luftë, u vinit epitete të turpshme drejtuesve.

Ndaj, sigurisht që sot nuk besoj që ju ta kuptoni dot qëndrimin tim dhe qëndrimin tonë për këtë gjë, të cilin po jua përsëris, nëse nuk e kuptuat: të gjithë të barabartë përpara ligjit! Ky është qëndrimi im, ndërsa zakoni juaj tashmë dihet. Ju doni të bëheni, e keni treguar këtë dhe e tregoni vazhdimisht, edhe prokurorë, edhe gjykatës, edhe avokatë në çdo ngjarje. Ju doni ta bëni këtë rol dhe doni ta vërtisni, sigurisht, politikisht, sepse kështu ju intereson. Por, falë Zotit, sot kemi drejtësi, kemi organe drejtësie të pavarura, të cilat, ndryshe nga ju, unë i respektoj dhe për këtë, fjalën e fundit e thotë drejtësia!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Manastirliu!

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi pa mikrofon.)*

Zoti Bardhi, ju replikuat në fjalën tuaj dhe morët përgjigje nëpërmjet fjalës së ministreve,

koha e fjalës së të cilave llogaritet në kohën e përgjithshme të grupit. Kështu që përgjigjen që ju doni të jepni, të cilën nuk e jepni dot, sepse nuk jua lejon Rregullorja, le ta vijojë një kolegu juaj që ka radhën për të folur. Unë do t'ia jap fjalën një kolegut tuaj për të bërë harmonizimin e radhës së fjalës.

Kështu që, zoti Sula, në fakt...

*(Deputeti Bardhi ndërhyr pa mikrofon.)*

Jo, nuk ka replikë mbi replikën, ju lutem! Brenda fjalës që ministret kishin të drejtë të mbanin, bënë replikë. Zoti Bardhi, fjalën do t'ia jap zotit Sula për të respektuar Rregulloren.

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi pa mikrofon.)*

Ju lutem, nuk ka një rregullore të tillë që deputetët i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe pastaj lejohen të japin edhe përgjigje. Në qoftë se do të kishte një rregullore të tillë, unë do ta zbatoja me shumë kënaqësi, por nuk ka.

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi pa mikrofon.)*

Ju lutem, zoti Bardhi, ju e dini më mirë sesa unë që nuk ju takon fjala për replikë!

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi pa mikrofon.)*

Nuk ju takon fjala për replikë, zoti Bardhi, tani! Po i përmendët ju më së pari, prandaj ka vendosur Rregullorja ndalim.

*(Deputeti Bardhi flet nga vendi pa mikrofon.)*

Ju lutem, mos e pengoni zhvillimin e seancës!

Besoj se është krejt e qartë.

Fjalën e ka zoti Sula.

*(Debate në sallë)*

Zoti Sula, do ta merrni fjalën, ju lutem?

*(Debate në sallë)*

Ju lutem, ju po konsumoni kohë fjalë pas fjale me njëri-tjetrin, por seanca nuk është për këtë gjë. Seanca është për diskutime, për çështje që lidhen me zgjedhësit.

Ju lutem, zoti Sula, afrohuni!

*(Debate në sallë)*

Në rregull.

Zoti Braçe e ka fjalën.

*(Debate në sallë)*

Zoti Bardhi, ju lutem, uluni!

*(Debate në sallë)*

Pikërisht se po respektoj Rregulloren, nuk mundem t'jua jap fjalën. E vetmja gjë që mund t'i

kërkoj teknikës, është që të ketë kujdes për të llogaritur kohën. Kështu që, me ndërhyrjen e dy ministreve, koha e përcaktuar për diskutantët e tjerë të grupit të PS-së do të zvogëlohet.

Zoti Braçe, 7 minuta.

*(Debate në sallë)*

Ju lutem, mund t'ia jepni jashtë kësaj salle, por jo këtu!

Zoti Braçe...

*(Debate në sallë)*

Më fal, unë të thirra disa herë dhe nuk erdhe.

Si ta bëj unë këtë gjë? Si ta vazhdojmë këtë gjë? Si ta zgjidhim këtë gjë tani? Dikush mendon se ka të drejtë të ngulë këmbë dhe të marrë përpara 140 deputetë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Jo, nuk keni të drejtë. Po të kishit të drejtë, do ta kishit marrë. Kërkuat vetë të replikonit dhe morët përgjigje.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem! Ju duhet t'i përgjigjeni asaj që drejtuesi i seancës thotë gjatë diskutimit.

Ju lutem, zoti Sula, për respekt të kolegut!

*(Debate në sallë)*

Ju lutem, Garda, nuk ka nevojë, sepse nuk ka asnjë konflikt mes dy deputetëve.

*(Debate në sallë)*

Zoti Sula, nuk jua hoqa të drejtën e fjalës, por ju po hezitonit.

Megjithatë, zoti Braçe, keni mirëkuptimin ta lini zotin Sula të flasë përpara jush?

**Erion Braçe** – Po, patjetër! Me një kusht, që të mos qajë.

**Ermonela Felaj** – Tani, kush do të flasë?

Merre fjalën, zoti Sula, ju lutem!

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

**Ermonela Felaj** – 5 minuta.

**Dashnor Sula** – Sigurisht, në këtë parlament çfarë nuk mund të presësh. Pa diskutim që ngjarjet kështu do të vazhdojnë, se juve ju ka kapur mania për të kontrolluar gjithçka, doni gjithçka dhe mund të merrni gjithçka, por keni një gjë parasysh: të gjithë jemi të vdekshëm në këtë dynja. Asnjëri nuk do të rrojë 500 vjet, 400 vjet apo 300 vjet. Do të vijë një orë që të gjithë do të japim llogari përpara Zotit, në radhë të parë dhe përpara qytetarëve shqiptarë, pa diskutim. Çështje kohe është.

Doli ministrja e Shëndetësisë këtu? Po. Le të flasë pa letër ministrja e Shëndetësisë, por del

flet me letër, siç është e shkruar dhe thotë vetëm një fjalë.

Po ti distancoheshe përpara se të arrestohesh, zonja Ministre! Ju të gjithë distancoheni pasi hyjnë në burg. Keni krijuar një grup parlamentar brenda në burg me deputetë, me ministra, me drejtorë, sa të duash. Tani keni gjetur një slogan: “Jo, po ne i kemi dorëzuar”. Kur i dorëzoni ju? T’i dorëzoni para, jo kur kapen. Po pse nuk kapen nga opozita? Deri dje, a ishte kjo opozitë mazhorancë? E paskemi pasur ne drejtësinë?! Epo, kështu nuk shkon! Nuk shkon kështu!

Mua më vjen keq për të gjithë kolegët e mi këtej, se janë të gjithë njerëz të nderuar. Singërisht, nuk e them për propagandë. Për disa nuk më vjen keq fare, madje po e them prapë: ai SPAK-u që ka nisur hetimin, duhet t’i shtojë hapat përditë dhe duhet ta çojë gjënë më tutje, sepse këtu çfarë s’po ndodh. Këtë e dimë të gjithë. Shkoni kontrolli tenderët nëpër bashki! Shkoni kontrollojini nëpër drejtoritë tuaja, ku nuk janë kryer punë fare! E dini fort mirë që nuk janë kryer punë fare, por në momentin kur ata njerëz arrestohen, ju thonë: “Ikëm ne”.

Megjithatë, Zoti ju dhëntë mendje! Çfarë t’ju themi më shumë!

Zonja drejtuese e seancës, sigurisht, problemet janë jashtëzakonisht të mëdha në të gjitha zonat që kemi ne. Ju edhe kohën e ndani në mënyrë të tillë, që ju të keni më shumë kohë, se keni më shumë halle sesa ne të opozitës, pasi kujtoni që përfaqësoni më shumë njerëz dhe më mirë. Ju jeni të kënaqur. Merrini bashkitë! Mirë bëtë që i morët, por t’i kishit marrë të gjitha bashkitë. Merrni gjithçka, lini vetëm një parti, mbani një mbretëri dhe pastaj të jeni të kënaqur, kaloni prapë para ’90-s! Por kjo nuk është rruga e duhur.

Duhet të jemi alarmantë në lidhje me atë që thotë OKB-ja, që do të jemi kombi më i plakur, do të jemi vendi me moshën më të madhe, do të jemi vendi që do të kemi më pak njerëz. Nuk kam nostalgji, e kam thënë edhe një herë tjetër, për atë regjim, por ai regjim, të paktën, e çoi në 4 milionë e gjysmë njerëz vendin, ndërsa ju po e çoni në 800 mijë, po e zbrisni mbrapsht. Këto janë problemet e përditshme që kemi ne. Pa diskutim pastaj janë edhe problemet e zonave.

Ministrja e Bujqësisë nuk është këtu, por në zonën e Peqinit, në ish-komunën Shezë dhe në ish-komunën Gjocaj, 80 hektarë pjeshka ikën, u

shkatërruan nga breshëri dhe ju nuk u jepni asnjë lek fermerëve. Zonja Ministre e Bujqësisë, në qoftë se na ndjek, po ju them se në të gjithë Bashkinë e Peqinit, në të gjithë zonën e Peqinit, vetëm 15 fermerë kanë aplikuar për të marrë subvencionin për bagëtitë e imta dhe lopët, sepse nuk i plotësojnë dot kriteret dhe numrat që keni vendosur ju. Numrat dhe kriteret që ju keni vendosur janë që duhet të kesh 100 kokë dele, duhet të kesh 100 kokë dhi, duhet të kesh 10 lopë, duhet të kesh 50 koshere bletësh. Po më gjeni një fshatar që të ketë 10 lopë! Jo, 1 ose 2 lopë mund të mbajë fshatari, ndërsa ju thonë: “Jo, duhet të kesh mbi 10 lopë”. Ju thonë se po të kesh 99 kokë dele, përsëri nuk merr subvencione. Këto janë kushtet dhe rrethanat që keni vendosur ju.

Jeni e vetmja qeveri, që kur u bë rialokimi i fondeve më datën 23 dhjetor të vitit të kaluar, dhatë vetëm 1,5 milionë euro për bujqësinë, në një kohë kur 125 milionë euro i kaluat për fondin e rindërtimit. E kam thënë edhe herë tjetër, në bashkitë e Rrogozhinës dhe të Tiranës, u keni dhënë për herë të pestë para atyre që, gjoja, ndërtuan shtëpitë e prishura. Të verifikohen ku janë! Vetëm e vetëm, për të blerë votuesit. Kjo është situata.

Merrni vetëm dy pika referimi, Kosovën dhe Maqedoninë! A e dini, zonja Ministre e Bujqësisë, që Kosova vetëm për këtë vit ka dhënë 100 milionë euro subvencione për bujqësinë, për të gjithë fshatarët? Ndërkohë që Maqedonia këtë vit arrin në 200 milionë euro ndihmë për bujqësinë, në një kohë kur ka lançuar edhe një nismë duke i dhënë çdo bujku të ri, çdo fermeri të ri 10 mijë euro ndihmë për mjetet bujqësore, çka do të thotë se ato para janë të parikthyeshme. Ndërkohë, ju këtu jepni para vetëm, gjoja, nëpërmjet fondit të AZHBR-së, të cilat dihet se kush i merr, 10, 20 apo 50 veta, ndërsa pjesa më e madhe e fshatarëve dhe fermerëve nuk marrin para.

Të jeni të sigurt, se me politikën që po ndiqni, fshatrat braktisen çdo ditë. Të jeni të sigurt se brenda 4-5 vjetëve nuk do të ketë më njerëz për të punuar tokën nëpër fshatra. Njerëzit ikin më mirë në Greqi për 3 apo 4 muaj ose në Jugun e Italisë dhe sjellin para, se kanë punuar edhe për 8 muajt e tjerë.

Ky është realiteti. Kjo është e vërteta. Ky duhet të jetë shqetësimi dhe jo të na bëni moral, kush jemi ne dhe kush jeni ju. Jo, more, jo, të gjithë, nga i pari deri tek i fundit, nëse ka

problemin më të vogël, mund të hetohet, se ne jemi më të pambrojturit. Ju jeni të mbrojtur, me ministra, me Kryeministër, me qeveri, me parlament, me Gjykatë Kushtetuese, sepse Gjykatën Kushtetuese...

**Ermonela Felaj** – Përfundoni, ju lutem!

**Dashnor Sula** – E mbylla. Më falni!

E akuzove zotin Bardhi, duke i thënë: “Interesa të kujt”? A e di se çfarë është zoti Bardhi? Proletar është. Nënë ka dhe një shtëpi. Kaq ka ai njeri. Po ju? Vendimi i Gjykatës Kushtuese ka urdhëruar shfuqizimin e bordit të naftës e të karburanteve dhe ju e mbani. E dini pse e mbani? E mbani, sepse kompania ku ju keni interesa, nuk bën xhiro të naftës. Këtë e dimë të gjithë. Shfuqizojeni bordin e karburanteve! Nuk e shfuqizoni. Shfuqizojini ndërtimet pa leje, katet pa leje! I keni bërë presion Gjykatës Kushtetuese. I dimë fort mirë këto gjëra ne, se këtu jetojmë dhe i njohim njerëzit, se i kemi kolegë. Kjo është e vërteta.

Ju lumtë! Por do të vijë dita që edhe ju do të dorëzoheni.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sula!

Fjalën e ka zoti Braçe.

Të përgatitet zoti Mediu.

7 minuta për zotin Braçe.

**Erion Braçe** - Faleminderit, drejtuese e seancës!

Në këtë sallë, hëm të qash, hëm të shash, të bën deputet. Mua më vjen mirë për një gjë të paktën që, më në fund, në këtë sallë po flitet për vendime gjykatë. Më në fund, në këtë sallë po flitet për të korrumpuar, të cilët patjetër janë mes nesh, por që arrestohen. Me thënë të drejtën, nga viti 2005 deri në vitin 2013, nuk gjen një ministër të arrestuar, nuk gjen një zëvendësministër të arrestuar me përjashtimin të njërit që ishte demokristian, nuk gjen një drejtor të arrestuar me përjashtim të njërit që ishte me LSI-në, a thua se në atë kohë nuk vidhte askush. Të gjitha këto që thoni sot, për atë kohë janë të rreme. Ah, për luftë të brendshme këto funksionuakan, por për drejtësi, nuk funksionuakan! Paskan qenë të ndershëm, të gjithë të asaj kohe!

Dhe meqenëse dëgjova këtu pak më herët një kolege të fliste për fabrikat e çimentos, patjetër që duhet bërë edhe ajo që thotë kolegia, por, a e dini që atyre fabrikave të çimentos (këtu kishte arritur niveli i korrupsionit) lejet e shfrytëzimit për guroret, në funksion të tyre, u janë dhënë me

ligj në parlament? Çdo gurore e mundshme është mbyllur në Krujë nga ato që ishin me ligj, me vendim qeverie, apo me vendim ministrie. Ndërkohë, të gjitha guroret që janë me ligj parlamenti, të bëra këtu, një vit para se të iknit nga pushteti, të votuara në parlament, një vit para se të iknit nga pushteti, janë bërë me ligj parlamenti. Keni vullnet? Prishini! Pse nuk i prishni?

Ah, Dashi e di këtë!

Në rregull. I di Dashi këto. Këtë e keni të qartë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, patjetër, kur nuk na pëlqen, janë të atyre, kur na pëlqen, jemi bashkë. E di si është puna, Dashi? Janë pjekur të gjallë njerëzit, Dashi, dhe nuk ka mbajtur përgjegjësi askush. Janë vlarë njerëz në mes të bulevardit dhe tani thua: “Do të vrisnim edhe të tjerë”, dhe prapë nuk është përgjigjur askush. Shyqyr që ia arritëm ditës, që edhe për 350 mijë lekë të përgjigjet një njeri atje dhe të mbajë përgjegjësi deri në fund, por distancimin ta fillojmë nga vrasjet, Dashi, se ai është problemi më i madh, kur i merr jetën tjetrit. Ia ka falur Zoti jetën. Si the ti? Do të përgjigjemi para Zotit, apo jo? Ia ka marrë rob jetën, nuk ia ka marrë për ligj, ia ka marrë për qejf, për të ndenjtur në pushtet. Kaq e thjeshtë është.

Megjithatë, kërkoj ndjesë, që ju mora kaq shumë kohë për gjëra kaq të parëndësishme, por do të flas për disa gjëra më të rëndësishme.

Indeksi i çmimeve për muajin maj, indeksi më i rëndësishëm botëror i ushqimit, i FAO-s, bën me dije se çmimet në muajin maj, në raport me prillin e po këtij viti, ranë me 2,6%, ndërkohë në raport me nivelin më të lartë të tyre të marsit të vitit 2022, kanë rënë 22,1%. Po e përsëris edhe një herë: çmimet e ushqimeve rreth e qark nesh, në të gjithë botën, referuar indeksit të FAO-s kanë rënë me 22,1%.

Ndërkohë, çmimet e drithërave, në raport me prillin e këtij viti, ranë me 4,8% në muajin maj dhe në raport me nivelin më të lartë të një viti më përpara, të marsit të vitit që shkoi, kanë rënë me 25,3%.

Çmimet e vajrave vegjetale, ku hyjnë të gjitha, vaji i lulediellit, i sojës dhe vaji i palmës, kanë rënë gjatë muajit maj në raport me prillin me 8,7%, ndërkohë që me nivelin më të lartë të një viti më përpara, pra të marsit kur filloi lufta, kanë rënë me 48,2%.

Çmimet e të gjitha produkteve të bulmetit, përfshirë ato të qumështit, kanë rënë gjatë muajit maj në raport me prillin me 3,2% dhe në raport me nivelin më të lartë të një viti më përpara me 25,5%, pra edhe të bulmetit.

Çmimi i mishit, gjithashtu, ka rënë me 1% nga muaji prill dhe me 5% në raport me nivelin më të lartë të një viti më përpara. I vetmi produkt që ka pësuar rritje çmimi është sheqeri.

Ky është fakt dhe tabelat janë këto, këto janë kurbat e çmimeve, të gjitha janë poshtë dhe janë më poshtë sesa niveli i një viti më parë. Kam një pyetje për të gjithë ata që na ndjekin dhe që bëjnë pazar: Keni verifikuar që çmimi i vajit të lulediellit të ketë rënë me 48,2%? Keni verifikuar që çmimi i bukës të ketë rënë me aq për qind sa ka rënë edhe çmimi i drithërave në tregjet ndërkombëtare, për sa kohë që ne jemi importues? Jo. Keni verifikuar që çmimet e të gjitha produkteve të tjera të fabrikua, që veç efektit të çmimeve ndërkombëtare kanë edhe një efekt plus në territorin e Republikës së Shqipërisë, rënien e kursit të monedhës, pra forcimin e lekut dhe zhvlerësimin e monedhës me të cilën kryhen këto importe, të kenë rënë me kaq për qind? Jo. Atëherë, unë mendoj se më e rëndësishme sesa të shahemi këtu, sesa të shpifin dhe të akuzojmë këtu dhe sesa të tregojmë me gisht gjithsecilin, është ta bëjmë ekonominë të funksionojë, t'i bëjmë tregjet të funksionojnë, sepse ata që janë atje matanë kanë nevojë të ushqehen me cilësi të mirë dhe me çmim të lirë. Për sa kohë që çmimet në tregjet ndërkombëtare po bien, e rëndësishme është që ato të reflektohen në çmimet me të cilat qytetarët e këtij vendi blejnë produktet e tyre për t'u ushqyer në harkun e një muaji.

Shqetësimi i dytë që kam lidhet me një fakt shumë të rëndësishëm, të cilin e kam paralajmëruar në këtë sallë dhe kudo, që në muajin shkurt, që ka të bëjë me infektimin e tokave bujqësore në Myzeqe. Është një problem shumë i madh që, edhe vjet, edhe këtë vit nuk po i lejon bujqit të merren me një cikël tjetër prodhimi. Askush nga Plugu, në Sopës, në Sektor, në Ferras, në Grabian, në Tërbuf e deri në Çermë-Sektor nuk po mbjell sot për shkak të karkalecit të tokës. Nëse e mbjell sot bimën, e ha karkaleci të nesërmen dhe kur them "nesër", është fiks të nesërmen. Kaq e rëndë është gjendja.

Që në muajin shkurt fola në parlament për këtë situatë, me qëllim që ministria përgjegjëse të

mernte masa, por sot verifikoj faktin sa e parëndësishme është të jesh deputet, të merresh me hallet e njerëzve dhe të flasësh këtu në sallën e Kuvendit dhe se sa i zhvlerësuar bëhet gjithsecili prej nesh kur shkon atje për të folur me njerëzit, për sa kohë që askush nuk reflekton të dëgjojë në radhë të parë, por vazhdon historia që kur ti ngre një problem, merren me ty dhe jo me hallin e njerëzve.

**Ermonela Felaj** - Përfundojeni, ju lutem!

**Erion Braçe** – Dakord.

Ka një shprehje nga një film se çfarë duhet t'i bëhet bahçes në këtë moment, por, për fat të keq, ka ende kohë që gjithsecili të shikojë veten në raport me detyrën.

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zoti Mediu, 3 minuta në dispozicion. Të përgatitet zonja Lindita Buxheli.

**Fatmir Mediu** – E nderuar, zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kolegu im i opozitës tha se në këtë vend nuk ka demokraci. Që të ketë demokraci, si fillim duhet të kemi një republikë kushtetuese. Që të kemi republikë kushtetuese na kërkohet, po ashtu, ta kthejmë në një republikë parlamentare, sepse të tillë e kemi përcaktuar, por që të kemi republikë parlamentare, duhet të kemi zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Ky vend nuk është as republikë kushtetuese, as republikë parlamentare, por thjesht një republikë kryeministrale, prandaj, më shumë se për çdo gjë tjetër, ka nevojë për një reformë të thellë kushtetuese, që parimi i kontrollit dhe i balancimit të pushtetit të funksionojë në shërbim dhe në interes të qytetarëve.

Zgjedhjet e 14 majit treguan qartë se nuk ka zgjedhje të lira dhe të ndershme, por unë kam një thirrje për kolegët e mi të opozitës: duhet t'i shikojmë të vërtetat ashtu siç janë dhe jo siç na pëlqejnë! Këto vite ne kemi shkatërruar vetveten dhe mazhoranca ka shkatërruar sistemin tonë kushtetues, kemi marrë vendime absurde deri dhe idioteske, kemi pasur sherre pa kuptim me njëri-tjetrin, mbyllje dhe mediokritet, që nuk vlejnë as për ne dhe as për shqiptarët. Në qoftë se nuk do të kalojmë vetveten dhe t'ua kthejmë opozitën shqiptarëve, duke krijuar një të djathtë me ide të qarta dhe me njerëz kualitativë, ne nuk jemi duke përmbushur detyrimin tonë.

Si opozitë, detyrë të parë kemi garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, prandaj të gjithë si fillim duhet të kërkojmë me një qëndrim të vetëm mbledhjen sa më parë të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ta fillojmë nga reforma zgjedhore, nga sistemi zgjedhor që ka vuarë parlamentarizmin në Shqipëri. Le të shikojmë mundësinë për një sistem proporcional kombëtar me lista të hapura, ku gara dhe qytetarët të vendosin kush do të jenë deputetët dhe jo kryetarët e partive. Ato janë primaret e vërteta. Po ashtu, t'u japim mundësi njerëzve të talentuar, të jashtëzakonshëm, që jetojnë në diasporë, që jo vetëm të votojnë, por edhe të konkurrojnë dhe të bëhen pjesë e qeverisjes dhe e politikës shqiptare. Kualitetet e tyre janë të padiskutueshme dhe mentaliteti i tyre është krejt ndryshe nga ky që diskutojmë ne në Kuvendin e Shqipërisë.

E djathta, të nderuar kolegë të opozitës, nuk është pazar, por ide, që vlerësojnë në radhë të parë vlerat, individin, familjen, biznesin dhe pa dyshim edhe besimin.

Të nderuar kolegë të opozitës, po vazhduam kështu, zelli dhe dashuria për udhëheqësin do të na lërë pa shqiptarë.

Çështja e dytë, për të cilën dua të flas, ka të bëjë me Kosovën. Të flasim për Kosovën nuk na bën patriotë. Rruga e vetme për ta mbështetur Kosovën nuk është të mbajmë qëndrimet tona sikur flasim për një vend të huaj. Ata janë bashkëkombësit tanë dhe përpara çdo marrëdhënieje tjetër, ata janë të parët. Po ashtu, duhet të koordinojmë veprimtarinë tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Britaninë e Madhe, me NATO-n dhe me BE-në. Ne, shqiptarët, që jemi vend anëtar i NATO-s, duhet të ndërtojmë boshitin e Aleancës së Atlantikut në Ballkan për të gjitha elementet politike dhe ushtarake. Deklaratat kundër njëri-tjetrit vetëm na bëjnë akoma edhe më absurdë.

Dua të flas, gjithashtu, edhe për një çështje të tretë, të cilën po e mbyll me një fjali të vetme.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, BE-ja, partnerët tanë, në mënyrë të vazhdueshme ngrenë shqetësimin për penetrimin dhe influencën e Ruisë dhe Kinës në rajonin e Ballkanit. Është detyrë e këtij Kuvendi të marrë një iniciativë të përbashkët bipartizane për të analizuar se deri ku shtrihet kjo influencë dhe të mos mjaftohemi vetëm me këndvështrimin sipërfaqësor se ne nuk kemi marrëdhënie të tilla. Ka dhe duhet t'i

analizojmë, ka politika që duhet t'i ndërtojmë, ka ligje që duhet t'i miratojmë, për të mos lejuar që bizneset dhe ekonomitë e tyre të penetrojnë në vendin tonë, duke cenuar sigurinë dhe marrëdhëniet tona me partnerët.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zonja Buxheli, 5 minuta në dispozicion. Të përgatitet zoti Agron Duka.

**Lindita Buxheli** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Java që lamë pas ishte e dedikuar për zgjedhësit, por, në fakt, bashkë me kryetarët e bashkive gjatë një muaji ne u ballafaquam me ta në çdo lagje dhe në çdo derë.

Në fakt, një vit më parë Lushnja ishte ndër ato bashki që iu drejtuan zgjedhësve për të marrë votëbesimin e tyre. Askush në Lushnjë nuk e besonte kur të gjithë ne, bashkë me Taulant Ballën, u premtuam banorëve rehabilitimin e përroit të qytetit, një gangrenë 32 - vjeçare. Ejani sot në Lushnjë dhe shikojeni! Gjatë kësaj "Jave të gjelbër" vumë re se punimet për rehabilitimin e përroit të qytetit kanë avancuar dhe vazhdojnë çdo ditë për të arritur në destinacion.

Një vit më parë 700 nxënësve të shkollës "Skënder Libohova", e cila ndodhet në qendër të qytetit, iu premtua rehabilitimi i godinës. Sot shkolla "Skënder Libohova" po rikonstruktohet dhe nxënësit e saj në vitin e ri shkollor do të mësojnë në kushte të mrekullueshme.

Po kështu, një vit më parë lushnjarëve iu dha fjala nga Kryeministri Rama për rehabilitimin e unazës së qytetit, e cila kishte 32 vjet pa u rikonstruktuar. Sot kanë përfunduar procedurat e tenderimit të unazës së qytetit, është shpallur fituesi dhe pritet fillimi i punimeve, gjë që do t'u japë zhvillim bizneseve dhe familjeve rreth kësaj zone.

Po kështu, një vit më parë të gjithë prindërve që kanë fëmijët në kopshtet dhe çerdhet nr. 2, 3 dhe 4, iu premtua rikonstruksioni i këtyre godinave. Sot, një vit më pas (këtë e vumë re edhe gjatë kësaj "Jave të gjelbër"), fëmijët e çerdes nr.1 edukohen në kushte mjaft të mira. Po kështu, kopshtet nr. 1 dhe nr. 4 janë rikonstruktuar dhe ndërkohë vazhdojnë punimet për rikonstruksionin e kopshtit nr. 3.

Festën e fëmijëve këtë vit e festuam së bashku në shkollën e Karbunarës së Madhe

“Hysen Xheka”. Shqetësimi që m’u drejtua nga banorët e kësaj zone ishte rikonstruksioni i kësaj shkolle, e cila është ndërtuar në vitet ’70, që Karbunara e Madhe, një vend arsimdashës, e meriton.

Po kështu, nga 26 pika grumbullimi që janë në qytet, gjatë kësaj jave kam vizituar 4-5 prej tyre. Dua të them se projektligji që ne miratuam të gjithë këtu në parlament, me iniciativën e deputetit Braçe, ka zënë vend dhe sot fermerët likuidohen brenda aftit 60-ditor që ne miratuam. Kjo i jep fermerit frymëmarrje dhe liri nga ana financiare për t’u paraprirë mbjelljeve të sezonit të ardhshëm. Lajmi i mirë, gjithmonë i lidhur me këtë gjë, është se eksportet në Bashkinë e Lushnjës për katërmujorin janë rritur me 20% krahasuar me një vit më parë.

Për ta mbyllur me bujqësinë, gjatë këtij muaji në qendër të qytetit të Lushnjës, u zhvillua panairi tregtar, që është bërë traditë tashmë, me biznese të bujqësisë dhe të blegtorisë nga vendi, rajoni e më gjerë, të cilët shkëmbyen eksperiencën me njëri-tjetrin, lidhën kontrata, gjë e cila u jep mundësi zhvillimi për të rritur ekonominë e tyre dhe ekonominë kombëtare.

Shumë faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Buxheli!

Fjalën e ka deputeti Isuf Çelaj, 5 minuta në dispozicion.

**Isuf Çelaj** - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë të Tropojës,

Të nderuar kolegë,

Problematikat dhe hallet e qytetarëve të Tropojës janë të shumta, pasi ju u vodhët votën duke blerë varfërinë e tyre.

Sot jam përpara jush për të ngritur dy shqetësime shumë të mprehta të atyre banorëve, të cilat i kam ngritur edhe herë të tjera nga kjo foltore, por që deri tani kanë rënë në vesh të shurdhër të kësaj qeverie.

Problematika e parë ka të bëjë me mungesën e investimeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes për furnizimin me energji elektrike të fshatrave të Luginës së Valbonës, zona më e bukur dhe piktoreske e alpeve shqiptare, ku numri i turistëve vendas dhe atyre të huaj ka ardhur në rritje nga viti në vit dhe veprimtaria e vetme për sigurimin e të ardhurave për familjet e këtyre fshatrave është turizmi.

Është detyrë e qeverisë t’u sigurojë kushte për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, ku më kryesorja është furnizimi me energji elektrike 24 orë gjatë gjithë vitit për këta banorë, e cila nuk është siguruar, megjithëse ata i paguajnë rregullisht faturat e majme të energjisë elektrike. Linjat janë investime të vjetra e të shkatërruara. Zona prodhon energji, por energji nuk ka.

Dy herë është shpallur procedura nga OSHEE-ja dhe në të dyja herët është anuluar me justifikimin se gjoja nuk ka fonde, nga thatësira apo nga situata energjetike në vend. Ky veprim është një diskriminim i pastër që kjo qeveri u bën këtyre banorëve. Investimet private në hotele dhe në bujtina po shtohen nga viti në vit, prandaj nevoja për investime serioze në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike është urgjente, pasi nuk mund të bëhet turizëm me gjenerator.

Thirrja ime e ripërsëritur shkon për zëvendëskryeminstren Balluku dhe drejtuesit e OSHEE-së, që të finalizohet me urgjencë procedura për furnizimin me energji elektrike të fshatrave të kësaj lugine, si: Klysyre, Dragobi, Valbonë, Rrogam i Shalës e Çerem, pjesë e bukurive natyrore e turistike të Luginës së Valbonës.

Problematika tjetër ka të bëjë me gjendjen shqetësuese në të cilën ndodhen drurët e masiveve të gështenjës në Malësinë e Gjakovës. Sivjet, në masivet e pyjeve të gështenjës është shfaqur një insekt dëmtues shumë i rrezikshëm i quajtur “grerëza aziatike”, që shkakton rënien e prodhimit me 80%, duke i shkaktuar qytetarëve të këtij komuniteti një dëm ekonomik deri në 7-8 milionë euro në vit në të ardhurat që sigurohen nga prodhimi i frutit të gështenjave, mjaltit dhe lëndës drusore për mobilieri.

Deri tani, metoda më e efektshme për të luftuar këtë insekt shkatërrues të gështenjës është ajo e kontrollit biologjik të grerëzës aziatike, që konsiston në instalimin e insektit, një agjent i suksesshëm i kontrollit biologjik të grerëzës. Për këtë kërkohet angazhimi i Ministrisë së Bujqësisë për sigurimin urgjent të këtyre insekteve nga jashtë, për shembull nga Italia, që të bëhet i mundur luftimi me sukses i kësaj sëmundjeje, duke qenë se fshatarët vetë e kanë të pamundur ta bëjnë këtë gjë.

Tropoja ka gjithsej rreth 2800 hektarë masivë me gështenja, nga këto 2410 hektarë kanë

qenë administruar nga ish-ndërmarrjet bujqësore, të ndodhura në fshatrat Gegëhysen, Gri, Bujan, Markaj, në zonën e Gashit, si edhe afro 400 hektarë në Lekbibaj, Shipshan, Dushaj i Epërm dhe Demaliaj-Pac. Në vitin 1968, nga qeveria moniste, sipërfaqja prej 2410 hektarë është transferuar nga fondi i kadastrës pyjore dhe i ka kaluar në administrim ish-ndërmarrjeve bujqësore, dhe është përfshirë në fondin e drurëve frutorë. Nga ai vit e deri më sot, kjo sipërfaqe nuk është e regjistruar në regjistrin e pronave të shtetit në asnjë nga llojet e pronës. Kështu që, duke qenë pronë informale, pa status pronësie, pa administrim dhe mbrojtje shtetërore, është bërë objekt dëmtimesh dhe zjarresh të përvitshme. Ky burim natyror historikisht ka qenë pronë private derisa është shtetëzuar nga qeveria moniste dhe në vitin 1991 u la në rrugë të madhe, i braktisur, në vend që t'i transferohej ish-komunave (pushtetit vendor).

Sot të gjitha sipërfaqet pyjore, pjesët shkëmbore, sipërfaqet e zhveshura, si edhe kullotat janë të regjistruara dhe administrohen nga shteti dhe kanë një punonjës pyjesh që përgjigjet për to, por gështenja jo. Asnjë fermer nuk ka certifikatë pronësie për kashnjetin e tij. Roli i shtetit shqiptar është të menaxhojë burimet natyrore të vendit, të kontrollojë, të administrojë, të drejtojë, të menaxhojë burimet natyrore të nëntokës dhe të mbitokës shqiptare dhe t'i vejë ato të ardhura në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Qeverisja qendrore dhe vendore kanë për detyrë të hartojnë planin e menaxhimit, ta regjistrojnë këtë pasuri në regjistrin themelor të pronave të shtetit dhe çdo fermeri t'i japin certifikatën e pronësisë për pronën e tij. Qeverisja vendore ka detyrim kushtetues për të rehabilituar masivet e dëmtuara.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj-** Faleminderit, zoti Çela! Fjalën e ka zoti Ramadan Likaj, 5 minuta në dispozicion. Të përgatitet zoti Xhemal Qefalia.

**Ramadan Likaj-** Të nderuar kolegë,  
Të nderuar qytetarë,

Pas fushatës që lamë pas, e zhvilluar në një situatë jo normale, jo të barabartë, edhe javën që kaluam, edhe sot, kërkesat e qytetarëve tanë vazhdojnë të jenë po të njëjtat. E vërteta është se ne duhet ta kuptojmë, siç e thanë dhe disa parafolës, që jemi përfaqësues të qytetarëve tanë dhe duke qenë përfaqësues të tyre ne duhet të

paraqesim në këtë parlament problemet dhe hallet e tyre.

Ndaj ju bëj thirrje edhe kolegëve të tjerë, të mos dalin këtu të procedojnë me format e tyre, duke bërë politika të mëdha, për sa kohë zgjedhësit nuk i njohin fare. Është gjëja më e mirë që çdo deputet t'i kthehet zonës së tij elektorale, të marrë kërkesat dhe të dëgjojë hallet e popullit të zonës së tij dhe, madje, asnjë moment më tej nuk duhet humbur kohë.

Problemet që unë do të paraqes sot në këtë seancë, nuk janë të panjohura, përkundrazi janë të njohura dhe të ripërsëritura. Një zonë administrative e Malësisë së Madhe, e quajtur Gruemirë, është një zonë e mrekullueshme që merret qëkur me kultivimin e duhanit, një duhani të një cilësie të shkëlqyer. Ata më thonë se për vite me radhë, çmimi i duhanit që ata prodhojnë, është në rënie drastike. Nëse para disa vitesh çmimi i duhanit ishte 11 mijë lekë të vjetër për kilogram, sot çmimi i duhanit ka zbritur në 3 mijë lekë, dhe më e keqja është se, as kaq nuk ia merr njeri. Sipas informacioneve që kanë, ata thonë se para disa vitesh kanë qenë 3 kompani të licencuara, por sot të tri kompanive iu kanë hequr licencat. Dhe kjo varet drejtpërdrejt vetëm nga qeveria. Është për të ardhur keq që sot nuk është këtu në sallë asnjë ministër, por kjo është vëmendja që tregohet për qytetarët shqiptarë, të cilët iu kanë dhënë votat. Po me kë duhet të flasim ne për shqetësimet?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ja, po flas me ty. A merr ti vesh nga bujqësia? Dakord.

Atëherë, meqë një ministër qenka e deleguar të mbrojtë edhe Ministrinë e Bujqësisë, po i drejtohem me pyetjen: Sa fermerë në Malësinë e Madhe kanë marrë subvencionim dhe kanë përfituar nga nafta? A ke përgjigje? Pra, kjo është situata sot në sallën e parlamentit të nderuar, të dashur qytetarë.

Edhe në Malësinë e Madhe, sot situata është e njëjta. Në raportin përfundimtar të Ujësjiellës-Kanalizimeve, të cilin unë e kam lexuar, Malësia e Madhe rezultoi me 19 orë ujë në ditë, por, në fakt, fatkeqësisht, sot 80% e saj nuk ka ujë jo 19 orë, por edhe as një minutë të vetme. Pra, sigurimi i ujit për 19 orë është një gënjeshtër e madhe. Të vetmen të vërtetë që ka ai raport është ku shkruhet se 41% është humbje e ujit në rrjet. Po, sepse vidhet, aty është hajnia më e madhe që bëhet. Kjo është e vërtetë.



Në fakt, do të kisha pasur dëshirë të ishin këtu dhe drejtuesit e PS-së për qarkun e Shkodrës, por nuk janë, për disa kërkesa që i janë bërë të vazhdueshme edhe asaj zonjës, për sa kohë që e di shumë mirë si është sot Malësia e Madhe, si është Shkodra, pasi kanë fituar gjithandej. Në një fshat të Vukëlit, që përmendet prej 20 vitesh për rrugën, absolutisht, deri në këto momente nuk është bërë asgjë. Përsëri qytetarët e asaj zone më kërkuan dhe më thanë: zoti deputet, paraqite dhe njëherë në parlament kërkesën tonë. Sigurisht që prapë unë sot po i përsëris dhe po i bëj thirrje drejtueses së PS-së, të qarkut të Shkodrës, që një ditë të bukur, kur të ketë mundësi, të lërë festat që bën përditë, dhe bashkë me mua si deputet i zonës, të shkojmë atje, se jam i gatshëm që krah për krah me të të dalim dhe të qarkullojmë në Malësinë e Madhe.

Për të gjitha çfarë unë them këtu, nëse nuk rezultojnë, i kërkoj falje publike këtij parlamenti dhe mbaj edhe përgjegjësi.

Një kërkesë tjetër, jo e vogël e qytetarëve të Malësisë së Madhe, është kërkesa për rrugët, dritat dhe ujin. Është e turpshme që ende sot, në vitin 2023, në çdo vend të Malësisë së Madhe, kërkohen këto.

Por, kërkesa më e rëndësishme është marrja e certifikatave të pronësisë së tokës së qytetarëve të Malësisë së Madhe. Ligji nr. 2020 është i miratuar, por zbatimi i tij vazhdon të zvarritet. Kryeministri i Shqipërisë në dëgjesat e tij, në takime me kryetarët e bashkive, iu thotë të ulin tensionet e qytetarëve, pra e ka kthyer në një sistem sikur opozita nuk ekziston më.

Unë i bëj thirrje Kryeministrit të vërë dorë në mënyrë të menjëhershme të Bashkia e Malësisë së Madhe, në mënyrë të veçantë të Kadastra, që është kthyer në një gangrenë për qytetarët dhe në mënyrë të menjëhershme t'i jepet zgjidhje kësaj situatë dhe qytetarët e Malësisë së Madhe të kenë certifikatën e tyre të pronësisë. Sot, në situatën ku ndodhen ata, nuk janë në gjendje t'i shërbejnë vetes, bujqësisë. Pse? Sepse, as edhe një bankë nuk iu hap rrugën për sa kohë nuk kanë një certifikatë. Pse zvarritet kjo, të nderuar qytetarë? Përse bëhet kjo?

**Ermonela Felaj**- Përfundoni, ju lutem.

**Ramadan Likaj** – Kjo bëhet, sepse, thjesht, vazhdoni të ruani me çdo kusht monopolet që i keni të krijuara.

Ndaj ju them edhe një herë, duke mbyllur fjalën time, pasi kaq është e llogaritur koha ime, se do të vazhdoj të jem vetëm për hallet dhe problemet që ka zona ime elektorale, Malësia e Madhe.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Fjalën e ka ministria, Edona Bilali. 10 minuta, ju lutem!

**Edona Bilali** - Në fakt, jo rastësisht e mora fjalën pas zotit Likaj, me të cilin ndajmë jo vetëm të njëjtën zonë, por edhe një sërë problematikash të përbashkëta. Për hir të së vërtetës, më duhet të pranoj që, sa i përket interesit qytetar, ky është një rast që na bashkon më shumë se na ndan. Në fakt, me këtë lidhet fjala ime sot.

Sot kam zgjedhur të flas për një ligj, i cili që në krye të herës u hartua për të zgjidhur një problem jo të vogël, për një të drejtë, siç është e drejta e pronës, ligjin e famshëm nr. 7501, të cilin u munduam ta adresojmë nëpërmjet ligjit nr. 2020 për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Në fakt, nuk do të ndalem fare te historia si kemi arritur deri këtu, për shkak edhe të tranzicionit të stërzgatur, të cilin po vazhdojmë ta kalojmë, por do të ndalem vetëm tek efektet financiare dhe ekonomike që prodhon mungesa e adresimit dhe zbatimit të një kuadri ligjor të tillë.

Sot, mungesa në zbatim përkthehet në mungesë të ardhurash në familje, në ekonominë lokale, por edhe në ekonominë kombëtare. Megjithatë problematika është kombëtare, unë do të përqendrohem te qarku im, te Shkodra, ku, për shkak të mungesës së këtij rregullimi, qytetarët nuk mund të zhvillojnë pronat e tyre bujqësore. Në Reç, në Bajzë, në Koplik, në Gradec, në Gruemirë, në Malësi të Madhe, apo në Velipojë, Dukagjin, Postrinë, në Anën e Malit, në Shkodër ka familje dhe sipërmarrje, të cilat janë të gatshme të investojnë në tokat e tyre për të krijuar biznese, të cilat, minimalisht, do të krijojnë një impakt punësimi lokal.

Në zonën e Reçit, ne kemi nisur një projekt pilot për regjistrimin e këtyre tokave. Dhe sot jam shumë e kënaqur të ndaj para të gjithë shqiptarëve që tashmë jemi pothuajse në fund të këtij procesi, i cili ishte i zgatur, por që po shikon dritë në fund të tunelit. Megjithatë, kjo është një qasje për një zonë dhe zgjidh një problem të caktuar, por nuk zgjidh të gjithë problemin e zonave të tjera që ka

jo vetëm Bashkia e Malësisë së Madhe apo Bashkia e Shkodrës, por e gjithë Shqipëria.

Për shkak të mungesës së titujve të pronësisë, sot subjektet nuk mund të marrin një kredi në bankë, nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare me vetë fondet që qeveria i vë në dispozicion, nuk mund të aplikojnë as për grante ose mbështetje tjetër ndërkombëtare dhe nuk mund të tjetërsojnë, pra t'i shesin, t'i japin me qira në mënyrë të rregullt tokat e tyre bujqësore, për të shtuar vlerë.

E gjithë kjo, sigurisht që përkthehet në një fluks monetar të munguar në fund të ditës, jo vetëm në të ardhurat e familjeve të atyre zonave, por edhe në arkën e shtetit. Ligji nr. 2020 është hartuar që të adresonte këtë problem dhe, në thelb, ligji ka krijuar bazën e nevojshme për të shuar aspektin e posedimit pa titull të tokës bujqësore, që manifestohet në sipërfaqe shtesë, që zotërohen përtej titullit të miratuar në AMTP.

Ky ligj zgjidh, gjithashtu, aspektin e posedimit të parcelës së plotë apo të pjesës më të madhe pa titull, megjithëse, me gjithë adresimin, është vërejtur që sërish shumë prej poseduesve pa titull nuk e kanë shfrytëzuar rivendosjen në afat, për të aplikuar për kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore në përdorim. E thënë ndryshe dhe, ndoshta më thjesht, është se nuk kanë aplikuar brenda afateve të afishuara.

Duke parë këtë problematikë, duke qenë një qeveri në kontakt të përditshëm me qytetarët dhe që ka në thelb bashkëqeverisjen, javës që kaloi miratuam në mbledhjen e qeverisë VKM-në për ngritjen e task forcës për mënyrën e trajtimit të tokave bujqësore të poseduara pa titull. Kjo task forcë po ngrihet me qëllimin e analizës së sfidave për zbatimin e ligjit nr. 2020, identifikimin dhe grupimin e problematikave, dhe dhënien fund të posedimit të tokave bujqësore pa titull pronësie. Është tashmë e konfirmuar që ky fenomen është veçanërisht prezent në Shqipërinë Veriore. Efekt anësor pozitiv, që do të prodhohet nga ngritja e këtij grupi, përveç sa listova më sipër, është edhe minimizimi i informalitetit në zotërimin e tokave bujqësore.

E them sot me shumë kënaqësi, megjithëse jemi të vonuar, që tashmë jemi një hap më afër për t'iu dhënë qytetarëve një të drejtë themelore, siç është ajo e posedimit të tokave bujqësore.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhemal Qefalia, 5 minuta, ju lutem. Të përgatitet zoti Berisha.

**Xhemal Qefalia** - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Në fakt, sot është një seancë e veçantë, që ka të bëjë me problemet e qytetarëve në zonat tona, por, meqenëse vijmë 1 javë apo 10 ditë pas zgjedhjeve, do të ndalem pak te fushata elektorale që u zhvillua më 14 maj.

Së pari, dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët treguan qytetari duke marrë pjesë në një fushatë të qetë, pa eksese dhe pa probleme duke u bashkuar kështu me shumë vende të tjera të zhvilluara.

Së dyti, duke parë që fushata shkoi mirë dhe pati qytetari, mendova se edhe në fund të fushatës përfaqësuesit e partive politike do të dilnin dhe do ta pranonin rezultatin, të cilin e vendosën qytetarët me votën e tyre, por nuk ndodhi kështu. Opozita si përherë e kundërshton dhe e akuzon mazhorancën për vjedhje, për mashtrime dhe për marrje të votave. Në fakt, opozita ishte përgatitur për një revolucion të madh demokratik, që 14 maji do të ishte një festë e madhe, ku qytetarët do të fitonin të drejtën e tyre, madje kishte edhe nga ata liderë të opozitës që thoshin se “do të shënojmë 3-pikësh” në Tiranë, në Elbasan dhe në Durrës, por, në fakt, rezultoi e kundërta. Një 3-pikësh tjetër u shënuar në hartën e Shqipërisë, u fituan Shkodra, Kamza, fitoi edhe kryetari i Komisionit të Sigurisë në një zonë të vështirë në Çorovodë. Pra, ky është realiteti, ku qytetarët me votën e tyre treguan se fushata nuk ishte ashtu siç e akuzonin Kryeministrin Rama, se po bën një fushatë “me tallava dhe me dajre”, por ishte një fushatë reale dhe konkrete me gjithçka që ishte arritur dhe gjithçka që do të bëhet.

Si deputet i qarkut të Tiranës dua të vlerësoj kandidatin e opozitës për qytetarinë që tregoi gjatë fushatës, por rezultati ishte bindës, fitues me 60 mijë vota më shumë në Tiranë (60 mijë vota më duket se ka një qark i rëndësishëm në Shqipëri, Fieri). Dua ta evidentoj këtë fakt, pasi këto ditë kam ndjekur disa drejtues të partisë së opozitës, të cilët kanë atakuar dhe kanë thënë se është fituar vetëm në zonat rurale, pra, në fshatra. Po, more po, këta banorë të këtyre zonave votuan sërish kandidatin e tyre, Erion Veliajn, sepse u ka qëndruar afër dhe rezultatet janë impresionuese. Dua t'ju përmend sot disa emra qytetarësh dhe

banorësh të këtyre zonave, të cilët ndoshta askush nuk i ka dëgjuar, por që arritën rezultate spektakolare në krye të ekipeve, si: Gent Sita, Esi Kreka dhe Hamza Sita në Zall Bastar; Arben dhe Roza Muharremi, Avni Luli, Beqir Boja dhe Taulant Hoxha në Zall Herr, që arritën rezultat spektakolar 72%; Sea Meta, Sul Kulloli, Alban Shaba në Bërzhitë, 72%; 74% është fitorja e Klisman Mukës dhe Lorenc Isufit. Janë qytetarë të thjeshtë, të cilët kanë qenë në krye të këtyre ekipeve.

Po kështu janë edhe ekipet e Fatjon Ballës, Ina Dordës, Shpëtim Sinës dhe Redion Çatrit në Shëngjergj. Në njësinë 12, Militan Marku, Romina Zajmi, Sajmir Allushi dhe Rezart Isufi. Pa dyshim, që edhe në Dajt, ku ndodhet Sureli ose "San Françisko", siç doni ta quani ju, u arrit fitore spektakolare. Fredi Braja, Klevis Lala, Anila Dano, Kujtim Qefalia, që ka konflikt interesi, por realisht ka fituar bindshëm. Ne jemi fitues dhe unë jam i ndërgjegjshëm se ka shumë punë për të bërë, por do të ndikojmë bindshëm për t'i realizuar. Vërtet e kemi bërë rrugën në Kërrabë pas 76 vjetësh, por ne do të bëjmë edhe rrugën e Priskës; vërtet e kemi bërë rrugën në Kasallë, por do ta bëjmë edhe rrugën e Vilës, prandaj këtu nuk ka të humbur, sepse nga vota e 14 majit do të përfitojnë edhe ata që abstenuan.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjalën e ka zoti Berisha.

Keni 10 minuta në dispozicion.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Zonja Vokshi, 10 minuta, sepse Rregullorja nuk e lejon që një deputet të flasë më shumë se 10 minuta.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, e kam në Rregulloren.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, 10 minuta! Është bashkuar fjala juaj, e zotit Bylykbashi dhe e zotit Baçi.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Vokshi, sepse nuk i bën drejtuesi i seancës as listën dhe as ndarjen e kohës!

**Sali Berisha** - Të dashura qytetare dhe qytetarë,

Zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Jam këtu për të denoncuar farsën e turpshme kriminale elektorale të 14 majit. Në këtë farsë,

krahas dërgimit të 683 mijë zarfeve, në kundërshtim flagrant me ligjet e vendit dhe me Kartën e Kopenhagenit për zgjedhje të drejta dhe të ndershme; rritjes së rrogave për 180 mijë punonjës, në thyerje të këtyre standardeve, për herë të parë në historinë e këtij vendi, krahas caktimit të kryetarit të koalicionit opozitar nga qeveria, një akt i shëmtuar që tregon fytyrën e vërtetë të këtij regjimi; komisioneve 6 me 1 apo 6 me 0, si kurrë ndonjëherë në historinë e vendit; krahas qindra milionë eurove të shpërndara në dorë nga Edi Rama dhe asistenti i tij Tom Doshi në të katërt anët e vendit, të cilët deformuan në mënyrë ekstreme një rezultat ku për rreth 40% të votave arrihet pas gjithë këtyre mnaipulimeve vetëm 5% pushtet, u përdor edhe një mekanizëm tjetër kriminal, monstruoz për të deformuar rezultatit e zgjedhjeve, u përdorën zgjedhësit fantazmë apo zgjedhësit që votuan potencialisht mbi një, dy apo tri herë në qytete apo vende të ndryshme.

Zgjedhësit fantazmë apo zgjedhësit potencialë, që votuan më shumë se një herë, ishin në total 547 mijë. Në Bashkinë e Vlorës ata arritën në 29% të zgjedhësve; në Bashkinë e Vorës 15%; në Përrenjas 28%; në Rrogozhinë 16%; në Sarandë 35%; në Përmet 29%; në Malësinë e Madhe 23%; në Kurbin 30%; në Konispol 34%; në Has 18%; në Kamëz 21%; në Durrës 23%; në Shkodër 16%; në Devoll 20%; në Delvinë 34%; në Bulqizë 10%; në Mallakastër 11% e kështu me radhë. Është kjo ushtri e zgjedhësve fantazmë që u përdor masivisht për të mashtruar rezultatit e zgjedhjeve më 14 maj, krahas faktorëve të tjerë.

I denoncoj këtu në parlament, këtë batërdi elektorale dhe këtë farsë, për t'u thënë shqiptarëve se ka vetëm një rrugë që ju të votoni të lirë, ka vetëm një rrugë që Edi Rama të mos e blejë me paratë tuaja publikisht votën, ka vetëm një rrugë që Edi Rama të mos blejë me para në dorë qindra milionë euro vota, ka vetëm një rrugë që Edi Rama të mos i përdorë zgjedhësit fantazmë kundër jush për të shkelmuar vullnetin tuaj dhe kjo rrugë është: protesta, protesta dhe vetëm protesta.

Kombi i fuqishëm polak, për një ligj që vë në diskutim procesin zgjedhor, sot është i tëri në rrugë. Unë qëndroj këtu me thirrjen time të fuqishme: në protestë, protestë dhe vetëm në protestë, përndryshe, ata, të cilët përpiqen të justifikojnë me mënyra të ndryshme këtë vjedhje

monstruoze të votës, bëhen veçse mbështetës të një krimi të paparë në historinë elektorale. Unë kam bindjen se qindra dhe mijëra shqiptarë idealistë, që votuan në këto zgjedhje për opozitën, do të ngrihen dhe do të krijojnë mundësinë që shqiptarët të votojnë të lirë.

Por, unë jam këtu sot, gjithashtu, për të denoncuar qëndrimin antikombëtar, antishqiptar, sintonizimin e qëndrimeve të Edi Ramës, vasalit të Beogradit me padronin e tij Aleksandër Vuçiç.

Të dashur miq,

Një situatë dramatike u krijua në Veriun e Kosovës. Analiza është bërë duke mbështetur fuqimisht të drejtën e qeverisë së Kosovës për të vendosur ligjin në të gjithë territorin e saj. Gjithashtu, i bëj thirrje që të ketë parasysh frymën e ligjit dhe të bashkërendojë të gjitha veprimet me faktorin ndërkombëtar. Unë jam këtu për të dënuar sulmet e turpshme, sulmet antishqiptare të përditshme të Edi Ramës ndaj Kryeministrit të Kosovës; sulme në sintoni vetëm me një njeri dhe ky është padroni i tij, Aleksandër Vuçiç.

Dje, televizioni i zyrës së Edi Ramës, me urdhër të kësaj zyre, në mënyrën më kriminale shpalli publikisht se Kosova zgjodhi luftën dhe jo paqen. A ka nxitje më të madhe të konfliktit sesa kjo thirrje e Edi Ramës në emër të Vuçiçit, në Tiranë?!

Ata që mendojnë se Edi Rama e ka personale me Kurtin, mashtrojnë veten. Edi Rama nuk kurseu për sulme, qoftë edhe për fatkeqësinë shëndetësore ish-kryetarit dhe ish-kryeministrin e Kosovës, ish-kryetarin e LDK-së, Isa Mustafën, nuk kurseu padinë në gjykatë ndaj ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj dhe kjo vetëm e vetëm pse ata nuk pranonin diktatin e padronit të tij, Vuçiç.

Këto sulme që Rama i bëri ndaj Albin Kurtit dhe qeverisë së Kosovës, këto mashtrime dhe trillime të paimagjinueshme identike me ato të Televizionit Shtetëror të Beogradit, se Kosova ka zgjedhur luftën, tregojnë se ky është një Kryeministër fund e krye antishqiptar, skllav i padronit të tij në Beograd. U rikujtoj shqiptarëve se kryeministri kroat bëri një propozim pikërisht në Bratislavë, kur Edi Rama lëshonte rrufe ndaj Albin Kurtin, që t'i kërkohet falje Kosovës për krimet e Milosheviçit, kërkoi të njihet reciprocikisht edhe pastaj të normalizohen marrëdhëniet. I dërguari gjerman për Ballkanin, zoti Sarrazin, duke mos rënë dakord me Kurtin për

veprimet e tij, deklaroi se nga Beogradi erdhën emisarë dhune, erdhën falanga dhune, erdhën huliganë, të cilët sulmuan KFOR-in, por këto nuk i konsideron vasali i Beogradit. Po kështu me dhjetëra e dhjetëra analistë e politikanë të tjerë bëjnë një analizë më gjakftohtë, kurse ky e ka shndërruar Tiranën zyrtare në një altoparlant të Beogradit zyrtar. Nga ana tjetër, beson se me këto qëndrime do të mund ta lehtësojë veten nga afëra *McGonigal*. Asgjë nuk të shpëton ty, ta kesh të qartë! Ja ku po ta them: afëra *McGonigal* do të çojë ty në birucë, aty ku është *McGonigal*-i. Asgjë nuk të shpëton ty nga dënimi për këto zgjedhje, shqiptarët do ta thonë fjalën e tyre!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka zoti Balla.

**Taulant Balla** – Në fillim të kësaj seance kolegu, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Bardhi, bëri një lapsus që do të doja që shërbimet e seancës ta korrektojnë, të mos na krijojë incident diplomatik, sepse iu referua Kryeministrit të Moldavisë si zonjë. Dorin Reçean është një zotëri i nderuar, ndoshta e kishit për Presidenten Maja Sandu, por besoj se lapsuse të tilla korrektohen në procesverbalin e seancës.

E bëra këtë ndërhyrje përpara se të hyj në një përgjigje me *non grata*-n, që sapo u nongradua edhe nga salla. U shpreh se ka 547 mijë zgjedhës në të gjithë Shqipërinë, që paskan votuar dy herë dhe sipas tij i bie që këta 547 mijë zgjedhës, që kanë votuar për kandidatët e shumicës, të gjithë të kenë votuar dy herë, siç tha ai, që i bie nga 1 milion e 395 mijë vota që janë numëruar, pra që kanë marrë pjesë, opozita të ketë marrë më pak se 300 mijë. Tani, o ta ka lënë Luli këtë problem llogarish matematike..., por gjëja që i vuri qershinë mbi tortë kësaj shprehje kuptimplote të disfatës, që sapo bëri udhëheqësi historik i foltores, fakti që nuk përmendi Tropojën, është gjëja më e bukur. Pra, rezulton që Sali Berisha e ka pranuar humbjen në Tropojë, se nuk e përmendi Tropojën si një nga rastet e bashkive, sikurse nuk përmendi edhe shumë të tjera, ku ka pasur një problem si ky.

Sali, humbjen e Tropojës duhet ta konsiderosh si humbjen tënde personale. Unë po ta them troç, edhe pse nuk jam më aty, nëse një rezultat të tillë do ta kisha në Librazhd, nuk do të vija më në këtë sallë. Kështu që bën mirë edhe ti që humbjen e Tropojës ta konsiderosh si përfundimin e karrierës tënde në politikë, të

lëshosh mandatin e të ikësh njëherë e përgjithmonë edhe nga kjo sallë, sepse, në fund të fundit, kemi një shprehje të gjithë ne që merremi me politikë: kur nuk të voton fshati yt, ç'të të votojnë më të tjerët. Po e mbyll këtë ndërhyrje, sepse të gjithë biem dakord që zgjedhjet e 14 majit ishin zgjedhje plotësisht të drejta, demokratike. Fakti është që ditën e diel, më 14 maj, në orën 19.00, udhëheqësi i parë që doli në konferencë për shtyp për të njoftuar fitoren ishte zoti Berisha, ku shpalli fitoren: "Tirana blu. Elbasani blu. Durrësi blu", madje një koleg thoshte që përpara zgjedhjeve kishte thënë që në Fier fitojmë bindshëm, e në fakt mirë dolën, dolën aty-aty të dyja PD-të me njëra-tjetrën, me diferencë të vogël, ndërkohë që Partia Socialiste mori 70% të votave. Në këtë aspekt, mirë është që në zgjedhje, çdo parti politike të shohë një herë nga vetja. Mendoj se ajo që i thashë më sipër Berishës, mund të jetë edhe një zgjidhje për të ardhmen e Partisë Demokratike. Duke e konsideruar Tropojën si humbjen e vet personale, shpëton edhe Partinë Demokratike nga halli ku e ka futur.

10 vjet më parë, 9, në fakt, kam qenë në Rumani në një takim dhe zëvendës-presidenti i atëhershëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sot Presidenti aktual, Xho Bajden, duke iu drejtuar një konference ku merrnin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, tha se korrupsioni është një kancer që ha besimin te demokracia, zhduk instinktin e inovacionit dhe të kreativitetit. Është një shprehje shumë e bukur, që mendoj se edhe ju, kolegë të opozitës, duhet ta kuptoni dhe duhet t'ju vijë edhe juve kreativiteti, por edhe inovacioni kur merrni përsipër të bëni denoncuesin. Arsyeja, themeli i reformës në drejtësi ka qenë pikërisht që ne të heqim dorë nga historia që drejtojmë gishtin kundër njeri-tjetrit. Pra, fakti që në këtë vend, policia, Byroja Kombëtare e Hetimit, prokurorët e Prokurorisë Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar arrestojnë, ngrënë akuza ndaj funksionarëve më të lartë në këtë vend, nuk është dështim, është fitorja e betejës kundër korrupsionit. Nëse unë do të isha në vendin tuaj, kur të merrja fjalën sot këtu do të thosha, po, e përshëndesim punën që po bën Prokuroria Speciale kundër Korrupsionit. Nëse unë kam një akuzë ndaj një zyrtari dhe nëse do të isha njëri prej jush, do të shkoja ta çoja atje. Unë vazhdoj ta bëj, do të jem përsëri këtë javë, të mërkurën, e pres

Sali Berishën, i cili ka ngritur një akuzë kundër meje. Doli këtu në foltore e tha ky ka bërë këtë e këtë. Kam shkuar atje, kam bërë kallëzim dhe pres nga gjykata që të më japë ose mua të drejtë ose atij të drejtë. Duke qenë se e çon në SPAK, është detyrë e tyre që ta hetojnë. Zotëria nuk vjen. Vjen bën pis foltoren, i akuzon të gjithë dhe, kur vjen puna për t'u paraqitur atje, nuk duket. E pres këtë javë. Të vijë aty, nëse i ka ngelur ndopak burrëri, dhe të përballet. Hiqni dorë nga kjo historia që vini këtu dhe thoni "sekretarja e Përgjithshme". Sekretarja e Përgjithshme është në burg dhe përgjegjësitë juridike, penale janë personale. Për mua është arritje që arrestohet një sekretar i Përgjithshëm, sepse kohën kur urdhrat e prokurorisë nuk zbatoheshin, e mbani mend, apo jo? Për vrasje lëshoi prokuroria urdhrë për komandatin e Gardës, por urdhri nuk zbatohet. Për drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, për zhdukjen e një shqiptari të Kosovës, që kishte regjistruar takimet e Saliut, nuk zbatohet urdhri dhe ai qëndronte drejtor i tatimeve. Rrinte drejtor tatimesh nga shtëpia, se ishte në arrest shtëpie. Kjo ishte drejtësia juaj. Vini e thoni pse arrestohen! Shumë mirë që arrestohen.

E fundit. Po, është e vërtetë, e tha edhe zoti Mediu, unë e kam njoftuar. Ne nuk kemi hequr dorë nga nevoja që Kuvendi i Shqipërisë të kontrollojë, jo të hetojë, përmes një komisioni të posaçëm nivelin e ndërhyrjeve të huaja, kryesisht nga aktorë jomiqësorë, dhe këtu veçoj Rusinë, në funksionimin e institucioneve demokratike në vend. Parlamenti Europian e bëri këtë gjë. Që nga viti 2020 ka ngritur një komision të posaçëm për të parë këto ndërhyrje të huaja, ka miratuar së fundi një raport të enjten e kaluar dhe pashë nga reagimi i njerit prej kryetarëve të grupeve një lloj dakordësie, siç është zoti Mediu dhe shpresoj që zoti Bardhi, meqë është këtu, zoti Agalliu, në sallë apo edhe zonja Doda, që në Konferencën më të parë të Kryetarëve ta diskutojmë, në mënyrë që edhe Kuvendi i Shqipërisë të ngrejë pa humbur kohë një komision të posaçëm për të verifikuar të gjitha këto ndërhyrje të huaja. E vërteta është që Partia Demokratike ka qenë një prej subjekteve politike tek e cila rezulton të ketë ardhur një financim i huaj me burime të dyshuara nga Rusia dhe sikurse jemi njoftuar ka pasur edhe një hetim të brendshëm, sikurse ka pasur një hetim të dështuar nga prokuroria, por ka edhe pretendime të tjera ose prova të tjera të bëra publike së fundmi

edhe për një parti tjetër politike, apo drejtues të asaj partie. Mendoj që Shqipëria nuk është totalisht immune, sikurse nuk janë të gjitha vendet. Fakti që në prag të zgjedhjeve europiane të vitit 2024, Parlamenti European po u bie këtyre kambanave, mendoj se jemi në kohën e duhur që edhe ne t'i verifikojmë të gjitha këto informacione dhe një komision i posaçëm, jo një komision hetimor, sepse nuk e kemi mundësinë të ngremë një komision hetimor, t'i verifikojë të gjitha dhe të dalë me një set rekomandimesh për të përmirësuar legjislacionin për t'i dalë para çdo lloj të papriture.

Për sa i përket atij fjalimit bajat, se gjoja Sali Berisha po merr në mbrojtje Albin Kurtin, po ju them se pozicioni zyrtar i Republikës së Shqipërisë, i shprehur qartë nga Presidenti i Republikës, nga Kryeministri i vendit, nga Ministria jonë e Jashtme, është në të njëjtën linjë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin European. Nuk ka asnjë deviacion të qëndrimit të Shqipërisë nga ky pozicion tepër i qartë. Natyrshëm ky duhet të jetë, në fakt, edhe pozicioni i Kuvendit të Shqipërisë sa kohë që ajo që na intereson më shumë është ardhmëria europiane, euroatlantike e Kosovës. Kosova është shtet i pavarur, Kosova ka institucionet e veta, por natyrshëm nuk duhet ta harrojmë kurrë që këtë e kemi arritur në një aleancë të pakontestueshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin European.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zonja Ina Zhupa. Të përgatiten zoti Arbi Agalliu dhe zoti Ferdinand Xhaferraj.

**Ina Zhupa** – Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Keni 5 minuta në dispozicion.

**Ina Zhupa** – S'ka gjë, marr edhe 10.

Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Për herë të parë dua të ndaj nga ky Kuvend një lajm të mirë: vendosjen e datës 15 qershor, ora 10:00, si seancën e parë plenare publike, për padinë e bërë nga një grup deputetësh opozitarë, konkretisht 36 deputetë, kundër koncesionit të Butrintit. Seanca e parë do të zhvillohet më 15 qershor dhe është hera e parë kur në Gjykatën Kushtetuese bashkohen 4 institucione të pavarura të këtij vendi. Është hera e parë që 36 deputetë opozitarë kanë marrë parashtrimet e Presidentit të Republikës, të Avokatit të Popullit, të Kontrollit

të Lartë të Shtetit, në mbështetje të kërkesës së tyre. 4 institucione të pavarura të këtij vendi mendojnë se duhet rrëzuar koncesioni i Butrintit, ashtu siç unë e them prej 1 viti, në betejë publike parlamentare me ministren Margariti.

Të vetmit, që thonë se koncesioni duhet të vazhdojë, janë ata që e kanë dhënë dhe e kanë marrë, pra Ministria dhe fondacioni. Asnjë institucion tjetër publik, i pavarur, kushtetues i këtij vendi nuk ndan këtë mendim, siç mendojnë ai që e ka dhënë dhe ai që e ka marrë, Ministria dhe fondacioni.

Ky është një lajm i mirë dhe besoj se beteja në Gjykatën Kushtetuese do të jetë një betejë e fortë për mbrojtjen e identitetit të historisë e trashëgimisë sonë kulturore, një betejë aspak politike, sepse e kam thënë që në krye të herës se beteja për Butrintin nuk është betejë politike, nuk është betejë ideologjike, nuk është mes të majtës dhe të djathtës, por është betejë për historinë, për identitetin, për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

Një betejë tjetër e saponisur, për të cilën do të kemi rast të flasim gjerësisht të enjten e ardhshme, për shkak se unë kam thirrur në një interpelancë ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi, është mbyllja në mënyrë të papërgjegjshme, antihistorike, e Akademisë së Studimeve Albanologjike. ASA sot përfaqëson institucionin përgjegjës të studimeve të historisë, të gjuhësisë, të letërsisë, të antropologjisë, të shtetit shqiptar. Kjo vendimmarrje, me një të rënë të lapsit, për të plotësuar orekset e kryetarit të Akademisë së Shkencave, ish-ministrit të fundit të diktaturës, Skënder Gjinushit, është totalisht e papranueshme, antishqiptare, dhe sigurisht edhe kjo do të ndiqet në të gjitha instancat parlamentare, por edhe jashtëparlamentare, që nga Gjykata Administrative deri te Gjykata Kushtetuese. Nuk mundet me një të rënë të lapsit të zhdukësh 100 profesorë, të zhdukësh Akademinë e Studimeve Albanologjike, të zhdukësh thelbin e asaj që është shteti shqiptar dhe ta fusësh atë në dyert e mbyllura të një mbistrukture, që vetëm shkencë nuk bën, si akademia e ish-politikanëve të dalë në pension, të cilët janë mbledhur nën tutelën e Skënder Gjinushit. Vetë BIRN thoshte se si ish-deputetët e Partisë Socialiste në një moshë të caktuar bashkoheshin si anëtarë të Akademisë së Shkencave. Kjo do të jetë një betejë, për të cilën

të enjten tjetër do të kemi interpelancë, por, sigurisht, nuk do të mjaftohemi me kaq, sepse është e njëjta gjë: nuk bëhet fjalë për individë, por bëhet fjalë për histori, për identitet dhe unë nuk mbroj individët, edhe pse ata e meritojnë mbrojtjen tonë, por mbroj institucionin, mbroj institucionin e studimeve albanologjike, me një rektor të dekretuar nga Presidenti i Republikës, një institucion i njohur ndërkombëtarisht, me 45 marrëveshje kombëtare dhe ndërkombëtare, i cili shuhet, sepse Skënder Gjinushi ka një reformë për të bërë. Kjo është e papranueshme dhe të gjithë bashkë në këtu nuk duhet të ndahemi kur vjen puna për historinë, për identitetin, për trashëgiminë. Kur bëhet fjalë për Butrintin, duhet e njëjta qasje që kanë pasur organet kushtetuese. Duhet të bashkohemi dhe t'i themi ministres së Arsimit: “Jo, ju jeni shumë më lart se Skënder Gjinushi! Nuk mundet që reformat në këtë vend t'i bëjë akoma ish-ministri i fundit i diktaturës! Ju jeni Ministre e Arsimit dhe ju duhet të mbani përgjegjësi për arsimin në këtë vend!”. Ta kthejmë Akademinë e Studimeve Albanologjike, ta kthejmë atë vendim të marrë me shpejtësi të mërkurën e kaluar, kur u mblodhën vetëm e vetëm për të vrarë albanologjinë! Gjithçka tjetër nuk ka kuptim, nëse ne nuk mbrojmë dot identitetin, historinë, gjuhësinë shqiptare!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Zhupa!

Fjalën e ka zoti Agalliu. Të përgatiten zoti Xhaferraj dhe zonja Pranvera Resulaj.

Zoti Agalliu, keni 5 minuta në dispozicion.

**Arbi Agalliu** – Atëherë, unë dua të flas pak për qytetin e Vlorës. Tashmë jemi në sezonin turistik. Ju mburreni për investimet e bëra në qytetin e Vlorës, por sot i gjithë qyteti ndodhet nën mbetje. Mbetjet dhe plehrat i gjen në çdo lagje, i gjen në çdo rrugë, i gjen në atë që ju e përmendni si Lungomare dhe si investimin më mbresëlënës në atë qytet.

Po kështu, me ardhjen e sezonit turistik, si zakonisht në qytetin e Vlorës fillojnë edhe punimet. Keni hapur çdo rrugë alternative me shtrime kabllorsh, me shtrime tubacionesh, nën pretekstin e investimeve, por nuk ka asnjë konsulencë me operatorët turistikë për këto zhvillime, për këto investime në qytet, nëse doni t'i quani “investime”. I gjithë qyteti, i cili ka një karakteristikë të shtrirjes paralele me bregun e

detit, është sot në sistemin “hinkë” të trafikut. Pra, të jeni të bindur se, në ditët në vijim, në qytet nuk do të ketë frymëmarrje dhe qarkullim, jo vetëm në ditë normale, por edhe në raste emergjencash, me zjarrfikëse apo ambulanca, sepse në rrugën paralele me Lungomaren prej kaq kohësh është në punë e sipër dhe nuk dihet se kur do të përfundojë.

Po përmend edhe spitalin e qytetit, i cili me zhvillimet në Sheshin e Flamurit, që ju e quani investim interesant (kjo është temë tjetër, për vetë karakteristikën e këtij sheshi), është shkëputur totalisht nga pjesa tjetër e qytetit. Duhet të kalosh në një ngushticë jo më shumë se 3-4 metra të gjerë për të shkuar në spitalin e qytetit, që, me ardhjen e sezonit turistik, bëhet gjithnjë e më shumë i nevojshëm.

Nga ana tjetër, dua të përmend plazhet private. Unë po e besoj se lejet për operatorët turistikë janë dhënë duke e zbatuar ligjin, por problem është se si zbatohen këto leje. Pra, nëse një operator ka marrë leje për të vendosur 10 shezlongë, sa shezlongë dhe sa çadra janë vendosur? Kjo duhet të verifikohet nga autoritetet përkatëse, sepse sot në qytetin e Vlorës plazhi është kthyer tërësisht në një plazh privat dhe banorëve të qytetit u ofrohet të bëjnë plazh në atë që quhet “plazhi i vjetër i qytetit”, si plazh publik, ku deti është me mbetje. Qytetarëve nuk mund t'u ofrohet ai lloj pushimi!

Nga ana tjetër, është siguria. Fatkeqësisht, sot qyteti i Vlorës është një qytet që menaxhohet nga bandat. Nëse do të pyesni operatorët e bizneseve të mëdha sot, e përmendin këtë fakt. Fatkeqësisht, qyteti i Vlorës është kthyer në qytetin e djemve të humbur. Në qytetin e Vlorës sot janë mbi 40 të rinj, të cilët nuk janë gjetur. Kështu që, në këtë kontekst, i bëj thirrje ministrit të Brendshëm, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në vetë të parë, për të reaguar për sigurinë në qytetin e Vlorës. Jemi një qytet, ku, siç e thashë, sezoni turistik sjell kontingjent dhe në mënyrë të padiskutueshme duhet të mbizotërojë siguria. Nuk po flas për sigurinë rrugore, sepse ai është një problem tjetër.

Po kështu, është edhe problemi i mungesës së stafit. Në Vlorë biznese të ndryshme kanë investuar paratë e djersës së tyre në hoteleri, në bare dhe në restorante. Unë besoj dhe mendoj se duhet një element mbështetës, qoftë axhustim në paketën fiskale, qoftë një vendim i qeverisë, për të përkrahur dhe për të nxitur forcën punëtore tek

operatorët turistikë. Sot, fatkeqësisht, kemi investitorë që kanë hedhur qindra-mijëra euro në infrastrukturën turistike, por kanë mungesë të theksuar të stafit. Të rinjtë e Vlorës mendojnë si të largohen një orë e më parë. Ky është problem, të cilin ju e quani “global”, kurse unë e quaj, së pari, problem shprese dhe alternative, prandaj mungesa e stafit është një element tjetër që e shqetëson qytetin dhe qarkun e Vlorës, sepse, kur flas për Vlorën, kam parasysh të gjithë qarkun, në këtë prag sezoni turistik.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Agalliu!

Fjalën e ka zoti Xhaferraj. Edhe ju keni 5 minuta në dispozicion.

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Unë do t'i lutesha drejtueses së seancës të më akordojë 1 apo 2 minuta më shumë, duke qenë se çështjen e parë e kam thjesht procedurale dhe nuk dua ta marr 2 herë fjalën.

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë mbahet për të diskutuar problemet e evidentuara nga zgjedhësit. Sipas logjikës dhe ligjit, prezentë duhet të ishin thujtë të gjithë anëtarët e kabinetit qeveritar, për të dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime për gjykimin e ekzekutivit për të zgjidhur problematikat e zgjedhësve. Pra, në frymën e Rregullores së Kuvendit, seanca është konceptuar që qeveria të dëgjojë problematikat nga zgjedhësit dhe të shpjegojë se si do t'i zgjidhë ato.

Kuvendi i Shqipërisë, sipas nenit 1 të Kushtetutës “Shqipëria është Republikë parlamentare”, është pushteti nga ku burojnë të gjitha pushtetet e tjera, duke filluar nga qeveria. Pra, qeveria e Republikës së Shqipërisë, bazuar në Kushtetutë, prodhohet nga Kuvendi. Ku është qeveria?! Ne kemi këtë sjellje të qeverisë, sepse të tillë e ka injektuar Kryeministri Rama, duke deklaruar në televizione kombëtare një marrëdhënie të kufizuar me parlamentin. Kush është ky që del mbi Kushtetutën dhe vendos si duhet të sillemi me parlamentin?! Kjo sjellje, “marrëdhënie e kufizuar me parlamentin”, tregon konceptin që ai ka për shtetin. Nuk është koncepti “pushtetet burojnë nga parlamenti”, por është koncepti “shteti jam unë, të gjitha pushtetet burojnë nga unë” dhe kjo e ka bërë copë shtetin

shqiptar. Ky është mendimi i pastër i demokracisë, ky është mendimi i pastër i institucioneve.

Le të shohim tani se çfarë ka prodhuar ky model i Kryeministrit për qytetin e Durrësit, ku ka 2 vjet që është deputet!

Të nderuar kolegë,

Unë këtu do ta heq fare kostumin partiak dhe do të flas thjesht si qytetar i Durrësit, si qytetar i atij qyteti të cilit kam më shumë se dy dekada që i shërbej. E theksoj që kam më shumë se 2 dekada që i shërbej.

Kur zoti Rama vendosi të ishte anëtar i parlamentit, duke përfaqësuar edhe qytetin e Durrësit në Kuvendin e Shqipërisë, një pjesë e qytetarëve durrsakë menduan se po të fitonte zgjedhjet dhe të bëhej Kryeministër, do të kishte më shumë hapësira dhe mundësi për investime në Durrës, ndoshta dikush nisur nga projekti i shëtitores që kishte ndërtuar në Vlorë, e cila, kam kurajën ta pranoj, nuk është një punë e keqe e qeverisë “Rama”, dhe dikush nisur nga projekti 3D i portit të Durrësit, të cilin unë e konsideroj, bazuar në argumente, si aferën më të madhe korruptive të tranzicionit shqiptar, sikurse edhe për BE-në është një projekt që shkon në mënyrë skandaloze në kundërshtim me kornizën ligjore të anëtarësimit në BE, por gjithsesi kam dëgjuar se ishin edhe pak qytetarë që besuan te kartolina elektorale e ofertës së “Rilindjes” për Durrësin në zgjedhjet e vitit 2021. Ku jemi sot, pas 10 vjetësh qeverisjeje të “Rilindjes” dhe pas 2 vjetësh kur Rama është deputet i Durrësit?! Çfarë ka bërë Kryeministri, ndërkohë që është edhe deputet i qytetit bregdetar?!

Këtu, në këto foto, kemi Durrësin që Rama premtoi në fushatën e vitit 2021. Ky është premtimi i zotit Rama! Po ku është Durrësi sot?! Ku jemi sot pas 10 vjetësh?! Cili është Durrësi real, jo ai i 3D-së?

Në vitin 2016 nisi në zemër të qytetit dhe pa u konsultuar fare, po fare me qytetarët durrsakë, projekti i Velierës. Atëherë u tha që ky projekt do të kushtojë 4 milionë euro, por kanë kaluar 7 vjet dhe çfarë ka ndodhur?! Projekti ka marrë mbi 7 milionë euro dhe ka përfunduar në një kapele të shëmtuar hekurishtesh, që nga dita në ditë po ndryshken. Ky është Durrësi real dhe jo Durrësi 3D.

*(Zoti Xhaferraj paraqet një foto.)*

Pra, projekti i Velierës.



Ky është Durrësi i vërtetë sot, Durrësi turistik i Edi Ramës në vitin 2023.

*(Zoti Xhaferraj paraqet një foto.)*

Këtë foto e kam bërë unë në zemër të qytetit, në shëtitoren “Taulantja” 3 ditë më parë. Ky është Durrësi turistik dhe jo ky që na paraqet Rama në 3D.

Vazhdojmë më tej. Vite më parë u deklarua projekti i unazës së qytetit, ku qytetarët durrsakë mbajnë mend se keni folur ndër vite për unazën që do të lidhte rrugën “Aleksandër Goga” me Currilat, si dhe keni folur për tunelin 1,4 kilometra, i cili do të fillonte te Muzeu i Dëshmorëve për të dalë në Currila dhe se të gjitha këto do të bëheshin për të lehtësuar trafikun në qytet. Por çfarë kemi sot?! Një qytet me një trafik tejet të rënduar, sepse, në vend të unazës, ju ngushtuat rrugët ekzistuese dhe zgjeruat trotualet vetëm e vetëm për afëra korruptive; një qytet, ku trafiku është kthyer në stres për qytetarët, kur u duhet t’i çojnë dhe t’i marrin fëmijët në shkolla.

Ku është porti turistik me vlerë 2 miliardë dollarë, pas më shumë se 2 vjetësh?! Që porti nuk mbaron për 2 vjet, këtë e kuptojmë të gjithë, por të mos fillojë për 2 vjet, nuk ka kurrfarë shpjegimi. Çfarë keni bërë pas 2 vjetësh?! Keni ndërtuar vetëm një zyrë shitjesh.

Durrësin, sikurse të gjithë Shqipërinë, keni 10 vjet që e keni nxjerrë në shitje. Pas dy vjetësh, çfarë ka ndodhur me projektin 2 miliardë dollarë?! Keni marrë të gjitha aktivitetet e portit ekzistues, për t’i çuar te biznesi privat në Porto Romano. Më keq, përveç spostimit të aktiviteteve, janë zaptuar edhe pronat e ushtrisë. Ja ku e keni, me zë dhe me figurë, se çfarë na thotë ministri i Mbrojtjes!

*(Zoti Xhaferraj paraqet një video.)*

**Ermonela Felaj** – Zoti Xhaferraj, keni edhe 30 sekonda në dispozicion, përfundojeni fjalën tuaj, ju lutem!

**Ferdinant Xhaferraj** – Ministri i Mbrojtjes thotë: “Letrat janë letra, s’kam çfarë i bëj, jemi përpjekur ta denoncojmë”, pra qahet ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes së vendit anëtar të NATO-s, sepse i është zaptuar depoja e ish-minave detare. Turp! Duhet t’i themi 100 herë faleminderit biznesit privat që nuk ka shkuar ta zaptojë zyrën e ministrit, sepse do të prisnim që ministrin ta fuste në zyrë prokuroria.

Po ndalem këtu. Për ta mbyllur, dua të them se pas dy vjetësh të Ramës si deputet i Durrësit,

ky qytet na prezantohet vetëm si një qytet, potenciali ekonomik i të cilit është grabitur për interesat korruptivë të pushtetarëve të “Rilindjes”.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Xhaferraj!

Fjalën e ka zonja Resulaj, 5 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Qani Xhafa.

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Të dashur qytetarë,

Në këtë foltore dalim gjithnjë për të diskutuar dhe për të miratuar projektligje, të cilat, pa dyshim, kanë në thelbin e tyre interesin qytetar, por java dedikuar zgjedhësve është një moment reflektimi, sidomos kur kjo vjen pas një fushate zgjedhore, ku për ditë e ditë të tëra kemi qenë në komunikim me thujse çdo qytetar, kështu që një bilanc të punës sime, si deputete, e kam të pashmangshëm.

Në një vështrim makro, ne si mazhorancë duhet të jemi pa dyshim krenarë për gjithçka që kemi arritur dhe për çdo vendimmarrje që kemi marrë në interes të qytetarëve shqiptarë, duke përfshirë këtu edhe vendimin e seancës së fundit për të miratuar projektligjin e pagave, duke i hapur rrugën reformës në sistemin e pagave, të cilat do të kulmojnë vitin e ardhshëm, ashtu sikundër është parashikuar, me rritjen e pagës mesatare 900 euro. Por, të dashur qytetarë, të dashur zgjedhës, në përditshmërinë tuaj, sigurisht që keni nevojë për më shumë se kaq, në kutinë e votimit ju çon më shumë sesa kaq, qëndrimet tuaja formohen më shumë sesa kaq. Çdo ditë që kalon, sa më shumë kontakte krijoj me ju, thjesht përpiqem të kuptoj se çfarë i krijon këto qëndrime dhe, gjithashtu, kuptoj jo thjesht qëndrimet tuaja, por, mbi të gjitha, kuptoj më mirë detyrën time, të cilën po ju ma keni besuar me votë.

Aktiviteti im në territor shtrihet në rajonin 3 dhe, gjithashtu, në komunën Qendër. Sigurisht, zonat rurale kanë specifikën e tyre, ndryshe nga ato urbane, por, në thelb, mbetet e vërtetë që të dyja, si zonat urbane, ashtu edhe zonat rurale kanë një pritshmëri dhe konvergojnë në një pikë, te interesi dhe standardet që ato presin nga shërbimet publike, qoftë në administratën lokale, qoftë edhe në atë qendrore. Më besoni që jam përpjekur shumë të kuptoj dhe të analizoj çdo sjellje tuajën, çdo qëndrim, çdo mllaf që keni treguar ndaj politikës, duke heshtur apo me fjalë.

Duke u takuar me qytetarët dhe zgjedhësit e mi në zemër të Vlorës, aty ku shtrihet rajoni 3, e kuptoj se nuk mund të tolerohet që të mungojnë infrastruktura e brendshme, pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, bolierët, që, në fakt, për qytetarët janë bërë një problem i përditshëm, por, sigurisht, nuk mund të mungojnë edhe gjëra që ndoshta mund të duken periferike, siç mund të jenë administratorët e pallateve. Duke shkuar më tej, në zonën tjetër elektorale, në të cilën unë kam nderin të ushtroj aktivitetin tim, pra në komunën Qendër, duke shkelur çdo fshat të kësaj komune që nga Narta, Zvërneci, Babica, Panajaja, Sherishta, Oshëtima, Kërkova e Bestrova, e kuptoj se nuk mund të pranohet që në këto zona të mungojë ose të ketë vështirësi jetike të furnizimit me ujë të pijshëm. Gjithashtu, unë nuk mund ta kuptoj që të mungojë menaxhimi dhe të vazhdojë të mos ketë një afat për menaxhimin e tokave bujqësore, të cilat do t'i hapnin rrugë jo vetëm një standardi të ri të të punuarit dhe të investuarit në këto fshatra, por do t'i kthenin këto fshatra me bukuri mahnitëse, me njerëz të thjeshtë dhe punëtorë, në potenciale të fuqishme për zhvillimin e agroturizmit.

Po kthehem tek ajo që është më e rëndësishme: Vlora (sikundër edhe kolegët e përmendin vazhdimisht, është një potencial i madh turistik) është kthyer në një kantier ndërtimi, ku çdo ditë ka fluks turistësh jo vetëm kombëtarë, të brendshëm, por gjithnjë e më shumë ka një fluks turistësh ndërkombëtarë. Duke qenë se zhvillimi i turizmit është e ardhmja e rajonit dhe e Bashkisë së Vlorës, sigurisht që edhe këto fshatra, të cilat i përmenda pak më lart, kanë nevojë për t'u mbështetur, për t'u stimuluar, për t'u investuar, për t'u përkrahur që të bëhen pjesë e këtij zhvillimi, për të lidhur ekonominë lokale me atë individuale.

Shqetësimet tuaja, të dashur qytetarë, janë angazhimi im në vijim dhe ky është fokusi i punës sonë të përbashkët për gjithçka që do të bëjmë në ditët e ardhshme për t'u dhënë fund të gjitha shqetësimeve tuaja.

Ju falënderoj përzemërsisht për të gjithë mbështetjen që jepni pa kushte dhe për të gjithë dashurinë, të cilën do të përpiqemi t'jua kthejmë me punë dhe vetëm me punë!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Resulaj!

Fjalën e ka zoti Qani Xhafa, 5 minuta...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Dogjani!

**Asllan Dogjani** – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Unë mund ta kisha ngritur këtë çështje në fillim të seancës, sepse mendova se do të ketë ndonjë reagim nga ministrat, por shoh që edhe ministrat janë larguar. Në seancën e kaluar unë kam denoncuar një problem për zonjën Edlira Kovaçi, që ka 5 vajza të sëmura, e cila e siguron ushqimin e përditshëm në kazanët e plehrave. Kur e kam bërë denoncimin, nuk e kam bërë për të bërë politikë, por për të kërkuar reagimin e institucioneve, kryesisht, të ministres së Shëndetësisë apo të një ministri tjetër, sepse kjo zonjë e siguron ushqimin nëpërmjet kazanëve të plehrave dhe ka 5 vajza të sëmura që kanë nevojë për shërbim mjekësor. Ajo merr 94 mijë lekë në muaj dhe paguan 108 mijë lekë qiranë e banesës. Deri tani (siç thashë, unë nuk e kam bërë denoncimin për të bërë politikë) te kjo zonjë nuk është afruar asnjë drejtues, punonjës i shërbimeve sociale të institucioneve të shtetit...

**Ermonela Felaj** – Zoti Dogjani, ju lutem, nuk kam dëshirë t'ju ndërpres, por çështjet që ju ngrini nuk janë çështje të procedurës; kur ta merrni fjalën, mund t'i trajtoni.

**Asllan Dogjani** – Jo, është çështje procedure, sepse ministrat kanë ikur.

**Ermonela Felaj** – Jo, ju ftoj ta lexoni nenin 49 të Rregullores për të kuptuar se kjo nuk është çështje e procedurës dhe, ju lutem, të mos e zgjatim këtë debat!

Zoti Qani Xhafa e merr fjalën për herë të parë në këtë Kuvend dhe, si deputet i ri, unë kam detyrimin t'i uroj sërish mirëseardhjen dhe t'i uroj suksese!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Ju lutem, uluni! Çështjet e procedurës i përcakton Rregullorja.

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Ju lutem, mos i ngrini tonet, sepse nuk ka nevojë!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Jua ndërpres fjalën, sa kohë që nuk keni të drejtë ta merrni fjalën për çfarëdolloj gjëje që ju vjen ndër mend.

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Uluni, ju lutem!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Uluni, zoti Asllan, sepse nuk keni të drejtë të nxeheni për asnjë gjë të tillë!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Po, patjetër që jua ndërpres fjalën, sepse thatë: “Për procedurë”, zotëri, dhe nuk folët asnjë fjalë për procedurë.

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Lexojeni Rregulloren, nenin 50, dhe kuptojeni se çfarë është çështje e procedurës. Dakord? Kjo nuk është çështje e procedurës dhe nuk është detyrim i asnjë ministri t’ju japë llogari se ku është.

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Zoti Dogjani, uluni, ju lutem!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Ju tërheq vëmendjen për sjelljen në seancë! Uluni!

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Patjetër!

Zoti Xhafa, fjala është për ju!

I lus kolegët që, si deputet i ri, ta dëgjojnë me respekt fjalën e zotit Xhafa.

*(Zoti Dogjani ndërhyr pa mikrofon.)*

Zoti Xhafa, keni 5 minuta në dispozicion.

**Qani Xhafa** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë shqiptarë që na ndiqni,

Si deputet i ri i këtij parlamenti, e ndiej të domosdoshme të sqaroj opinionin publik në lidhje me pozicionin tim për sa i përket rritjes së rrogave për Presidentin, Kryeministrin, ministrat, deputetët e të tjerë, që u miratua në seancën e dytë, pasi unë bëra betimin si deputet.

Është e vërtetë që Kryeministri, zoti Rama, nuk mori pjesë në votim, por unë mund të them me bindje të plotë se pa miratimin e tij këtu nuk kalon as miza. Përpara se të rriteshin rrogat tona, duhet të ishin rritur pensionet, pasi, aktualisht, janë në nivel skandaloz, 70-100 mijë lekë të vjetër për pensionistët në zonat rurale dhe 100-150 mijë lekë të vjetër për pensionistët në qytet; përpara se të rriteshin rrogat tona, duhet të ishin rritur pensionet e invalidëve, që janë në nivele të ulëta, të cilët nuk përballojnë ilaçet që u duhen, e jo më për të jetuar; përpara se të rriteshin rrogat tona, duhet të ishin rritur të ardhurat për familjet me ndihmë ekonomike, të cilave, me aq lekë sa trajtohen, 3 mijë deri në 8 mijë lekë të rinj, nuk u mjaftojnë që të jetojnë si qenie njerëzore. Pasi të ishin bërë këto rritje, duhej të kalonim te rritja për administratën shtetërore, jo me ato përqindje që u

përmenden në seancat e kaluara, por me rritje të konsiderueshme, që edhe ata të shkojnë në punë me qejf e me kohë të plotë dhe ta përballojnë rritjen e madhe të çmimeve në vendin tonë.

Ashtu si zoti Kryeministër, i cili nuk mori pjesë në votimin për rritjen e rrogave tona, edhe unë të njëjtën gjë bëra. E bëra këtë jo se nuk doja rritje rroge, por më vinte zor nga ajo shtresë e popullsisë, e cila nuk u prek fare nga kjo rritje, ose u prek shumë pak dhe, me të drejtë, më thonë: “Vajte në parlament për të rritur rrogën tënde”.

Zoti Kryeministër (për fat, nuk është, por, me sa pashë, është zëvendëskryeministria), ju mburreni për dyfishimin e pagës minimale, nga 22 000 lekë në 40 000 lekë dhe, siç keni premtuar, vitin e ardhshëm do ta bëni 45 000 lekë. Paçka se kjo e rëndon biznesin e vogël, të mesëm apo atë të madh, unë e vlerësoj, por kjo rritje në fondin e sigurimeve duhet të reflektohej edhe me rritjen e pensioneve, që e përmenda më lart. Në këto kushte, ju bëj thirrje nga kjo foltore e parlamentit që të mblidhni Këshillin e Ministrave dhe në mbledhjen tuaj më të afërt të shikohet mundësia e rritjes së pensioneve për të gjitha kategoritë, në mënyrë që edhe pensionistët të mos presin zgjedhjet për të marrë ndonjë bonus apo të presin Vitin e Ri për ndonjë shpërblim, por të marrin atë që u takon, sepse kanë punuar një jetë të tërë dhe, mundësisht, të hiqet koncepti “pension fshati apo qyteti”, pasi edhe fshatari, i cili del në pension pleqërie, presupozohet se nuk e punon dot më tokën apo të mbarështojë blegtorinë, por duhet të jetojë si të gjithë të tjerët. Pra, zoti Kryeministër, të plotësohet minimumi jetik në Republikën e Shqipërisë, sepse e kemi për detyrë t’i ndihmojmë shtetasit tanë kudo që ndodhen, në fshat, në qytet, në kryeqytet apo edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pasi fuqia e një shteti duket te shtresat në nevojë, ndërsa këtu te ne ka ndodhur e kundërta. Deri tani jo vetëm që nuk i keni ndihmuar, por i keni sulmuar; i keni sulmuar për riparimin e një çatie në fshatin më të thellë; i keni sulmuar për ndërtimin e një muri mbajtës apo të një muri rrethues në fshatin më malor; i keni sulmuar për ndërtimin e kotecit të pulave, për të mos thënë për kasollen e qenit. Prandaj, do t’ju lutem që të hiqen me ligj këto lloj lejesh, pasi në këtë kohë fushate i keni hequr për vota, sepse nuk i vjen e keqja shtetit nga këto ndërtime. Gjithashtu, të thjeshtohen dhe të lehtësohen procedurat për ndërtimet e reja në zonat rurale,

por edhe ato urbane; të ulen tarifat e lejeve të ndërtimit për shtëpitë e reja dhe çdo gjë të bëhet e kontrolluar nga shteti, duke u bazuar në plane afatgjata.

Deri në datën 13 maj, në të gjitha lagjet, fshatrat dhe njësitë administrative të Bashkisë së Elbasanit dhe të gjitha bashkive të qarkut investohet me letra apo pa letra, por e rëndësishme ishte që bëhej punë, paçka se ajo bëhej për fushatë. Sa mbaruan zgjedhjet, çdo gjë u pre me thikë, asnjë lloj pune, paçka se ato janë të papërfunduara, vetëm festime dhe falënderime. Popullit duhet t'i shërbejë njësoj, si para zgjedhjeve, si gjatë zgjedhjeve, ashtu edhe pasi ato përfundojnë.

Qarku i Elbasanit për nga popullsia është i treti, por për nga varfëria mbetet afër kreut të klasifikimit, për faktin se edhe nga qeveria qendrore në këta 10 vjet nuk është bërë aq sa duhet. Ju mburreni me investimin për "Formula 1" në Krastë të Elbasanit, por më parë duhej të ishte bërë bajpasi, që lidh autostradën Tiranë-Elbasan me Pogradecin dhe Korçën, pasi trafiku nga Bradasheshi në dalje të Elbasanit lë për të dëshiruar. Lajmi i mirë është që janë tenderuar lotet e tjera nga Miraka tek ura e Murrashit. Nga informacionet që kam marrë, do të jetë rrugë me parametra, interurbane kryesore, me dy korsi për sens, me trafikndarëse të pakapërcyeshme. Para se të fillojnë punimet atje, dua t'ju kërkoj që banorët, të cilët preken nga kjo rrugë, të dëmshpërblehen me vlerën e tregut dhe jo me çmimet që u keni ofruar, 200 lekë për metër katror, sepse ata jetojnë me ato prona.

Për lehtësimin e trafikut në Elbasan, derisa të bëhet bajpasi, dua t'ju sugjeroj të riparoni rrugën e vjetër nga ura e Zaranikës në drejtim të Bradasheshit, pasi do ta lehtësonte shumë trafikun në rrugën kryesore "Metalurgjik-kryqëzimi i luleve", që në Elbasan i thonë autostradë, pavarësisht se nuk është.

Në mbyllje, dua t'ju sugjeroj kësaj qeverie ta kthejë kokën nga zonat rurale, pasi deri tani i ka lënë pas dore. Këta banorë kërkojnë gjërat më imediate: rrugë, ujë, ujë për vaditje, drita. Për këto të fundit është bërë diçka, por ende ka gjëra që duhen riparë. Ajo reforma e famshme e vitit 2015, i largoi shërbimet e pushtetit vendor ndaj banorëve. Kështu që në çdo njësi administrative, qeveria qendrore duhet të bëjë nga një investim të madh, që bashkia nuk mund t'i realizojë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Xhafa!

Fjalën e ka zoti Agron Duka.

Të përgatiten zotërinjtë Flamur Noka dhe Bujar Leskaj.

**Agron Duka** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Zgjedhësit kanë evidentuar nevojën për ndryshimin e Kodit Zgjedhor. Në këto zgjedhje pjesëmarrja ishte më e ulëta që kemi pasur ndonjëherë. Një nga arsytet pse shumë opozitarë abstenuan ishte se ata nuk besojnë se me këtë sistem zgjedhor vota e tyre ka vlerë. Shumë prej tyre, me të cilët kam folur gjatë kësaj fushate, ishin pesimistë dhe nuk besonin që vota e tyre lexohet ashtu siç duhet.

Të gjithë e dinë që ky sistem është bërë për të mbajtur në pushtet dy parti, edhe kur ato nuk kanë më mbështetjen e pjesës më të madhe të shqiptarëve. Aktualisht është në favor vetëm të një partie. Prandaj, unë po e shfrytëzoj këtë mundësi për të theksuar tri probleme që ka sistemi zgjedhor aktual.

Në fakt, këto probleme janë krijuar në vitin 2020, kur mazhoranca në një mënyrë të njëanshme ndryshoi Kodin Zgjedhor dhe na e hoqi të drejtën për të garuar me një koalicion zgjedhor, siç kemi bërë qysh në fillimet e pluralizmit. Sado i keq që ishte sistemi zgjedhor i vitit 2008, ai kishte njëfarë ekuilibri mes elementeve të tij.

Së pari, është formula zgjedhore. Në Kodin Zgjedhor që kemi pasur, kishim një formulë për llogaritjen e mandateve jashtë koalicioneve dhe një formulë tjetër për shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit, e cila ishte më favorizuese për partitë e vogla. Sot, mirë që na është mohuar e drejta për të krijuar një koalicion parazgjedhor, por votat na përlllogariten sipas një formule, e cila edhe në këto zgjedhje bëri që partive, si Partia Agrare Ambientaliste, Partia Republikane, LZHK-ja, Nisma Thurje e të tjera, t'u duhen shumë më tepër vota se i duhen PS-së për çdo mandat në këshillin bashkiak. Kjo jo vetëm që është e padrejtë, por është edhe antikushtetuese, prandaj ose t'i rikthejmë koalicionet në Kodin Zgjedhor, ose do të aplikojmë të njëjtën formulë zgjedhore që kishim para Kodit Zgjedhor të vitit 2020.

Së dyti, është proporcionali rajonal. Ndarja rajonale në Shqipëri, të paktën në mënyrën se si është konceptuar, nuk ka asnjë bazë sociale, ekonomike, historike, madje as logjike dhe është bërë në mënyrë të njëanshme; është bërë sipas llogaritjeve elektorale të mazhorancës. Megjithatë, edhe në këtë ndarje rajonale, duke pasur koalicionin, ne mund ta kompensonim njëri-tjetrin brenda këtij koalicioni dhe t'u jepnim peshe votave tona. Për shembull, të marrim Kukësin. Me këtë ndarje rajonale, për të fituar një deputet në Kukës duhen 33% të votave të qarkut. Sigurisht që një parti e dimensioneve tona, si Partia Agrare Ambientaliste, nuk mundet t'i marrë këto vota, por, duke qenë në koalicion, votuesit tanë mund të kontribuonin për fitoren e mandateve të koalicionit. Sot, me heqjen e koalicioneve, votuesit tanë as që ia vlen të dalin në zgjedhje. Prandaj, jo për ne, por për të drejtën e çdo shqiptari që të përfaqësohet në këtë parlament pa diskriminim, ne duhet ose t'i rikthejmë koalicionet, ose të aplikojmë një zonë zgjedhore kombëtare, siç kanë bërë kolegët tanë jo më larg, por në Kosovë, pra të kemi një sistem proporcional kombëtar ose proporcional rajonal me korrektim kombëtar.

Së fundi, janë listat e mbyllura. Për këtë çështje kemi folur shumë, por ende nuk është zgjidhur. Sapo mbaruam një palë zgjedhje, ku listat për këshilltarët bashkiakë ishin të mbyllura. Partia Agrare Ambientaliste kandidoi e vetme në të gjithë Shqipërinë dhe kudo kishte personalitete lokale që respektohen nga komuniteti i tyre. Ky Kod Zgjedhor ua mohoi atyre të drejtën që të ishin në fletën e votimit, duke krijuar vështirësi edhe për votuesit që të gjenin kandidatit e tyre. Ndërkohë, për 2 vjet vijën zgjedhjet e përgjithshme, por kemi një Kod Zgjedhor me një herës që aktualisht është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese. Çfarë do të bëjmë? Do t'i japim një drejtim që tani, apo do ta lëmë edhe këtë për momentin e fundit, ashtu siç kemi bërë gjithmonë?

Unë u bëj thirrje kolegëve të mi të opozitës, edhe atyre të mazhorancës, të cilët mendojnë që ky sistem zgjedhor është i padrejtë, sidomos të rinjve, të cilët duan të hyjnë në politikë me idetë dhe ideologjitë e tyre dhe jo t'u nënshtrohen shijeve të kryetarëve aktualë të partive, kushdo qofshin ata, që të nisim nga puna që tani, jo pas pushimeve, sepse nuk ka më kohë. Kjo është një

çështje shumë serioze dhe kërkon kohën e saj për t'u bërë ashtu siç duhet. Unë nuk marr përsipër të them cili sistem zgjedhor është perfekt, sepse të tillë nuk ka, por një gjë e them me siguri, që ky ekzistuesi është më i padrejti, nuk lejon garë dhe u pret rrugën të rinjve që të hyjnë në politikë me idetë e tyre.

Shqiptarët, me të drejtë, refuzojnë politikën dhe politikanët aktualë. Duhet t'u hapim rrugën të rinjve, por kjo bëhet me ndryshimin e sistemit dhe Kodit Zgjedhor Ne kemi detyrimin, përgjegjësinë, por edhe mundësinë që të krijojmë kushtet e nevojshme për këtë ndryshim. Nuk kemi çfarë të presim më.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Duka!

Fjalën e ka zoti Noka, 6 minuta në dispozicion.

**Flamur Noka** – Ka një predispozitë të çuditshme nga ana e mazhorancës për ta anashkaluar, për t'u fshehur dhe për ta kaluar si në kalendat greke çështjen e farsës zgjedhore të 14 majit. Sigurisht, nga shqiptarët nuk gëlltitet dot kollaj një farsë e tillë. Në një vend demokratik ka një garë mes forcash politike. Gjithkund, shteti dhe institucionet e tij janë garantë të këtyre proceseve të garës, të drejtësisë në garë, të barazisë në garë, të respektit ndaj votës dhe votuesve, kryesisht shenjtërisë së votës. A ndodhi kjo më 14 maj në Shqipëri?! Jo! Askush nuk guxon ta thotë, sigurisht as vetë Kryeministri, as ndonjë nga kolegët rilindës këtu në sallë. Nuk kishte bërë vaki ndonjëherë që të kishte betejë të tillë të pabarabartë; nuk kishte bërë vaki ndonjëherë në asnjë vend demokratik, por as edhe në Shqipëri, që shteti dhe falangat e tij të funksiononin nga mëngjesi deri në darkë çdo ditë të fushatës jo si shtet, jo si institucione, por si një mafie. Kodi me të cilin qeveria e Shqipërisë dhe "Rilindja" funksionoi gjatë fushatës zgjedhore deri në momentet e mbylljes së rezultateve, nuk ishte Kodi Zgjedhor. Jo, Kodi Zgjedhor për Edi Ramën ishte kinezëri. Nuk ishte ligji. Jo, jo, ishte "kodi i mafies". Të tërë, me një skenë mafioze, u turrën mbi votën e lirë.

Duhen orë e orë dhe ditë të tëra që të bisedojmë dhe të sqarojmë çfarë batërdie ka ndodhur me votën dhe me zgjedhjet në Shqipëri. Mjafton të thuhet se është hera e parë që një Kryeministër, qoftë edhe një qytetar i thjeshtë, bën thirrje për bojkot. Është hera e parë që pas

thirrjes së bojkotit nga ana e Edi Ramës, fshihej vetëm një gjë: blerja e kartave me shantazh, me terror dhe me para. Unë dua të kap dy elemente në zonat ku u bë votimi elektronik. Në të gjitha këto qendra në Elbasan, në Kamëz dhe në Vorë, operatorët funksionuan si falanga kriminale për të devijuar vullnetin e zgjedhësve. Rreth 30% e votave janë klikuar nga operatorët, të cilët rastësisht na kishin qenë të gjithë anëtarë të FRESH-it ose bij rilindësish të thekur. Shikojeni tani se çfarë ka ndodhur: votimet me grupe.

*(Tregon foto.)*

Ja ku e kenë, është në Elbasan.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, po, qesh ti. Ja, Ja, është votim i fshehtë ky?! Ja, shikojeni, ta afrojmë te kamera, shikojeni. Shikojeni një qendër tjetër! Një qytetar i panjohur, nga jashtë, futet dhe voton për një votues.

Shikoni një qendër tjetër: operatorja (janë edhe me video), duke votuar mbi 30 herë. Se për kë voton, duhet pyetur “Rilindja”. Kjo teorikisht është operatore, praktikisht duhej të ishte në burg. Janë me qendra votimi.

Shikojeni qendrën tjetër. Atje ku kanë dërguar votues shëtitës, kanë porositur që kamerat të ulen dhe të mos filmojnë qendrën e votimit, por të filmojnë vetëm pllakat dhe këto janë në të gjithë Shqipërinë, por kryesisht në Kamëz, në Elbasan dhe në Vorë.

Shikojeni qendrën tjetër: përsëri operatorja duke votuar për qytetarët dhe qytetari rri e vëzhgon. Kjo operatore duhej të ishte në burg. Ne të gjitha këto do t’ia çojmë prokurorisë. Shikoni këtu, po në Elbasan: janë dy qendra votimi, a thua se është pazari i gjësë së gjallë. Dy qendra votimi, komisionet janë bashkë dhe vendi i votimit është në një dhomë tjetër. Pazar i gjësë së gjallë, ku votojnë operatorët për qytetarët.

Shikoni këtu, po në Elbasan: është qendër votimi, ku ky personi i paidentifikuar, që nuk e njihete askush në qendrën e votimit, me presion voton për qytetarët e moshës së tretë. Askush nuk e njeh; nuk është banori i fshatit. Jo, është një rilindës i ardhur me porosi.

Shikoni një qendër tjetër: kamera e fokusuar te pllakat, për të mos i parë votuesit. Pse? Sepse ishte qendër e targetuar për votuesit shëtitës.

Tani, këto ishin të gjitha ato që kisha mundësi t’ju tregoja në këto pak minuta, por janë me dhjetëra, sepse në Kamëz, 20% e kamerave paskan funksionuar dhe i famshmi KAS, kasapi i

zgjedhjeve, nuk i jep kamerat për pjesën tjetër. Pse? Sepse ata e dinë. Pra, këtu nuk bëhet me ligj, jo, jo; këtu kasapi i Edi Ramës, që quhet KAS, vendos si “Maliq”. Po të jepen pamjet e kamerave të tjera, të jeni të sigurt që do të dalë batërdia si këtu, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Ndaj, këto zgjedhje nuk mund t’i njohë askush më si zgjedhje; këto zgjedhje ishin një farsë, një batërdi me moton: “Të gjithë pushtetin sovjetëve”. Ja ku i kemi sovjetët këtu mbrapa, të cilët përdorën para dhe gjithçka, e përdorën shtetin si bandë...

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Noka!

Ju lutem, ju ka përfunduar koha, madje morët edhe një minutë shtesë!

**Flamur Noka** – Përgjigjja do t’ju vijë siç i jepet një bande, protestat do të jenë hapi i parë dhe më pas prisni hapa të tjerë.

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka zoti Leskaj, 5 minuta.

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

**Bujar Leskaj** – Pavarësisht stinës së nxehtë politike, në Vlorë, në periudhën e pranverës dhe të verës, veçanërisht, kryefjala e bisedave dhe diskutimeve është turizmi. Kjo ndodh për faktin e thjeshtë, sepse industria turistike është numri një në industrinë e qytetit të Vlorës, e cila punëson mbi 30 000 veta dhe janë me dhjetëra e mijëra familje që ushqehen nga shërbimet turistike, si dhe të ardhurat që përfiton buxheti i shtetit janë me dhjetëra miliona euro.

Pavarësisht nga fjalna e shumë e propagandës qeveritare për investimet në dy projektet e Lungomares, turizmi përfaqëson sot asetin më të madh ekonomik të qarkut të Vlorës, për fat të keq, të pavendosur në vëmendje të qeverisë qendrore dhe të patrajtuar me politika prioritare fiskale dhe zhvillimi.

Si mund të pretendosh të kesh turizëm të qëndrueshëm, kur në zonat me fluks të madh turistik në verë, si: Radhimë, Orikum, Tragjas dhe Dukat, nuk sigurohet furnizimi me energji elektrike, nuk sigurohet furnizimi me ujë?!

Si mund të kesh dhe të pretendosh për një turizëm cilësor dhe për të gjithë qytetarët, pas investimeve që janë kryer në Lungomare, kur pjesën kryesore të investimit në Lungomare 2, qeveria qendrore dhe vendore ia ka vendosur në dispozicion privatit, duke i privuar qytetarët e vjetër dhe të rinjtë vlonjatë apo edhe të ardhur nga qytetet e tjera, që të pushojnë në kushte individuale?!

Si mund të pretendosh të kesh një industri të fuqishme turizmi në Vlorë, duke e kthyer atë në një destinacion kryesor turistik, duke ruajtur asetet e saj natyrore dhe kulturore, kur investimet në turizëm janë vetëm reklamë dhe *show*, dhe nuk janë aty ku ka më shumë nevojë, nuk janë në kohën e duhur?!

Pikërisht tani që pritet të fillojë sezoni turistik, infrastruktura është e bllokuar; investimet që po kryen në det e ulin ndjeshëm cilësinë e ujit, cilësinë e detit, pastërtinë e tij dhe për rrjedhojë edhe frekuentuesit, pushuesit do të jenë më të pakët.

Sipas mendimit tim, në mënyrë të përmbledhur, turizmi në qytetin e Vlorës mund të karakterizohet si një turizëm që nuk është i orientuar me politika të drejta dhe të sakta, por me problematika të ndryshme, të shumta dhe të mprehta, si, për shembull:

- mungon një sistem, që të lehtësojë çdo procedurë të investimeve në fushën e turizmit, me prioritet turizmin lokal;

- zyrat e turizmit në bashkitë Vlorë, Sarandë dhe Himarë nuk kanë staf të kualifikuar dhe nuk kanë programe të qarta, programe konkrete pune;

- mungon një strategji dhe një plan konkret nga qeveria për uljen e barrës fiskale në industrinë e turizmit, për të unifikuar në nivelin e ulët TVSH-në për njësitë akomoduese dhe për restorantet e baret turistike, gjë që e kemi ngritur edhe kur kemi diskutuar për paketën fiskale;

- *tour*-operatorët ndihen krejtësisht të pambështetur; mungon suporti në promovimin e paketave të tyre turistike; mungon mbështetja financiare; ka nevojë për ulje deri në zerim të taksave vendore, ulje të taksave dhe tarifave kombëtare, si dhe për programe qeveritare për zhvillimin e ofertave turistike në trekëndëshat e artë të atraksionit vlonjat, si: Vlorë-fshatrat e Lumit të Vlorës-Kaninë; Himarë-Kuç-Kanionet e Kurveleshit; Dukat-Tragjas-Rradhimë; Vlorë-Himarë-Delvinë e të tjera;

- largimet masive të rinisë kanë sjellë mungesë të theksuar të stafëve në sektorin e turizmit, duke e dëmtuar seriozisht atë dhe duke vënë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve turistike;

- ka mungesë të shkollave apo të kualifikimeve profesionale në qytet dhe në qark, të cilat duhet të jenë të aksesueshme, si dhe duhet të ketë politika motivuese për to, por dhe marketing të gjerë, për të nxitur të rinjtë të

trajnohen (të famshmes Shkollës Tregtare të Vlorës i ka humbur shkëlqimi);

- mungon një program i dedikuar për trajnimin e vazhdueshëm në distancë të personelit të njëjësive akomoduese të qarkut të Vlorës, të guidave turistike e të tjerë;

- nuk ka asnjë plan dhe asnjë masë konkrete për fuqizimin e mjeteve detare të operatorëve turistikë të qarkut të Vlorës;

- vijon të jetë kronike në qarkun e Vlorës problematika e mprehtë e derdhjes së ujërave të zeza në det;

- mjedisi turistik, sidomos gjatë fluksit turistik në verë, nuk mirëmbahet dhe nuk ruhet, as në qytet dhe as në të gjithë qarkun;

- mungojnë investimet në menaxhimin e mbetjeve dhe të ujërave të zeza dhe të bardha, bashkë me kujdesin për mjedisin;

- mungojnë rimbursimet ndaj aktivitetit turistik për periudhat jashtë sezonit veror, të cilat janë të shumta në të gjitha vendet e rajonit;

- TEC-et lundruese, që ju si mazhorancë, ia bëtë peshqesh Vlorës, ndikojnë negativisht në florën dhe faunën e Vlorës;

- mungojnë kontrollet supërvizuese dhe suportuese e të tjerë.

Përfundimisht, mund të thuhet se të dyja qeverisjet, si ajo qendrore dhe ajo lokale, por sidomos ajo qendrore, kanë dështuar plotësisht për ta shndërruar qarkun e Vlorës në një destinacion turistik të qëndrueshëm, gjithëvjetor, me oferta të qarta të turizmit të diellit dhe të detit; të turizmit kulturor dhe historik; të turizmit arkeologjik dhe të aventurës; të turizmit natyror dhe të agroturizmit.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Fjalën e ka zoti Shehu.

Ju lutem, të përgatiten zoti Saimir Korreshi dhe zoti Ludovik Hasani!

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë hyj te grupi i të diskriminuuarve këtu, që, në kundërshtim të plotë me Rregulloren, me të drejtat, jemi përjashtuar nga grupi parlamentar nga një “patericë” e Ramës, pa dyshim, e komanduar nga Kryeministri juaj.

Zonja drejtuese e seancës,

Këto zgjedhje ishin një komplot kundër demokracisë, pluralizmit dhe PD-së; këto

zgjedhje çuan në konsolidimin e autokracisë shqiptare; këto zgjedhje po na çojnë në rrugën e diktaturës. Duhet të jemi shumë të vëmendshëm dhe shumë të qartë midis nesh, ky është edhe produkt i këtyre zgjedhjeve. Nuk është vetëm çështja e parave që u hodhën në qarkun e Gjirokastrës, e zhavorrit elektoral që u hodh në Libohovë, e presionit të madh dhe dhunës që u zhvillua mbi arsimtarët, mjekët, kudo, në atë qark dhe në të gjithë Shqipërinë, por problemi është se këto zgjedhje ishin të dështuara dhe të deformuara pa filluar. Ishin zgjedhje, që realisht u zhvilluan pa opozitë, u zhvilluan me një PD të goditur nga të gjithë mekanizmat që janë në Shqipëri. Këto zgjedhje ishin kulmi i deformimit të demokracisë, u shpërbë emri i PD-së, ia shitën dikujt tjetër; u tentua të tjetërsohej lideri e koalicionit; realisht në mënyrë artificiale u tentua të krijohet një opozitë nga “patericat” e Ramës, pikërisht për të dëmtuar këto zgjedhje dhe procesin zgjedhor, për ta shkatërruar procesin zgjedhor. Ky është dëmi më i madh që i keni bërë demokracisë shqiptare. Shikojeni rezultatin si është, shikoni si po katandiset Shqipëria dhe demokracia shqiptare.

U paguan para, u tjetërsua sigla, u tjetërsuan vlerat e opozitës shqiptare dhe u shitën në dorën e dikujt tjetër.

Unë kam një pyetje: ç’u bënë ato 2 milionë euro, që u shpërndanë në prag të zgjedhjeve? Kush i ka marrë? Ku janë? PD-ja nuk ka marrë asnjë qindarkë! Po flas për PD-në, nuk po flas për “patericën”. Ku janë ato para?

*(Ndërhyrje nga salla)*

Unë kërkoj që këtu të dalë e vërteta, sepse ajo punë ishte një korrupsion madhor, ishte një blerje e opozitës, gjoja e një pjese të opozitës. Prandaj këto zgjedhje u katandisën kështu, sepse u përdor çdo mjet, që nga gjykatat, që nga KAS-i, që nga KQZ-ja dhe deri te paratë: para në Libohovë, para në Këlcyrë, para në Përmet, në Gjirokastrë, kudo, në të gjithë Shqipërinë, por edhe këtu, madje përdorët edhe “patericën”, e cila rrëzoi Arjanin në Këlcyrë vetëm pse ju e vutë atë nëpërmjet “patericës” që keni pasur këtu, në këtë sallë.

Prandaj, këto zgjedhje shënojnë një goditje të madhe për demokracinë; shënojnë një demokraci në agoni në Shqipëri; shënojnë Shqipërinë drejt konsolidimit të autokracisë.

Unë besoj se edhe kolegët e tjerë deputetë të mazhorancës, të cilët në pamje të parë mund të

jenë të kënaqur nga ky rezultat, në thelb duhet të jenë të shqetësuar, shumë të shqetësuar, sepse në këtë vend është deformuar thellësisht demokracia dhe asnjë nuk e di se ku do të shkohet nëse njerëzit nuk do të ngrihen dhe t’i kundërvihen diktaturës, e cila po e vesh këtë Shqipëri në mënyrën më të rrezikshme të mundshme.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Shehu!

Më duhet të bëj një ndryshim në radhën që njoftova pak më parë, tani duhet të flasë zoti Florenc Spaho, sepse më kaloi dhe nuk e përmenda emrin. Kështu që, edhe për harmonizimin e radhës, do të flasë një nga Grupi Parlamentar i PS-së dhe më pas do të vijojmë me radhën siç u njoftua.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, por deri tani kanë folur deputetë të opozitës dhe asnjë deputet i shumicës. Kështu që, zoti Florenc e ka fjalën.

**Florenc Spaho** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, mendoj se zgjedhjet e 14 majit mbaruan dhe nuk dëshiroj të zgjatem, sepse qytetarët folën dhe na votuan në të gjithë Shqipërinë, kryesisht në qarkun e Elbasanit, ku patëm një rezultat historik 7 me 0 për bashkitë e Elbasanit. Por, meqenëse jam deputet i Elbasanit dhe kolegu Noka foli për Elbasanin, për zgjedhjet farse, për intimidim votash, qytetarët e Elbasanit nuk harrojnë, sepse ka dalë edhe në medie apo në portale, që zoti Noka hynte nëpër qendrat e votimit duke intimiduar vëzhguesit dhe anëtarët e komisionit.

Gjithashtu, qytetarët e Elbasanit nuk mund t’i harrojnë ato më shumë se 20 makina, si një eskortë, që lëviznin rrugëve të Elbasanit natën, kryesisht rrugëve të lagjeve periferike.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Po, patjetër, kemi edhe targat e atyre makinave që lëviznin, të cilat drejtoheshin nga pjesëtarë të opozitës apo të grupit “Bashkë fitojmë”, nuk e di, një parti që thotë se quhet “Partia Demokratike”, por te emrat që janë vënë te këshillat bashkiakë të Elbasanit nuk është asnjë nga PD-ja, janë të gjithë të partisë tjetër, por gjithsesi.

Zonat që unë mbuloj janë rajoni 2 dhe rajoni 3. Këtu dua të falënderoj të gjithë ekipin e



palodhur të PS-së, në mënyrë të veçantë rajonin 2 në Elbasan, që për herë të parë, pas shumë vitesh, edhe pse njihet si një zonë që shpesh mund të dilte barazim apo mund të fitonte opozita, vlerësoi PS-në! Ju e morët përgjigjen e merituar, sepse u munduat të intimidoni votat, duke u futur me nga 20 makina eskortë në këtë lagje për të intimiduar edhe qytetarët, madje këtë përgjigje e morët edhe nga lagja “Brigada” në Elbasan, që votuan PS-në, pra nga qytetarët dhe banorët e kësaj lagjeje të mrekullueshme, sepse nuk mundën t’i bashkëngjiteshin asaj kërkesë që vinte nga opozita. Unë nuk dua të flas shumë për zgjedhjet, sepse qytetarët folën më 14 maj.

Ata na besuan, sepse ne dimë të punojmë. Patjetër që duam të bëjmë akoma më shumë, por mundësia nuk është aq e madhe sa dëshira, e cila është shumë herë më e madhe. Ne dimë të kërkojmë falje nëse nuk i kemi arritur objektivat, por jo për fajin tonë. Edhe sot, afërsisht 3 javë pas zgjedhjeve, vijmë në parlament dhe themi: ishin zgjedhje farse; kanë intimiduar; kanë bërë këtë, kanë bërë atë. Por, siç e thashë, nuk dua të ndalem dhe të flas shumë për zgjedhjet, por dua të falënderoj të gjithë qytetarët e Elbasanit për votëbesimin dhe përgjegjësinë që na kanë dhënë!

Gjithashtu, dua të falënderoj Shoqatën e të Verbërve në Elbasan, me të cilët diskutuam javën e “gjelbër”! Ata më deleguan dhe më besuan të sjell një çështje që i shqetëson. Ne jemi këtu për të sjellë çdo problematikë që na adresohet nga qytetarët për të marrë një zgjidhje. Shoqata e të Verbërve në Elbasan përbëhet nga 800 anëtarë. Mua më kontaktoi një grup i vogël, të cilët kishin 2 apo 3 kërkesa. Sinqerisht ngela i suprizuar, sepse ne kemi bërë shumë për këto shtresa, por ka edhe shumë për të bërë. Ata kërkojnë që shoqëruesve të këtyre njerëzve, që janë në grupin e parë, t’u njihet siguracioni.

Nëse një person i këtij grupi ka edhe bashkëshorten me aftësi të kufizuara, nuk mund ta marrë këtë pagesë, ndaj ata kërkojnë që kjo pagesë t’u kalojë atyre dhe ta zgjedhin vetë personin që do të jetë shoqëruesi dhe ndihmësi i tyre.

Gjatë viteve 2005 – 2010, sipas ligjit në fuqi të asaj kohe, pensionet e invaliditetit rriteshin vit për vit. Më shumë se 100 persona të këtij grupi nuk e kanë përfutur këtë rritje, ndryshe nga shumë shoqata në qytete të tjera, që e kanë apeluar, e kanë çuar në gjykatë dhe e kanë përfutur këtë rritje. Kjo shoqatë e ka bërë

kërkesën në gjykatë që para 4 vjetësh dhe pret që t’i dalë data e gjyqit për ta përfutur atë.

Një informacion: të njëjtën gjë ka bërë edhe Shoqata e të Verbërve në Durrës, edhe në Berat, e cila e ka përfutur para muajit dhjetor.

Duke i falënderuar për besimin dhe për delegimin e kësaj çështjeje shumë shqetësuese që i përket kësaj shtrese, shpresoj që institucionet ta marrin në konsideratë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Spaho!

Zoti Noka, përse e keni kërkuar fjalën?

**Flamur Noka** – E kërkoja fjalën për replikë, sepse m’u përmend emri.

Kolegut që më përmendi emrin, dua t’i them: po, kam dalë në të gjitha qendrat e votimit të qytetit të Elbasanit, sepse kisha informacion se operatorët e famshëm po votonin 1 në çdo 3 persona. Pra, informacioni ishte se 30% të votimit po e kryenin vetë operatorët, në kundërshtim me ligjin. Ndaj kam dalë t’u kërkoja operatorëve të mbanin distancë dhe komisioni të funksiononte. Për faktin se unë u kërkoja operatorëve të mos përziheshin në qendrat e votimit për të votuar, prokuroria e Edi Ramës, me propozim të kandidatit për Bashkinë e Elbasanit, hapi një hetim për mua. Ndërkohë, nuk u hap hetim për drejtorët që unë gjeta në çdo qendër votimi, në çdo oborr të qendrave të votimit duke kërcënuar e shantazhuar votuesit që të votonin Rilindjen dhe të tregonin votën me foto. Nuk u hap hetim për operatorët, të cilët u rrinin në kokë dhe votonin për qytetarët.

Po i them zotit Spaho se gjeta në Shirgjan, aty ku kërkuam hetim për mua, printerin e mbuluar që qytetari të mos shihte se kë votonte. Pse? Sepse operatori rilindës klikonte dhe vetëm klikonte. Nuk kishte mundësi shteti të hetonte operatorin, jo, por më hetoi mua që thashë: hiqeni atë fletë dhe ti zonjë që je operatore, duhet të mbash distancë. Ky ishte krim i madh për rilindjen, sepse atje nuk donin 1 në 3 veta, por 3 në 3 vota të votonte operatori për Rilindjen.

Po në Belsh çfarë ndodhi?

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, përfundoi koha e replikës.

**Flamur Noka** – E mbarova!

**Ermonela Felaj** – Keni 30 sekonda.

**Flamur Noka** – Në Belsh mbaroi votimi dhe fitoi Bedri Qypi, por i thanë: “Prit se janë edhe votat e burgut”. Asnjë i burgosur nuk ishte nga

Belshi, por të gjithë të ardhur nga vende të tjera dhe kutia u mbush nga zero. Këtu ndodh edhe një çudi e madhe: në të gjithë botën të burgosurit votojnë kundër qeverisë, ndërsa këtu të gjithë të burgosurit, të lumtur dhe me duartrokitje, paskan votuar qeverinë. Ky është turp, është neveri! A e dini se çfarë jeni ju? Ju jeni të neveritshëm...

**Emonela Felaj** – Faleminderit, zoti Noka!

Fjalën e ka kërkuar ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, zonja Spiropali.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

**Elisa Spiropali** – Ju marr leje juve.

Gjatë viteve 2013, 2015, 2017, 2019, 2021 dhe 2023 janë 6 palë humbje dhe ju nuk keni nxjerrë asnjë mësim, zero. Sipas jush zgjedhjet ose i fitoni ju ose janë të manipuluar. Deri tani, këtë e thoshit përpara votuesve tuaj për t'u justifikuar, ndërsa tani keni filluar ta besoni edhe vetë.

Siç thotë Presidenti Biden, Presidenti i atij shteti që jua ka vendosur vulën e *non grata*-s në ballë: “Kjo mendësi fillon e bëhet e rrezikshme për demokracinë”.

Të pranosh humbjen është po aq e rëndësishme sa të planifikosh fitoren. Ju, në këta 10 vjetët e fundit, jo vetëm nuk keni ditur të planifikoni fushatë, fitore jo e jo, por nuk keni pranuar asnjëherë humbjen. Këto janë deklaratat që bëni: “Nga fitorja në fitore”; “Lufta nis tani”; “Lufta s’ka mbaruar” e të tjera. Nuk ka rëndësi nëse jeni të foltores, të vulës apo jeni bashkë, këtë diskurs e trashëgoni nga njëri te tjetri. Edhe kur humbja ka qenë e ngushtë, edhe kur ka qenë e thellë, si kjo që sapo ju ndodhi, ju po njësoj. Oferta juaj për shqiptarët ka qenë vetëm një: balta mbi kundërshtarin, duke sjellë si alternativë, sot në vitin 2023, tre personat më të urreyer në Republikën e Shqipërisë, Ilirin, Saliun dhe Monikën.

Kur ka votim elektronik, thoni se është manipuluar sistemi dhe e kanë bërë operatorët. Kështu e justifikoni humbjen e thellë në Kamëz, në Elbasan dhe në Vorë. Nëse doni ta dini përse keni humbur në Kamëz, mjafton të shikoni se si është Kamza sot dhe si e latë, kur e qeverisnit me dy gishtat lart dhe me bulevardin blu. Nuk ka nevojë t’jua them unë: me çerdhe, me kopshte, me shkolla, me rrugë, me kanalizime dhe me një kryetar bashkie si Rakip Suli, që u rri njerëzve nga mëngjesi deri në darkë në dispozicion, i cili nuk i merr për t’u garantuar, nuk i ka në xhep, por punon përditë për ata.

Pas humbjeve që pësuar nga votimi elektronik, vijnë humbje edhe më të thella përmes votimit manual, si në Shkodër, ku nuk ishte një humbje, por ishte përmbysje, ishte votë plebishitare kundër jush. Pra, ju jeni me 22 mijë vota minus atje, po ashtu në Tropojë, Lezhë, Kukës dhe në vende të tjera. Sërish, fajin sipas jush e ka çdokush tjetër përveç jush, sepse ju jeni të fituar; ju do të shpallni revolucionin; ju prisni beteja të reja dhe do të dilni në rrugë bashkë me njerëzit që nuk ju vijnë kurrë, sepse ju kanë braktisur në qendrat e votimit dhe në rrugë po e po. Keni arritur deri aty sa të mallkoni shqiptarët që nuk ju votuan, si në rastin e Astirit në Tiranë, aty ku veç ju nuk e shikoni zhvillimin, dhe ku humbët edhe më thellë se në të kaluarën, pavarësisht përpjekjeve titanike të ish-deputetit tuaj dhe librit të tij të ndritur “Unaza”.

Zgjedhjet e 14 majit i dhanë Partisë Socialiste një barrë shumë më të madhe se ajo e 4 vjetëve më parë. Nëse në vitin 2019, nga bojkoti juaj, ne u detyruam të qeverisnim shumicën dërrmuese të bashkive, pra 60 bashkitë përveç Shkodrës, sot 4 vjet më vonë janë shqiptarët që na besuan me votën e tyre duke na dhënë 54 nga 61 bashki, përfshirë edhe Shkodrën. Pra humbja juaj sot është më e madhe se në vitin 2019, kur nuk morët pjesë fare. Nuk është humor, por është e vërteta e hidhur. Kjo fitore flet shumë, qoftë për punën dhe rezultatet tona, qoftë për ofertën dhe premtimet tuaja.

Partia Socialiste i fitoi zgjedhjet në 54 bashki, në të cilat jeton 96% e popullatës. Partia Socialiste, nga këto zgjedhje, do të ketë 757 këshilltarë, 2,6 herë më shumë se “Bashkë firojmë” jo fitojmë, e cila ka 292 këshilltarë.

Kandidatët tanë kanë marrë 790 000 vota dhe në vitin 2021 morën 768 000 vota, pra 22 mijë vota më shumë nga zgjedhjet në zgjedhje. Kandidatët e koalicionit “Bashkë firojmë” morën 507 000 vota, pra 223 000 vota më pak se ai që këndonte himnin, të cilin ju rëndomtë e tallnit, por siç duket doli më i zoti dhe më i besueshëm se ju; ose të gjithë bashkë jeni më pak sesa keni qenë dhe sa më shumë të bëheni, aq më pak do të merrni.

Numrat bëhen edhe më dramatikë kur flasim për votën e partisë, asaj që ka mbetur, sepse nuk është më parti. Koalicioni i errësirës mori 248 000 vota. Pra, vetëm 1 në 3 votues nga ata që keni pasur në vitin 2021, ju kanë mbetur sot.

Vetmia juaj është edhe më e madhe nga sa mendoni ju. Edi Rama nuk e blen dot të shkuarën tuaj, të shkuarën e Sali Berishës, Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit. Shqiptarët votuan 2 herë fort kundër jush dhe pro Edi Ramës.

Unë nuk do të flisja sot për këtë çështje, sepse e kemi ezauruar në diskutime të tjera, në rast se Sali Berisha dhe të tjerë nuk do të kalonin sot Morinën për hallet e tyre. Rrini brenda kufijve të Republikës dhe mos kaloni Morinën sa herë keni hallet tuaja. Nuk i kontrabandoni dot problemet dhe hallet tuaja në kurriz të Kosovës, siç keni bërë shpesh dhe siç keni bërë rëndom.

Shëndet! Shihemi në zgjedhjet e radhës.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, jo, nuk keni të drejtë për replikë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk replikoi me ju fare, sepse ajo pati të drejtën e saj të fjalës.

Fjalën e ka zoti Korreshi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Noka, nuk keni të drejtë të flisni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, në këtë forum nuk keni të drejtë të flisni.

Zoti Korreshi, fjala për ju. Keni 3 minuta në dispozicion.

**Saimir Korreshi** – Faleminderit!

Unë u mallëngjeva nga fjalimet e kolegëve të mazhorancës, ndaj, meqenëse çdo gjë paska vajtur vaj, edhe po ju sjell disa falënderime nga Lushnja.

Së pari, falënderimet janë nga lushnjarët që tashmë janë kthyer në fshatin më të madh të Fierit. Ata prisnin se mos bëheshin Prefekturë, prisnin se mos u rikthehej nënprefektura, por jo. Ata thanë: shyqyr që u zgjodhën 3 deputetë nga mazhoranca, një nga opozita dhe një nga Divjaka, fshat më fshat dhe inshalla po i fusin në skemën e ligjit nr. 7501, që të kenë edhe ata mundësi të punojnë ndonjë gjë, sepse gjë tjetër nuk ka në Lushnjë.

Unë ju falënderoj që na hoqët prokurorinë dhe gjykatën! Jemi shumë mirë, kemi 3 muaj që presim për një çështje, të cilën e kemi hedhur që në prill, me kismet po doli nga korriku, të bëjmë edhe plazhin, dhe nga shtatori mbase na del seanca e parë.

Reforma në drejtësi po ecën për mrekulli.

Gjithsesi, na u bë qejfi dhe thamë shyqyr që na iku Apeli i Vlorës, se menduam që do të

shkonim në metropol, por shkuam atje për ndonjë seancë të parë, se kishim datat dhe na thanë: “Ejani pas 7 vjetësh, të mbarojnë dy mandate njëherë, pastaj, me kësmet, mund të bëjmë ndonjë seancë”! Vazhdon me ritme të fuqishme reforma në drejtësi!

Na ikën edhe drejtoritë! Po si ka mundësi që një qytet me 200 mijë banorë, nuk ka më absolutisht asnjë drejtor?! A i quani ju të mazhorancës ato votat e Lushnjës apo jo?! Vendosni të paktën një drejtor nga Lushnja atje në Fier, ndonjë punëtor apo ndonjë autobus, që të ikin të shkretët si aksionistët në atë kohë, se i keni kthyer të gjitha si në fshat. Si ka mundësi që në të gjithë qarkun nuk ka asnjë drejtor nga Lushnja?! Kush ma shpjegon dot se si ka mundësi? Kaq pa vlerë qenkemi ne?! Kaq inat e keni Lushnjën? Kemi frikë të vëmë kollare në Lushnjë, se na thonë: “Çfarë është, dita e Kongresit të Lushnjës?”, por e vendosim sa kalojmë Rrogozhinën. I vetmi me kollare në Lushnjë, jam unë. Pse duhet ta vendos unë kollaren, kur atje nuk ka asnjë drejtor dhe asnjë lloj gjëje tjetër?

Këta të mazhorancës mbase i kanë rregulluar kalamajtë e tyre, por unë kam hallin e kalamajve të mi, pasi në Lushnjë nuk ka asnjë lloj punësimi, as në privat dhe as në shtet. Pra, unë nuk u lë dot trashëgimi as lopatën dhe as kazmën, se nuk kam tokë. Si do t’ia bëjnë fëmijët e mi? Meqë ju i morët votat, meqë triumfuat me bashkitë dhe meqë i keni marrë të gjitha, shikojeni, se mbase e zgjidhni edhe këtë problem.

Ju falënderoj, sepse dy ditë më parë i gjithë fisi im shkoi drejt Fierit, se në spitalin e Lushnjës vetëm synetllëqe bëhen! Daja im ishte bërë synet, por u operua nga tëmthi. Të gjithë si fis ne shkuam me autobus nga Lushnja për në Fier. Ky është turp i madh për një qytet me 200 mijë banorë. Por, gjithsesi, ne bëmë një piknik deri në Fier. Ai u operua dhe doli mirë, por Lushnja është fshat e më fshat!

Kryetarja e Komisionit të Ligjeve përmendi se legalizimet duhen bërë me blloqe. Po, është e vërtetë se legalizimet me blloqe janë bërë, por janë bërë me blloqet e PS-së, për të diktuar se cili ishte i Partisë Socialiste dhe cili do t’ia jepte votën partisë, se të tjerët opingat e Sheros morën. Kam edhe unë një aplikim, por do ta rregulloj më vonë këtë punë, se vetëm 3-4 javë kanë kaluar nga zgjedhjet.

Ju falënderoj për tregun e stadiumit, se më në fund dolën edhe njerëzit në protestë! Shyqyr që e bëtë si serë tregun e stadiumit! Ata qeshin, ndërkohë që ju u vendosni tarifën prej 50 mijë lekësh në muaj. Ata domate dhe sallatorë shesin të shkretët, të mos e paguajnë 50-mijëlekëshin ata?! Të paktën vendosni ndonjë roje atje, që t'u ruajë produktet në darkë, se po ua vjedhin dhe të shkretët nuk po i gjejnë më produktet!

Ju falënderoj, se keni disa ditë që keni hapur fushën e plehrave në Saravë, sepse inceneratori është mbyllur dhe nuk e dimë se çfarë ka. Mirë që u liruan dung-fungët nga zgjedhjet, dhe tani po i çojnë plehurat te fusha. Shyqyr që këtë behar do të ndizen dhe do të marrim erë... Fabrikat me pelet, edhe pse nuk kanë leje nga Ministria e Mjedisit, vazhdojnë të punojnë dhe ne e kemi erën e ullirit në çfarëdolloj muaj të vitit.

Ka shumë për të folur për bujqësinë, por meqenëse folën të tjerët, unë po ju them vetëm një gjë: iku domatja e sallatori, po me shalqirin çfarë do të bëjmë? Shikoni sa ka dalë çmimi i referencës së grurit! 27 mijë lekë është në bursë. Si do ta llogarisni ju grurin? A i keni bërë hesapet?

Falënderimi i fundit vjen për përroin e qytetit. Shyqyr që na u bë përroi me standarde europiane, se po të gëlltisim një gjë kemi kohë të shkojmë ta gjejmë te përroi, pasi të gjitha ujërat e zeza atje derdhen! Meqenëse jemi te ura e përroit, inshallah hapin ndonjë fjalë patronazhistët tuaj, që të shtoni rojet matanë e këtej urës, se kanë shumë qejf të bëjnë xhiro.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Korreshi!

Zoti Ludovik Hasani e ka fjalën.

Besoje se edhe për ju është hera e parë që diskutoni në Kuvend, kështu që i ftoj kolegët t'ju dëgjojmë me respekt. Suksese!

**Ludovik Hasani** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si përfaqësues i një treve që pas 14 vjetësh ka zërin e saj në Kuvendin e Shqipërisë, si pasojë e ligjit elektoral, dëshiroj të adresoj disa problematika.

Krahina e Pukës, me një shtrirje territoriale prej 1034 kilometrash/katrorë, që vazhdon nga Laçi, Vau i Dejës dhe përfundon ngjitur me Tropojën e Kukësin, ka në përbërjen e saj dy bashki: Bashkinë e Pukës dhe Bashkinë e Fushë-

Arrëzit, të cilat janë të njohura brenda dhe jashtë vendit për resurse dhe pasuri mbitokësore dhe nëntokësore.

Mungesa e investimeve afatgjata, aneksimi i kësaj treve nga arteriet kryesore të transportit publik, mungesa e një vizioni të qëndrueshëm për një rimëkëmbje ekonomike ka sjellë një realitet të zymtë, që shoqërohet me largimin masiv të popullsisë. Fshatra të tëra po zhbëhen nga harta dhe qytetarët janë në gjendje alarmante.

Ndaj, sot gjej rastin që nga kjo foltore t'i drejtohem Kryeministrit të Shqipërisë dhe ministrave përkatës që t'i kthejnë sytë nga këto zona, të hartojnë politika të posaçme lehtësuese dhe përjashtuese në fusha të ndryshme dhe të marrin në konsideratë vështirësitë e shumta me të cilat përballen këta banorë, që nga dimri i ashpër, i cili zgjat me muaj, e deri te stërmundimi i tyre për të gjetur tregun e gjërave më elementare, pasi shumë fshatra janë pa drita, pa ujë e pa transport publik.

Të dyja bashkitë kanë nevojë për mbështetje, për financime projektsh, për investime, për nxitje punësimi, pra meritojnë vëmendje dhe vlerësim të posaçëm për atë çka përfaqësojnë në shumë aspekte.

Kolegë të nderuar,

Kam bindjen se kjo panoramë për shumë nga ministrat e kabinetit duket pak e ekzagjuar, pasi atyre u shkojnë raportime të tjera nga strukturat dhe dikasteret e linjave që, shpeshherë, për t'u bërë qejfin titullarëve, japin pasqyrime të pavërteta. Sot nga kjo foltore dua t'u them atyre që, nëse do të shkonin në terren, do të gjenin në këto treva copëza të një Shqipërie migjeniane, që më 14 maj vendosën të mos e kapërdinin kafshatën e mjerimit.

Meqenëse jemi në atmosferën paszgjedhore, shpreh shqetësimin tim për klimën në të cilën u zhvilluan zgjedhjet e 14 majit. Në të dyja bashkitë, si në Pukë dhe në Fushë-Arrëz, përpos administratës tejet të politizuar, përfshirjes masive të institucioneve dhe përdorimit të aseteve politike, alarmante ishte shitblerja e votës. Edhe pse kandidatët tanë të koalicionit "Bashkë fitojmë" janë fitues në këto dy bashki, fushata u zhvillua në një klimë të ashpër. Kjo nuk është retorikë, pasi nga ana jonë fenomene të tilla janë të pasqyruara me zë dhe me figurë. Gjej rastin sot të falënderoj të gjithë votuesit e Bashkisë së Pukës dhe Bashkisë së Fushë-Arrëzit, të cilët nuk janë

ndikuar nga thirrje dhe retorika të ndryshme, por kanë vlerësuar profilin e thjeshtë dhe qytetar të kandidatëve të opozitës, angazhimin e tyre në jetën sociale dhe politike, duke ndëshkuar me votë modelin arrogant të drejtuesve vendorë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Hasani!

Fjalën e ka zoti Vullnet Sinaj, 5 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zonja Erisa Xhixho.

**Vullnet Sinaj** – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, fjalën time do ta kisha nisur me një urim për deputetët e rinj që kanë marrë mandatin në këtë sesion parlamentar (shikoj që vetëm njëri ka mbetur këtu), të cilët kanë filluar të mësojnë pak mbrapsht nga parlamenti.

Në vazhdim dua të them se shqiptarët u besuan plotësisht me votë kandidatëve të Partisë Socialiste në shumicën dërrmuese të bashkive të vendit, sepse modeli qeverisës i Partisë Socialiste, drejtuar nga Kryeministri Edi Rama, është në mënyrë absolute alternativa e punës, është alternativa e bashkëqeverisjes me qytetarët.

Gjithkush nga ju që nuk do të respektojë verdiktin e popullit, të shprehur me votë, në fakt, e fyen popullin. Duhet të jesh i marrë që të korrësh humbje pas humbjes dhe, në vend që të reflektosh, të përsërisësh alibinë e manipulimit. Gjithashtu, dua t'u them edhe deputetëve të opozitës, deputetëve të Vlorës, të cilët kritikojnë aq shumë për turizmin në Vlorë, që, nëse do të krahasojnë kritikën që bëjnë me atë çfarë është bërë në qytetin e Vlorës për turizmin, nuk ka absolutisht vend për krahasim. Këtë gjë ata e kanë provuar, sepse sa herë që kanë kritikuar, aq herë kanë humbur. Nga njëra anë, mirë bëjnë që flasin se na vënë edhe ne në moto për të punuar më shumë dhe për të garantuar gjithmonë fitoren e asaj bashkie.

Gjej rastin të falënderoj të gjithë banorët e Bashkisë së Selenicës për mbështetjen që i dhanë kandidatit të Partisë Socialiste, Nertil Bellajt, dhe t'i uroj atij suksese, bashkë me të gjithë kryetarët e rinj të bashkive, edhe ata pak të opozitës, të cilët uroj të punojnë pa bërë dallime ideologjike dhe politike dhe t'u shërbejnë qytetarëve në mënyrën më të mirë të mundshme!

Qyteti i Selenicës dhe fshatrat përreth përbëjnë një zonë shumë të gjerë, që i ngjan një qarku. Është një zonë rurale, që si bazë të saj ka punën në bujqësi dhe në blegtori. Zhvillimi i tyre ka një rëndësi të jashtëzakonshme për të rritur agroturizmin në këto zona.

Falënderoj qeverinë, veçanërisht Ministrinë e Bujqësisë, për angazhimin për rilindjen e bujqësisë dhe blegtorisë në vend! Skemat dhe paketat e subvencioneve për këtë sektor janë një ndihmë e jashtëzakonshme për fermerët shqiptarë, ndaj nuk mund të mos përmend arritjet e kësaj ministrie.

Rritja e eksporteve në periudhën janar-prill 2023 ishte me 5,3% në sasi dhe 12,1% në vlerë, që krahasuar me periudhën janar-prill 2022 janë një fakt i mirë, që tregon për zhvillimin e bujqësisë në vend.

Po ashtu, përthithja nga IPARD II e investimeve të Komunitetit Europian ishte në vlerën rreth 94 milionë dollarë, ku pothuajse të gjitha u përthithën nga programet e fermerëve shqiptarë dhe sollën si rezultat që në projektin IPARD III të kemi një rritje me 146 milionë euro. Bashkë me këtë shifër në euro kemi edhe 9 masa, pra në krahasim me IPARD II ka edhe 6 masa më tepër, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin akoma më tej të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në vend.

Me gjithë këto falënderime, unë jam i bindur se vëmendja e Ministrisë së Bujqësisë është te bujqësia dhe blegtoria, por, gjithashtu, dua të shpreh disa sugjerime dhe shqetësime të banorëve të zonës ku unë jam deputet, të Selenicës dhe të Himarës.

Shqetësimi i parë që kam është për aplikimet për naftën falas për ata fermerë që kanë toka me qira. Sipas udhëzimit të përbashkët nr.5, datë 03.03.2023 “Për kriteret dhe procedurat dhe për mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësisë dhe zhvillimin rural”, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave, në rastet kur tokat janë marrë me qira kërkohet marrëveshje dakordësie e firmosur nga pronari i tokës dhe fermeri, e shoqëruar me kartat e identitetit të palëve dhe e vërtetuar nga njësi administrative, ndryshe nga një vit më parë, kur mjaftonte vetëm vetëdeklarimi i fermerit dhe vërtetimi nga njësi administrative. Kjo gjë ka sjellë pengesa në përthithjen e subvencioneve apo të naftës falas nga këta fermerë, pasi është shumë

e vështirë të gjesh të gjithë pronarët e tokave, për arsye të cilat ne i dimë shumë mirë: mund të jenë larguar në emigracion, nuk gjendet karta e identitetit apo ka njerëz që kanë ndërruar jetë dhe nuk janë bërë ndryshimet nga familjarët e tyre. Unë do t'i propozoj ministres së Bujqësisë që të kthehet te rregullat e vitit të kaluar për sa i përket mënyrës së dhënies së ndihmës për naftën falas.

Shqetësimin e dytë e kam për disa blegtorë, të cilët i kanë paguar me vonesë sigurimet shoqërore. AZHBR-ja, me anë të një njoftimi me numër protokollit 1479, të datës 20 prill, caktoi si afat të fundit për plotësimin e dokumentacionit datën 8 maj, por janë mbi 100 blegtorë të zonës së qarkut të Vlorës, të cilët nuk kanë arritur t'i paguajnë sigurimet shoqërore brenda kësaj date. Unë do t'i lutesha ministres së Bujqësisë që të mos i penalizojë këta blegtorë për të përfituar subvencione në blegtori ose të krijojë mundësi për ta shtyrë afatin e plotësimit të dokumenteve.

Të nderuar kolegë,

Këto nuk janë vetëm disa kërkesa që i parashtrova unë si përfaqësues i një zone rurale, por mendoj se janë problematika që mund t'i kenë të gjithë në bashkitë e tyre për fermerët dhe blegtorët.

Ju falënderoj për vëmendjen!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka zonja Erisa Xhixho, 5 minuta në dispozicion.

**Erisa Xhixho** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gati 1 vit më parë miratuam të gjithë bashkë një ligj shumë të rëndësishëm: regjistrin për të dënuarit për krime seksuale. Pas një pune shumë intensive me shoqërinë civile, ku u gjet dakordësia me Komisionin e Ligjeve, me Komisionin e Shëndetësisë dhe me Komisionin e Sigurisë, të gjithë bashkë vendosëm të krijojmë një mekanizëm parandalues shumë të nevojshëm për t'i bërë më të sigurta mjediset ku rriten fëmijët tanë.

Për të theksuar domosdoshmërinë e këtij mekanizmi, më lejoni t'ju kujtoj disa shifra. Gati 80% e krimeve seksuale kryhen ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve. Brenda afatit kohor 1 janar 2019–1 qershor 2020, 66 fëmijë kanë rënë pre e ngacmimeve dhe e dhunës seksuale nga persona të afërt apo janë dhunuar seksualisht nga familjarët e tyre, ku 3 prej tyre kanë qenë vajza, të

cilat janë vetëvrasarë. Patëm raste të mësuesve në Berat dhe në Lushnjë, të cilët, edhe pse kishin një vendim të gjykatës si të dënuar për krime seksuale, ishin bërë pjesë e sistemit tonë arsimor, duke rrezikuar në këtë mënyrë fëmijët dhe vogëlushët atje. Një fëmijë që bëhet viktimë e abuzimit seksual shënjohej përjetë; trauma e një abuzimi e shoqëron përjetë të abuzuarin dhe rrit rrezikun për ta shndërruar atë në abuzues më vonë. Abuzimi seksual gjeneron dhimbje, frustrim, humbje të vetëvlerësimit, humbje të besimit te njerëzit, depresion dhe në disa raste, edhe vetëvrasje.

Morëm për bazë të gjitha eksperiencat më të mira të vendeve të Bashkimit Europian, të rajonit; hartuam një ligj që synon të mbrojë fëmijët, të rinjtë, gratë dhe çdo individ nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual, duke siguruar që regjistri të jetë mjet efektiv për të identifikuar vendndodhjen e të dënuarve për krime seksuale dhe monitorimin e aktivitetit të tyre.

Jemi këtu 1 vit pas miratimit të ligjit, për t'u thënë të gjithë atyre, të cilët thonë gjithmonë se kemi ligje të mira por nuk kemi zbatim të tyre, që regjistri nuk është krijuar ende, edhe pse kam kërkuar zyrtarisht informacione nga organet përgjegjëse me qëllim nxitjen dhe vënien në zbatim sa më parë të ligjit.

Ligji hyri në fuqi më 22 janar 2023, 6 muaj pas miratimit të tij, por, fatkeqësisht, nuk është bërë ende i zbatueshëm, duke qenë hapur në shkëlqe me të. Përgjatë kësaj kohe, të gjitha institucionet përgjegjëse kishin kohën e mjaftueshme për të regjistruar të gjithë të dënuarit për krime seksuale dhe për ta vendosur regjistrin në dispozicion të palëve të interesuara, sipas përcaktimeve ligjore në *e-Albania*. Regjistri i mundëson Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera ligjzbatuese të identifikojnë dhe të monitorojnë grabitqarët seksualë, pedofilët dhe personat që kanë tendencë për të kryer krime seksuale, duke disponuar informacionin e detajuar për të dhënat personale, vendbanimin, rrethin shoqëror, komunikimin, veprimtarinë dhe punën e tyre. Regjistri, gjithashtu, garanton ndalimin e këtyre personave për t'u punësuar dhe për të qenë pjesë e personelit të institucioneve, agjencive, organizatave dhe çdo subjekti shtetëror dhe joshetëror që punon për fëmijët apo për persona të tjerë të rrezikuar ose të pambrojtur në Republikën e Shqipërisë. Ligji garanton dhe

ngarkon me përgjegjësinë e krijimit të regjistrimit brenda 6 muajve nga momenti i miratimit në Kuvend, një afat i shkelur tashmë nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Policia e Shtetit. Jemi përpara faktit që, pavarësisht se ligji është në fuqi nga muaji janar 2023, regjistri nuk është i aksesueshëm ende për publikun.

Si propozuese e këtij ligji, kam kërkuar informacion pranë institucioneve përgjegjëse për hartimin e regjistrimit, por përgjigja ka qenë se regjistri nuk është krijuar ende. Kalimi i përgjegjësisë nga njëri institucion në tjetrin, nuk është zgjidhje. Një ligj që është i tillë vetëm në letër, nuk i hyn në punë askujt.

Unë vijoj të mbetem e përkushtuar për ta çuar deri në fund këtë mision, ndaj i jam drejtuar së fundmi me një letër të gjithë ambasadorëve në vendin tonë, që cilatdo qofshin pengesat për regjistrin, ne duhet t'i kapërcejmë. Qytetarët shqiptarë kanë të drejtë të dinë nga kush duhet t'i ruajnë fëmijët. Këtë të drejtë jua kemi dhënë me plot 124 vota, ndaj krijimi i regjistrimit dhe zbatimi i ligjit mbeten një emergjencë.

Gjithashtu, do të kërkoj nga Kryetarja e Kuvendit, si drejtuese e Grupit të Deputetëve "Miqte e Fëmijëve", ku unë jam nënkryetare, të thërrasë një seancë dëgjimore me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe për të kërkuar llogari se përse jemi në shkelje të ligjit që është miratuar në Kuvend. Ky nuk është thjesht një ligj i radhës, por ka të bëjë me sigurinë e fëmijëve, të vajzave dhe djemve tanë, që të mos themi sërish "ishim vonë" për vënien në zbatim, siç ishim 10 vjet për miratimin e tij. Ne duhet të ushtrojmë të gjithë kontrollin parlamentar, që ligji të jetë eficient dhe i aksesueshëm për të gjithë, për të mos qenë vonë në ditët që do të vijnë, në mënyrë që, në momentin kur fëmijët tanë do të jenë në situata të tilla nga këta grabitqarë, të mos themi se ligjin e kishim, por u vonuam në zbatimin e tij.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Xhixho!

Kuvendi i Shqipërisë nuk i ka qëndruar indiferent shqetësimit tuaj, sepse u jemi drejtuar institucioneve dhe ndoshta është koha t'i ribashkojmë përpjekjet që kjo të ndodhë sa më parë.

Fjalën duhet t'ia jap deputetes Andia Ulliri, por nuk e shikoj në sallë, ndaj do të konsiderohet që ka hequr dorë nga fjala.

Fjala për zotën Spaho. Koha në dispozicion është 5 minuta.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Ndoqa ndërhyrjen e zonjës Spiropali për zgjedhjet, e cila u shpreh se oferta dhe premtimet e palëve ndanë rezultatin zgjedhor. Dikush tjetër shtoi se modeli qeverisës i Ramës i bindi qytetarët të jepnin votat. Unë do t'ju jap një shembull nga Bashkia e Maliqit, ku nga PS-ja kandidonte një individ që kërkonte mandatin e 7-të. 4 vjet më parë, oferta dhe premtimi i tij kryesor elektoral ishte se do të rivitalizonte kombinatin e sheqerit në Maliq, do të mbyllte panxhar, do të prodhonte sheqer, do të ndërpriste importin e të tjera. Çfarë ndodhi? Çfarë u ndërtua? U ndërtuan restoranti i peshkut, i Lucës, dhe zyrat e Partisë Socialiste. 4 vjet më vonë, oferta e këtij individ për zgjedhësit ishte se do të ndërtohej treni elektrik, që do të lidhte Maliqin me Pyllin e Fazanit.

Nga krahu tjetër, për PD-në kandidonte një doktor i nderuar, për mendimin tim, i cili bëri disa premtime të thjeshta: do t'i jepte zonës ujë për vaditje, duke rivitalizuar rrjetin vaditës dhe duke ringritur sistemin e pompave; do t'u jepte banorëve ndihmë për të shitur prodhimet bujqësore; do të ulte deri në 30% taksat dhe tarifatat, aq sa e lejon ligji; do të hiqte lejet për punime meremetimi, që sot kërkohen nga njësitë e qeverisjes vendore; do të përmirësonte dhe do të shtonte shërbimin shëndetësor, sepse në Maliq, për shembull, është inekzistent, dhe nuk ka spital.

Kush fitoi?! Fitoi ai që kërkoi mandatin e 7, i cili do të ndërtohte trenin elektrik, dhe fitoi më thellë se të gjitha herët e tjera. Nuk kishte ndodhur të fitonte kaq thellë. Fitoi mandatin e 7-të. Çështja e ofertës dhe e premtimeve mbi bazën e nevojave të qytetarëve, duket që nuk qëndron; duhet të ketë arsye të tjera pse ka fituar ky individ. Sipas asaj që unë konstatova në terren, më rezultoi se zotëria i përdori të gjitha burimet shtetërore: administratën e kishte në sulm frontal për të mbledhur vota; kush nuk voton për PS-në, do t'i pritë ndihma ekonomike, do të ngordhë për bukë (edhe imagjinojeni ta bësh këtë kërcënim në një nga bashkitë më të varfra të Republikës); policia bashkiake u lëshua gjithandej së bashku me tatimorët: "Bëhuni gati! Kush nuk voton për ne,

ka gjoba”; janë dhënë leje ndërtime pafund; janë bërë premtime për legalizimet, duke u thënë të sillnin letrat, se do të legalizoheshin; janë bërë punësime pa kriter; administrata në Maliq është shtuar dy apo trefish më shumë dhe janë bërë, gjithashtu, investime elektorale, madje mori paralajmërim edhe nga KQZ-ja se duhej t’i ndërpriste urgjentisht investimet elektorale, por as nuk donte t’ia dinte për këtë punë; shtojmë edhe 50 mijë lekët e pensionistëve; kërcënimet e Kryeministrit për votuesit e djathtë se, po fitoi ndonjëri nga ata, nuk do të ketë para dhe investime, por do të ngelen ashtu siç janë, si dhe blerjen e votave.

Çfarë ndodhi në qendrat e votimit?

*(Bie gongu.)*

Edhe një minutë dhe do ta mbaroj.

Në qendrat e votimit 3787, 3789/1, 3790, 3793/1, 3794/1 dhe 3776 (kjo sipas procesverbaleve që ka mbajtur KZAZ-ja e Bashkisë së Maliqit) kemi fletë votimi pa vula, por të shpallura të vlefshme. Gjithashtu, nuk përputhet numri i zgjedhësve, që janë identifikuar nga aparati, me fletët e votimit të përdorura në qendrat e votimit 3790, 3792, 3795, 3813, 3815. Po kështu, nuk përputhet numri i fletëve të përdorura me numrin e fletëve në kuti. Edhe për këtë i kam qendrat e votimit, por, meqenëse zonja po më bën shenjë që më ka mbaruar koha, po them edhe të fundit se komisionerët e të gjitha qendrave të votimit ishin punonjës të administratës, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor.

Në këtë foton këtu mund të shikoni se ky personi me rreth, është një i dënuar me 8 vjet burg për përdhunimin e dy turistëve suedeze; ka ardhur nga Greqia për të numëruar votat në emër të Partisë Socialiste në KZAZ-në e Maliqit. Këtij ia kemi lënë në dorë numërimin e votave.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Spaho!

Zoti Dogjani e ka fjalën 5 minuta.

**Asllan Dogjani** – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Opozita fjalën ka dhe nuk duhet të mendoni vetëm për sot që jeni aty në krye të Kuvendit, por duhet të mendoni edhe për nesër, sepse bashkë kemi qenë dhe nuk kemi lejuar ndonjëherë që të na hiqet fjala. Në fakt, mund të keni edhe të drejtë, sepse në krahun këtej, ku jam edhe unë, për të cilët më duket se keni punuar gjithë kohën, një pjesë e mirë nuk flasin me njëri-tjetrin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos qesh, Taulant, se ne bashkë e kemi lejuar fjalën, kurse sot po i hiqni të drejtën e fjalës opozitës. Ma hoqët të drejtën e fjalës mua kur po denoncoja rastin e një nëne me 5 vajza, e cila ushqehet në kazanët e plehrave.

Unë sot dua t’i falënderoj të gjithë qytetarët e Kamzës, Bathores, Paskuqanit, Laprakës, Njësisë 11, Vorës, Domjes, Rrogzhinës, Kavajës dhe të gjithë qytetarët e Tiranës, të cilët me votën e tyre më besuan të jem përfaqësues i tyre në Kuvendin e Shqipërisë! Dua t’i falënderoj me zemër 5287 burra e gra, të rinj e të reja, të cilët, pavarësisht se isha i fundit në listën e Tiranës dhe e dinin se e kisha të pamundur të fitoja, më besuan, pa marrë parasysh që edhe shumë vota u vodhën. Vetëm në një qendër votimi në Paskuqan më janë vjedhur 54 vota, e konfirmuar nga KQZ-ja.

Në demokraci për ta provuar veten se sa vlen, duhet t’i nënshtrohesh votës së lirë të qytetarëve. Po sot, në vitin 2023, a i jemi nënshtroar votës? Jo. Këtë e treguan zgjedhjet e 14 majit, këtë e tregon gjendja ku ndodhet Shqipëria dhe mënyra se si sillet Kryeministri i Shqipërisë. Nëse do të kishim zgjedhje të lira dhe të ndershme, sot nuk do të kishim një Kryeministër që sillet sikur të ishte kryetari i OKB-së, që në një medie thoshte se Albini e ka gabim. Po si e paska gabim Albini dhe nuk e paska gabim Vuçiçi, shefi i të cilit ka vrarë jo pak, por rreth 1500 fëmijë gjatë luftës në Kosovë?! Po edhe sikur Albini ta kishte gabim, a i takon Kryeministrit të Shqipërisë ta thotë një fjalë të tillë dhe të mbështesë Vuçiçin? Nëse Kryeministri ynë do t’i nënshtrohej votës së lirë, nuk do të guxonte ta bënte avokatin e Vuçiçit dhe nuk do ta sulmonte Kryeministrin e Kosovës; sigurisht që jo. A jemi një komb?!

Natyrisht, shqiptarët si në Kosovë, edhe në Shqipëri u janë shumë mirënjohës aleatëve tanë: SHBA-ve dhe Bashkimit Europian, dhe sigurisht që kanë të drejtë që situata në Kosovë mund të ishte zgjidhur pa konflikte dhe pa tensione, por mund të ishte zgjidhur me dialog, ndoshta, edhe Albini e ka gabim. Po a i takon Kryeministrit tonë të analizojë nëse e ka gabim Albini apo jo, dhe nuk e ka gabim Vuçiçi? A i takon Kryeministrit tonë të sillet sikur të jetë kryetari i OKB-së, duke bërë në maksimum servilin ndaj ndërkombëtarëve? Besoj se nuk i takon dhe,



ndoshta, do të ishte më mirë që t'ua kishte lënë këtë vlerësim ndërkombëtarëve dhe qytetarëve të Kosovës. A e dini ju se për herë të parë në historinë e Shqipërisë është krijuar një klimë jomiqësore midis shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Shqipërisë, madje edhe në kohën e diktaturës, diktatori sa për “sy e faqe” bënte sikur e donte Kosovën? Analistë të pavarur janë shprehur se Kryeministri i Shqipërisë me qëndrimet për ngjarjet e fundit në Veriun e Kosovës, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka bërë tradhti të lartë ndaj qytetarëve shqiptarë.

Të nderuar kolegë, ja pse nga vota fillon gjithçka. Po të kishim zgjedhje të lira e të ndershme, Kryeministri nuk do të guxonte të sillej në këtë mënyrë dhe sot nuk do të kishim 1 milion shqiptarë që e kanë braktisur vendin.

Zgjedhjet e 14 majit u manipuluan, u blenë masivisht. Kryeministri u bënte thirrje demokratëve: “Mos dilni në votime, se, po dolët dhe fituat, do të merrni “Ndoc Rrokun””. Si zakonisht, këto zgjedhje u morën peng nga grupet kriminale. Grupet kriminale u përdorën, sepse gjatë gjithë kësaj kohe, si zakonisht, kanë marrë tenderë dhe kanë vjedhur paratë e shqiptarëve, prandaj u morën peng nga këto grupe kriminale. U përdor administrata. Në të vërtetë kandidatët nuk kishin përballë një kandidat tjetër, por kishin shtetin...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, përfundojeni!

**Asllan Dogjani** – Ja, mbarova, sepse fola pak për atë që më penguat ju...

**Ermonela Felaj** – Vetëm 5 minuta kishit.

**Asllan Dogjani** – Më penguat më parë...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, edhe 30 sekonda!

**Asllan Dogjani** – Dakord edhe 30 sekonda, sepse kemi mundësi të flasim edhe në vende të tjera! Mendoni një herë për vendin! Mos mendoni se do të jeni gjithmonë në pushtet! Le të sigurojmë një palë zgjedhje të ndershme dhe të lira, sepse nga zgjedhjet fillon gjithçka. Nga zgjedhjet varet e ardhmja dhe zhvillimi i Shqipërisë. Personalisht do të bëj gjithçka dhe u bëj thirrje qytetarëve të Tiranës, Kamzës, Paskuqanit dhe kudo: për çdo problem tuajin më njoftoni, se unë do ta konsideroj si problemin tim dhe do të bëj gjithçka për mbrojtjen e interesave tuaja!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Mbyllet këtu seanca e kësaj dite.

Mirë u dëgjofshim në seancën tjetër!

*(Seanca u mbyll në orën 15:00)*

### Nënkryetarja e Kuvendit

**Ermonela Felaj**

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**